



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

Tiranë, Janar 2024

PËRMBAJTJA

Nr.	EMËRTIMI	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
3.	Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit	6
II.	HYRJA	6
1.	Objekti i auditimit	7
2.	Qëllimi i auditimit	7
3.	Identifikimi i çështjes	7
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	7
5.	Përgjegjësitë e audituesve	7
6.	Kriteret e vlerësimit	8
7.	Standardet e auditimit	8
8.	Metodat e auditimit	8
9.	Dokumentimi i auditimit	9
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	9
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	9
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	9
2.1	Auditimi i Sigurisë së Informacionit	9-20
a.	Siguria e informacionit në drejtim të politikave të sigurisë, vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit, identifikimit të risqeve si dhe aksesimit të brendshëm dhe të jashtëm	
2.2	Zhvillimi dhe blerja në teknologjinë e informacionit	20-62
a.	Investimet në teknologjinë e informacionit	20-56
b.	Marrëveshjet e nivelit të shërbimit	56-62
2.3	Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat Input / Output	62-76
2.4	Të tjera	76-78
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	
A.	Masa Organizative	78-87

✂ LISTA E SHKURTIMEVE

KLSH	- Kontrolli i Lartë i Shtetit
DPSHTRR	- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
AKSHI	- Agjencia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit
AKCESK	- Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
VKM	- Vendim i Këshillit të Ministrave
TIK	- Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
TI (IT)	- Teknologji Informacioni
COBIT-	- Objektivat e kontrollit për Teknologjinë e Informacionit
ISSAI	- Standardet Ndërkombëtare të institucioneve Supreme të Auditimit
AK	- Autoriteti Kontraktor
AP	- Autoriteti Përfitues
OE	- Operator Ekonomik
BOE	- Bashkimi i Operatorëve Ekonomik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

KLSH mbështetur në Ligjin nr.154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi auditimin mbi Teknologjinë e Informacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, nga data 13.09.2023 deri në 13.11.2023.

Grupi i auditimit mblodhi informacione, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në këto të dhëna hartoi drejtimet e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi me objekt “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit”, në DPSHTRR, është pjesë e Planit Vjetor 2023 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH-s.

Përzgjedhja e këtij subjekti, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, që janë zhvilluar nga DPSHTRR dhe në rastet kur vetë institucioni ka qenë përfitues shërbimi për kontrata që janë lidhur nga AKSHI.

Pas marrjes së ambienteve të përshtatshme, grupi auditues filloi fazën e studimit paraprak, ku u dërgua pyetësori i hartuar nga grupi i auditimit, bazuar në Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Programi i auditimit është miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 599/1, me datë 13.09.2023.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetjet kryesore, të paraqitura në këtë Raport Përfundimtar Auditimi në mënyrë të përmbledhur sipas drejtimeve të auditimit, rezultuan si më poshtë:

Nr.	Përmbledhje e Gjetjes	Ref. me Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
1	Ndërmjet DPSHTRR dhe AKSHI-t nuk ka një ndarje të detyrimeve dhe përgjegjësisë në lidhje me sigurinë e të dhënave. Nga auditimi u konstatua se DPSHTRR gjendet në kushte të paqarta vepruese ndaj kërkesave të vazhdueshme nga AKCESK për masat që duhet të merren për infrastrukturën kritike e DM dhe e DPSHTRR, për arsye se marrëdhënia e përgjegjësisë dhe bashkëveprimi me AKSHI-n nuk është përcaktuar në terma teknikë. Aktet ligjore e nënligjore për infrastrukturën kritike përcaktojnë DPSHTRR si Operator Administrues për e DM dhe e DPSHTRR. Në asnjë strukturë dhe tek asnjë punonjës nuk janë përcaktuar detyrat funksionale që DPSHTRR ka detyrim të plotësojë si Operator Administrues i strukturave kritike përcaktuar me aktet ligjore e nënligjore.	Faqe 62-69	e Lartë	Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor në bashkëpunim me AKSHI-n dhe AKCESK-un të marrin masa organizative për përcaktimin e detyrave që rrjedhin nga aktet ligjore ku mbështeten AKSHI dhe AKCESK, por që duhet t'i zbatojë DPSHTRR, duke ndarë në këtë mënyrë përgjegjësinë e çdo institucioni ku secili do të duhet të ndërmarrë hapat organizativë dhe teknikë në sigurimin e arsyeshëm të të dhënave që ruhen në sistemin e DPSHTRR.
2	Nga auditimi mbi zbatimin e masave organizative dhe teknike për Sigurinë Kibernetike”, u konstatua se DPSHTRR ka vepruar duke prokuruar një shërbim rivlerësimi mbi situatën aktuale të ISMS-s në kushtet dhe ndikimet e faktorëve të mëposhtëm që janë:	Faqe 30-39	e Lartë	Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor si institucioni përgjegjës për të dhënat e sistemeve informatike, në bashkëpunim me AKSHI-n si institucioni

	<p>- Kërkesat e vazhdueshme të AKCESK mbi marrjen e masave organizative dhe teknike në drejtim të sigurisë kibernetike;</p> <p>- Në mungesë të njohurive specifike në këtë drejtim;</p> <p>- Në mungesë të strukturës së sigurisë që AKSHI duhej të angazhonte për DPSHTRR;</p> <p>- Në mungesë të plotësisht të detyrimeve nga AKSHI-n mbi politikën dhe masat teknike që nevojiten të ndërmerren për llogari të DPSHTRR-s, për aq sa përcakton VKM nr.673 datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar. DPSHTRR si Operator Administrues i infrastrukturave kritike dhe AKSHI si institucioni përgjegjës për sigurinë, nuk janë angazhuar dhe nuk kanë aprovuar një ndarje të përgjegjësive dhe detyrave në mangësitë organizative dhe teknike që janë konstatuar nga AKCESK në drejtim të sigurisë kibernetike dhe masave që përcakton Ligji nr.2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”.</p>			<p>përgjegjës për zhvillimet teknologjike, të marrin masa për përcaktimin e termave në nivel teknik, të detyrimeve ligjorë që nevojitet të plotësojë secili prej tyre, si një zhvillim dhe domosdoshmëri në drejtim të sigurisë kibernetike. Të dy institucionet nevojitet që të mbajnë në konsideratë se siguria nuk mund të ofrohet vetëm nga një faktor, por nevojitet një përgjegjshmëri dhe ndarje eksplicite në detyrimet që ka secili prej tyre.</p>
<p>3</p>	<p>Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave u konstatua se:</p> <p>1. Nuk është ndjekur e njëjta praktikë në drejtim të nënshkrimit të marrëdhënies kontraktuale, megjithëse jemi në kushtet që asetet ndodhen në regjistrin e DPSHTRR-s dhe pagesat për këto kontrata kryhen nga ky institucion:</p> <p>- Kontrata me nr.4698, datë 24.09.2020 me objekt “<i>Implementimi i platformës elektronike eTransport</i>” është nënshkruar ndërmjet 3 palëve që janë: Autoriteti Kontraktor që është AKSHI, Autoriteti Përfitues që është DPSHTRR si dhe Operatorit Ekonomik.</p> <p>- Kontrata me nr.4721, datë 06.08.2019 me objekt “<i>Upgrade i sistemit qendror eDPSHTRR...</i>” është nënshkruar ndërmjet 2 palëve që janë: Autoriteti Kontraktor që është AKSHI dhe Operatorit Ekonomik.</p> <p>2. Nuk është ndjekur e njëjta praktikë në caktimin e punonjësve ndjekës të kontratave, ku:</p> <p>- Për kontratën me nr.4698, datë 24.09.2020 me objekt “<i>Implementimi i platformës elektronike e Transport</i>”, institucioni i DPSHTRR-s përfaqësohet me 1 punonjës ndërsa AKSHI me 3 punonjës;</p> <p>- Për kontratën me nr.4721, datë 06.08.2019 me objekt “<i>Upgrade i sistemit qendror e DPSHTRR...</i>” institucioni i DPSHTRR-s përfaqësohet me 2 punonjës ndërsa AKSHI me 3 punonjës;</p>	<p>Faqe 56-62</p>	<p>e Lartë</p>	<p>Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masa për përcaktimin e termave në kontratë dhe nënshkrimin e tyre me përfaqësimin e dy institucioneve që janë AKSHI si Autoriteti Kontraktor dhe DPSHTRR si Autoriteti Përfitues, për investime në teknologjinë e informacionit apo shërbime që aplikohen mbi asetet të cilat ndodhen në regjistrat e aktiveve të institucioneve përfitues të shërbimit.</p> <p>Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masa që në çdo kontratë investimi apo shërbimi në teknologjinë e informacionit ku asetet hardware dhe software regjistrohen në institucionin përfitues, numri i ndjekësve të kontratës nevojitet të jetë një numër tek punonjësish, ku numri më i lartë të jetë nga Institucioni Përfitues si ndjekës dhe monitorues i funksionaliteteve dhe administrator i fondeve të</p>

				shpenzuara në drejtim të teknologjisë së informacionit.
4	Nga auditimi u konstatua se në 4 dosjet e prokurimit me vlerë të vogël është konstatuar se pjesa më e madhe e shkresave zyrtare nuk janë protokolluar nga institucioni. Mungesa e numrit të protokollit nuk lë gjurmë mbi vërtetësinë e dokumenteve zyrtare të tenderit.	Faqe 39-53	e Lartë	Rekomandim: Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të mbajë në konsideratë që çdo shkresë zyrtare pjesë e dosjes së procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, të jetë e protokolluar nga institucioni.
5	Nga auditimi u konstatua se në Drejtorinë e Përgjithshme Shërbimeve të Transportit Rrugor nuk ka auditues me profil të teknologjisë së informacionit me qëllim planifikimin dhe zhvillimin e drejtimeve të auditimit IT nga struktura e Auditimit të Brendshëm.	Faqe 76-78	e Lartë	Rekomandim: Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Drejtorja e Auditimit të Brendshëm të vlerësojnë me prioritet ndryshimin e strukturës së Auditit të Brendshëm duke përfshirë auditues me profil në Teknologjinë e Informacionit me qëllim auditimin e drejtimeve IT, duke i ofruar institucionit mbulim të plotë të auditimit.

I.3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në, ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, vlerësojmë se siguria e të dhënave është e cënuar në sistemet informatike ku ruhen të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit dhe Transportit Rrugor dhe mundësia e institucionit për të marrë masa përmirësuese është e kufizuar për shkak të bashkëpërgjegjësisë që ka në drejtim të teknologjisë me AKSHI-n. Me rëndësi është situata e mungesës së strukturës së dedikuar nga AKSHI që i shërben sigurisë së informacionit si dhe mungesa e marrëveshjes në terma teknikë ndërmjet institucioneve, e mbështetur në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Megjithëse DPSHTRR është penalizuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për rrjedhjen e të dhënave të regjistrit të mjeteve, nuk është vepruar në marrjen e masave organizative dhe teknike që ka secili prej institucioneve DPSHTRR dhe AKSHI në procesin e sigurisë së të dhënave dhe sigurisë kibernetike.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 599/1, datë 13.09.2023 të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 14.09.2023 deri në 13.11.2023 në DPSHTRR, ku periudha e audituar është 01.01.2021 deri në 31.07.2023, u krye auditimi me objekt “*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*”, nga audituesit:

1. E. C., përgjegjëse e grupit;
2. A. A., anëtar;
3. A. K., anëtare;
4. M. P., anëtare.

II.1 Objekti i auditimit

Objekti i Auditimit TIK është përcaktimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrën e duhur duke përdorur burimet IT, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullatorë, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

II.2 Qëllimi i auditimit

Qëllimi i Auditimit TIK është vlerësimi nëse ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve TIK dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë.

Për të arritur në dhënien e një opinioni, janë mbledhur informacione, të dhëna dhe prova, për të përcaktuar nëse nëpërmjet sistemeve të teknologjisë së informacionit mbrohen asetet, ruhet integriteti i të dhënave, si dhe synimet e subjektit që auditohet arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet në mënyrë efikente.

II.3 Identifikimi i çështjeve

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin me nr. 599/1 Prot, datë 13.09.2023:

1. Auditimi i Sigurisë së Informacionit

a. Siguria e informacionit në drejtim të politikave të sigurisë, vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit, identifikimit të risqeve si dhe aksesimit të brendshëm dhe të jashtëm.

2. Zhvillimi dhe blerja në teknologjinë e informacionit

a. Investimet në teknologjinë e informacionit.

b. Marrëveshjet e nivelit të shërbimit.

3. Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat Input / Output

II.4 Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.343, dt. 21.07.1999, në zbatim të Ligjit nr.8378, dt. 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, si institucion me vetëfinancim, me kapital tërësisht shtetëror, mbi bazën e pasurisë dhe kapitalit të Ndërmarrjes së Shërbimeve të Transportit Rrugor. Objekti i veprimtarisë është shërbimi ndaj subjekteve shtetërore dhe private, në veprimtarinë e transportit rrugor, për regjistrimin e mjeteve, për ndërrimin e pronësisë së tyre, pajisjen me targa, për kontrollin teknik të mjeteve, për pajisjen e drejtuesve me leje-drejtimi, për ngritjen dhe informatizimin e regjistrit kombëtar të mjeteve e të drejtuesve të mjeteve dhe për transmetimin e menjëhershëm të të dhënave të kërkuara nga policia e rendit si dhe dhënien e licencave.

II.5 Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi DPSHTRR-n, mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2021 deri në 31.07.2023, në drejtim të çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë si dhe standardeve ndërkombëtare të Teknologjisë së Informacionit.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban programi i auditimit nr.599/1 Prot., datë 13.09.2023 miratuar nga Kryetari i KLSH-s. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon DPSHTRR si dhe legjislacioni për Teknologjinë e Informacionit në vendin tonë. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese është siguruar një evidencë e përshtatshme e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

II.6 Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165);
- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar”;
- Ligji nr.10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.8308, datë 18.03.1998 “Transportet Rrugore”;
- Ligji nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i Republikë së Shqipërisë”;
- Statuti i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, etj;
- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;
- VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Ligj nr.10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
- VKM nr.945, datë 2.11.2012 “Për miratimin e rregullores “administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”;
- VKM nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit”, i ndryshuar;
- VKM nr.553, datë 15.7.2020 “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të Rëndësishme të informacionit”;
- VKM nr.761, datë 12.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 553, datë 15.7.2020, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”;
- Vendim nr.239, datë 20.3.2020, për kërkesat teknike dhe funksionale të zgjidhjes software-ike për procedurën e faturimit dhe të fiskalizimit si dhe procedurën e kriteret për regjistrimin e prodhuesve e të mirëmbajtësve të zgjidhjeve software-ike;
- Rregulloret e miratuara nga CESK;
- Standardet TIK, etj.

II.7 Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testim dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, etj.

II.8 Metodatat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur, janë si më poshtë:

- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullatorë të institucionit;
- Intervista zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës;
- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi;
- Verifikime të sistemit si përdorues;
- Dokumentacioni i arkivuar i dosjeve të prokurimit, etj.

II.9 Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH si dhe në manualin aktiv të auditimit të Teknologjisë së Informacionit në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, raporte të ndryshme me të dhëna nxjerrë nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1 Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka si objekt veprimtarinë e transportit rrugor, regjistrimin e mjeteve, pajisjen e drejtuesve me leje-drejtimi, dhënien e licencave, ndërrimin e pronësisë dhe pajisjen me targa si dhe kontrollin teknik të mjeteve. Zhvillimi i sistemeve informatike është shumë i rëndësishëm për DPSHTRR pasi në informatizimin e shërbimeve, rritjen dhe përmirësimin e tyre mbështetet aktiviteti dhe arritja e objektivave institucional.

Me vendimin nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” i ndryshuar, DPSHTRR nuk ka një strukturë IT të vetën në institucion në drejtim të sigurisë dhe as një strukturë e dedikuar nga AKSHI për këtë institucion. Struktura e re e ngritur në DPSHTRR me emërtimin Drejtoria e Administrimit dhe Monitorimit ka si fokus administrimin dhe përpunimin e informacionit që lidhet me veprimtarinë e DPSHTRR-së.

Infrastruktura e teknologjisë së informacionit ku përfshihen jo vetëm pajisjet fizike servera, router etj, por dhe sistemet informatike që janë ndërtuar në vite dhe janë funksionalë aktualisht, ndodhet fizikisht dhe në regjistrin e asetëve të DPSHTRR-s.

Kontratat e shërbimit, të implementimit dhe mirëmbajtjes janë zhvilluar nga AKSHI, i cili është dhe Autoriteti Kontraktor, ndërsa për ndjekjen dhe zbatimin e tyre janë ngritur grupe të përbashkëta ndërmjet AK dhe institucionit përfitues që është DPSHTRR.

Ndërmjet AKSHI-t dhe DPSHTRR-s nuk është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, me terma teknike dhe ligjorë për mbarëvajtjen e shërbimeve TIK.

III.2 Përshkrim i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

III.2.1 Auditimi i Sigurisë së Informacionit

- Siguria e informacionit në drejtim të politikave të sigurisë, vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit, identifikimit të risqeve si dhe aksesimit të brendshëm dhe të jashtëm.*

Strategjia institucionale dhe teknologjisë së informacionit

Strategjia e IT përfaqëson lidhjen e përbashkët midis objektivave të Strategjisë së IT dhe atyre të strategjisë së institucionit. Objektivat e strategjisë së IT duhet të marrin parasysh nevojat e tashme dhe të ardhshme të institucionit, kapacitetin aktual të IT për të ofruar shërbime dhe kërkesat e burimeve. Strategjia duhet të marrë në konsideratë ekzistencën e infrastrukturës dhe arkitekturës së IT, investimeve, modelit të ofrimit të shërbimit, burimet duke përfshirë stafin, si dhe paraqitjen e strategjisë që integron këto elementë në një qasje të përbashkët për të mbështetur objektivat e institucionit.

Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor nuk ka një strategji institucionale si dhe nuk ka një strategji mbi teknologjinë e informacionit. Rrjedhimisht nuk ka një plan për të mbështetur dhe adresuar qartë objektivat e institucionit.

DPSHTRR për periudhën objekt auditimi nuk ka ndërmarrë masa për hartimin dhe implementimin e një strategjie mbi Teknologjinë e Informacionit, me qëllim identifikimin e proceseve për zhvillimin në mbështetje të objektivave institucionale, ku duhet të përfshihet një plan mbi teknologjinë e informacionit dhe proceset për zhvillimin, aprovimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e strategjisë.

Nga auditimi u konstatua se, në DPSHTRR janë ngritur Grupet e Menaxhimit Strategjik për çdo fillim viti respektivisht për vitin 2021 është ngritur grupi me Urdhër nr. 1352 prot., datë 21.01.2021, për vitin 2022 është ngritur grupi me Urdhër nr. 554 prot., datë 11.01.2022 dhe për vitin 2023 është ngritur grupi me Urdhër nr. 171 prot., datë 05.01.2023.

Siguria e informacionit në drejtim të politikave të sigurisë

Siguria e informacionit është bërë gjithnjë e më shumë e rëndësishme për institucionet, kjo vjen si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave.

Detyrat të cilat janë kritike për Sigurinë e Informacionit duhet të jenë të mirë përcaktuara dhe të dokumentuara. Punonjësit të cilëve u janë ngarkuar këto detyra, duhet të njohin përgjegjësitë e tyre referuar mbrojtjes së aseteve të informacionit të institucionit, përfshirë të dhënat elektronike, infrastrukturën e SI, dokumentet, etj. Rishikim për përcaktim të përshtatshëm të detyrave kritike, për të cilat kërkohen kontrole të sigurisë. Ndarja e detyrave duhet përcaktuar qartë midis menaxhimit dhe operacioneve të sigurisë së IT.

Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor nuk ka Politika të Sigurisë së Informacionit dhe një drejtim strategjik të përshtatshëm si mbështetje për sigurinë e informacionit.

-Nuk janë mirë përcaktuar përgjegjësitë për sigurinë e IT si dhe nuk ka në strukturë një staf të përcaktuar vetëm për sigurinë e informacionit.

Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit

Bazuar në standardet ndërkombëtare, siguria e informacionit garantohet duke siguruar gatishmërinë, konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave. Politikat e sigurisë së organizatës janë rregulla, praktika që rregullojnë sesi një institucion menaxhon, mbron dhe shpërndan burimet për të arritur objektivat specifike të sigurisë. Këto rregulla dhe praktika duhet të identifikojnë kriteret për autoritetin përkatës. Disa nga elementët në Sigurinë e TI janë:

- Planet e vazhdueshmërisë së institucionit;
- Procedurat e backup-it;
- Elemente të trajnimit dhe të edukimit mbi sigurinë;
- Procesi për raportimin e incidenteve të dyshimta të sigurisë;
- Metodatat e komunikimit me stafin mbi politikat dhe procedurat e përshtatura për sigurinë e Sistemeve të Informacionit etj.

Me Urdhër nr. 19817/4 prot., datë 13.06.2022 nga drejtori i përgjithshëm në DPSHTRR është miratuar Rregullorja ‘Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale’ e cila ka si qëllim përcaktimin e procedurave organizative teknike, masave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurisë, ruajtjes dhe administrimit të të dhënave personale në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Nga auditimi u konstatua se, kjo rregullore nuk përfshin të gjithë elementët e sigurisë së informacionit. Nga dokumentacioni i administruar fokusi kryesor i kësaj rregulloreje është siguria e të dhënave të sistemit të video survejimit si dhe mbrojtja e ambienteve të punës.

Procedura e backup-it

Qëllimi i procedurës së kryerjes së backup-it të sistemeve në përdorim është që të sigurojë metoda dhe procedura të standardizuara mbi këto procese, duke siguruar kështu ruajtjen e të

dhënave të serverave dhe mundësimin e rikthimit të këtyre të dhënave në raste të defekteve kritike ose rasteve të tjera të humbjes së të dhënave.

Nga auditimi u konstatua se, procedura e ndjekur për kryerjen e backup-it nuk është e pasqyruar apo dokumentuar në një dokument administrativ si Rregullore e Brendshme apo dokument tjetër TIK ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup, procesin e ruajtjes së të dhënave etj., për sistemet në përdorim nga punonjësit e DPSHTRR.

Mbi verifikimin e dokumentimit të planeve për vazhdueshmërinë e biznesit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat

Qëllimi i menaxhimit të vazhdimësisë, është të mirëmbahen kërkesat e vazhdimësisë, është të mirëmbahen kërkesat e vazhdimësisë së institucionit. Menaxhimi i vazhdimësisë përfshin rishikimin periodik dhe azhornimin e afatit të rimëkëmbjes për të siguruar se ato janë në përputhje me Planet e Vazhdimësisë së Biznesit. Vazhdueshmëria e biznesit (BCP) është procesi që një institucion ndjek për të planifikuar dhe testuar rimëkëmbjen e operimit të saj pas një ndërprerjeje.

*Nga auditimi u konstatua se, DPSHTRR nuk disponon dokument të planeve të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofat (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash. Këto dokumente përcaktojnë masat, procedurat dhe objektivat e mirë dokumentuara për rivendosjen në funksionim të sistemit në rastet e emergjencave dhe që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si dhe përcaktimin e RTO (*Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes*) dhe RPOs (*Objektivat e Punës së Ripërtëritjes*) për çdo proces kritik.*

-Nuk ka identifikuar sistemet ose pjesët e tyre të cilat janë kritike për ofrimin e shërbimit 24 orë në 7 ditë të javës.

Menaxhimi i Incidenteve dhe Problemeve

Për periudhën e audituar, në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti dhe mbështetja teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve.

Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Përgjithshme Shërbimit të Transportit Rrugor nuk ka hartuar politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT. Duke mos realizuar identifikimin e risqeve rrezikon që ngjarjet të përsëriten dhe mënyra dhe koha e zgjidhjes së tyre është e papërcaktuar duke rrezikuar mbarëvajtjen e punës së sistemeve, ndërprerjen e shërbimeve etj. Identifikimi i risqeve çon në gjetjen e zgjidhjeve për t'i trajtuar ato dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen dhe në mënyrë që funksionet e institucionit të jenë të mbrojtura.

Mungesa e masave dhe mungesa e rregullores për trajtimin e incidenteve bën që DPSHTRR të mos identifikojë dhe menaxhojë risqet me efekt negativ në IT dhe në proceset e punës si dhe sjell mos dokumentim dhe mos lënie gjurmësh për trajtimin e gabimeve ose incidenteve nga punonjësit e IT.

Vlerësimi i Burimeve Njerëzore në TIK

Për kryerjen e funksioneve institucionale DPSHTRR ka një strukturë organizative të miratuar me Urdhër nr. 34 datë 16.02.2022 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, si dhe miratimin e strukturës së pagave për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor*”, e cila është e ndërtuar mbi bazën e Drejtorive, sektorëve


dhe njësive të varësisë dhe veprimtaria e të cilave rregullohet nëpërmjet dokumenteve të rregullores së brendshme të DPSHTRR-së.

Numri i përgjithshëm i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor është gjithsej 1042 punonjës.

DPSHTRR ka të miratuar në organigramën e saj Drejtorinë e Administrimit dhe të Monitorimit (DAM) e cila është nën varësinë e Drejtorit të Përgjithshëm. Kjo drejtori ka në varësi 3 (tre) sektorë: Sektori i Administrimit (1 përgjegjës sektori + 4 specialist të parë), Sektori i Monitorimit (1 përgjegjës sektori + 2 specialist), dhe Sektori i Suportit (1 përgjegjës sektori + 2 specialist të parë).

Nga 13 Drejtori Rajonale tre janë pa specialistë administrimi në strukturë përkatësisht: Dibër, Gjirokastrë dhe Kukës. Drejtoria Rajonale Tiranë ka 2 specialist administrimi dhe Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Fier, Korçë, Laç, Berat dhe Sarandë kanë nga një specialist, nga të cilët 1 specialistë në Tiranë dhe 1 specialistë në Elbasan janë pozicione vakant.

Figura nr.1: Struktura e Drejtorisë së Administrimit dhe Monitorimit



Burimi: DPSHTRR, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela nr. 1: Struktura e Drejtorisë së Administrimit dhe Monitorimit Plan/Fakt

Nr.	Emërtimi	Numër viti 2023	
		Plan	Fakt
1	Drejtor	1	1
Sektori i Administrimit			
1	Përgjegjës sektori	1	1
4	Specialist i parë	4	5
Sektori i Suportit			
1	Përgjegjës sektori	1	1
2	Specialist i parë	2	1
Sektori i Monitorimit			
1	Përgjegjës sektori	1	1
2	Specialist	2	2
Specialist i Administrimit			
1	Tiranë	2	1
2	Durrës	1	1
3	Fier	1	1
4	Elbasan	1	0
5	Shkodër	1	1
6	Vlorë	1	1

7	Korçë	1	1
8	Berat	1	1
9	Laç	1	1
10	Dibër	1	1
11	Sarandë	1	1

Burimi: DPSHTRR, përpunuar nga grupi i auditimit

DPSHTRR ka kërkuar kalimin e burimeve njerëzore TIK tek AKSHI por pavarësisht kësaj detyrat funksionale ka vazhduar t'i bëjë struktura e vet institucionit pasi AKSHI nuk ka miratuar akoma një strukturë për DPSHTRR-n në kundërshtim kjo me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

Me shkresën nr. 1603 prot., datë 30.01.2018 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor i drejtohet AKSHI-t nga i cili kërkon përcaktimin e protokollit të kalimit tek AKSHI të punonjësve aktualë të njësive të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Me shkresën nr. 679 prot., datë 07.02.2018 nga AKSHI dhe nr. 2504 prot., datë 12.02.2018 AKSHI i drejtohet DAP duke vendos në dijeni DPSHTRR për procedimin e mëtejshëm në lidhje me burimet njerëzore të këtij të fundit.

Me shkresën nr. 1856 prot., datë 02.02.2018 nga DPSHTRR dhe nr. 531 prot., datë 30.01.2018 nga AKSHI është dërguar shkresë nga vetë Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit me lëndë: “Mbi zbatimin e VKM-së nr. 673 datë 22.11.2017 për punonjësit aktualë të NJTIK në përbërje të strukturave të institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore” me qëllim reflektimin e ndryshimeve strukturore përkatëse pranë Departamentit të Administratës Publike, duke hequr nga këto struktura Drejtoritë / Sektorët IT.

Me shkresën nr. 1856/1 prot., datë 02.02.2018 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor i është drejtuar AKSHI-t mbi strukturën përgjegjëse TIK, pranë DPSHTRR duke përcaktuar pozicionet aktuale të punonjësve dhe përfundimin e afateve kontraktuale të njoftimit të secilit punonjës. Gjithashtu kërkuar nga AKSHI vënien në dispozicion të personelit të mjaftueshëm dhe të certifikuar sipas legjislacionit në fuqi, për të mbajtur në funksion optimal sistemet të cilat nuk preken nga fusha e veprimit të VKM.

Me shkresën nr. 2575 prot., datë 13.02.2018 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor i është drejtuar AKSHI-t mbi strukturën përgjegjëse TIK, pranë Drejtorive Rajonale, në DPSHTRR duke përcaktuar pozicionet aktuale të punonjësve të Drejtorive Rajonale dhe përfundimin e afateve kontraktuale të njoftimit të secilit punonjës si dhe duke kërkuar vënien në dispozicion të personelit të mjaftueshëm dhe të certifikuar sipas legjislacionit në fuqi, për të mbajtur në funksion optimal sistemet të cilat nuk preken nga fusha e veprimit të VKM.

Pjesë e strukturës së DPSHTRR ka qenë edhe Sektori i Rrjetit dhe Sigurisë së të Dhënave dhe Sektori i Infrastrukturës dhe Pajisjeve Informatike.

Me shkresën nr. 2575/1 prot., datë 26.02.2018 Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit i drejtohet DPSHTRR dhe për dijeni Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Departamentit të Administratës Publike, për mos ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me punonjësit aktualë TIK deri në momentin që struktura e re e AKSHI-t të miratohet nga Kryeministri.

Me shkresën nr. 271 prot., datë 06.01.2023 DPSHTRR i është drejtuar AKSHI-t lidhur me strukturën përgjegjëse TIK pranë DPSHTRR-së ku e vë në dijeni se kjo e fundit nuk ka më në strukturën e vet Drejtori apo Sektor përgjegjëse për administrimin e TIK. Me shkresën nr. 271/1 prot., datë 24.01.2023 AKSHI i propozon DPSHTRR të parashikoj në strukturën e vet një sektor me një përbërje prej të paktën (1+2) punonjës, me emërtim “Sektori për administrimin

e të dhënave elektronike”, i cili mund të ndjekë dhe administrojë mbarëvajtjen e punës për të dhënat që DPSHTRR prodhon dhe administron.

Nga auditimi u konstatua se, Siguria e Informacionit nuk është fushë e mbuluar as nga DPSHTRR dhe as nga AKSHI i cili sipas VKM nr. 673 prot., datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, nuk ka atashuar asnjë specialist në DPSHTRR, pavarësisht se ka kërkuar ndryshimin e strukturës nga ana e DPSHTRR për mos të qenë më drejtori e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit por të mbulojë vetëm administrimin e të dhënave elektronike.

Trajnimet

Zhvillimi i trajnimeve ka një rëndësi të veçantë për menaxhimin e kapaciteteve njerëzore në institucion. Punonjësit të cilët kanë akses në sistemet e informacionit duhet të jenë të njohur me standardet e sigurisë dhe të gëzojnë aftësinë për zbatimin dhe implementimin e tyre gjatë aktivitetit që kryejnë. Është e nevojshme që të identifikohen nevojat e stafit për trajnime mbi teknologjinë e informacionit.

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën e audituar nuk u administruan dokumentacione mbi propozimet përkatëse nga niveli menaxherial i DPSHTRR (ku përfshihet drejtoria e burimeve njerëzore dhe drejtoria e administrimit dhe monitorimit) për zhvillimin e trajnimeve, nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre për trajnim për plotësimin e nevojave për trajnim mbi sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion është konstatuar se institucioni nuk ka një plan mbi trajnimin e stafit të IT në fusha specifike të cilat do të ndihmonin stafin në rritjen profesionale, certifikimin dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre. Gjithashtu, konstatohet se specialistët e IT nuk kanë marrë trajnime për kualifikime profesionale brenda dhe jashtë vendit, për vitet 2021-2022. Për vitin 2023 nuk ka trajnime të planifikuara nga ana e DPSHTRR por janë kryer dy tema trajnimi me ftesë për pjesëmarrje nga AKCESK lidhur me sigurinë kibernetike.

Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK

Regjistri i Riskut, përfaqëson një dokument të projektuar në formën e matricës monitoruese, në të cilin evidentohet informacion mbi riskun e identifikuar, riskun e qenësishëm (para kontrolleve) dhe riskun pas kontrolleve duke evidentuar gjithashtu nevojën për kontrolle të mëtejshme.

Me shkresën nr. 4763 prot., datë 23.02.2022 është miratuar nga drejtori i përgjithshëm i DPSHTRR ‘*Deklaratë për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të njësisë DPSHTRR për vitin 2021*’ dhe me nr. 4763/1 prot., datë 23.02.2022 dërgohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë shkresa me lëndë ‘*Dërgohet Pyetëtori i Vetëvlerësimit për Funkcionimin e Sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2021*’.

Për vitin 2023 është miratuar me nr. 3866 prot., datë 27.02.2023 shkresa me lëndë ‘*Deklaratë për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të DPSHTRR për vitin 2022*’ dhe me shkresën nr. 3866/1 prot., datë 27.02.2023 dërgohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ‘*Deklarata e Cilësisë, Raporti i Vetëvlerësimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin për vitin 2022 dhe Plani Veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*’. Me shkresën nr. 3866/2 prot., datë 28.02.2023 është miratuar Regjistri i riskut për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Në këtë regjistër është e përfshirë edhe Drejtoria e Administrimit dhe Monitorimit (DAM) e cila ka për funksion administrimin dhe përpunimin e informacionit që lidhet me veprimtarinë e DPSHTRR.

Nga auditimi u konstatua se, në identifikimin e risqeve për vitet 2021-2022 janë identifikuar risqet mbi sistemet e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor por nuk ka risqe të identifikuar për sigurinë e informacionit. Për vitin 2023 në risqet e identifikuar është përfshirë në Objektivin 40: ‘Ruajtja e sigurt e të dhënave të regjistrave elektronik’ e cila

përcakton si risk mungesën e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të vazhdueshëm me Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, për rritjen e sigurisë së sistemeve.

Aksesimit të brendshëm dhe të jashtëm

Përdoruesit e Sistemit e DM dhe e DPSHTRR. Administrimi i përdoruesve (krijimi, modifikimi dhe mbyllje) në këtë sistem realizohet nga përgjegjësja e sektorit të administrimit detyrë kjo e caktuar jo me urdhër nga titullari i institucionit por referuar detyrave që i caktohen këtij punonjësi në rregulloren e brendshme të institucionit Neni 68/1 pika 8 e cila citon: “*Ndjek menaxhimin dhe implementon ndryshime të përdoruesve me të drejta administrative në programet informatike (shtim, heqje, ndryshime) në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm*”, si dhe nga përgjegjësja e sektorit të suportit e cila nuk e ka të përshkruar këtë detyrë në rregulloren e brendshme.

Nga auditimi u konstatua se, në detyrat funksionale të përgjegjësit të sektorit të suportit nuk është përcaktuar se mund të kryhen detyra mbi administrimin e përdoruesve.

Nga auditimi u konstatua se, DPSHTRR për periudhën nën auditim nuk disponon një akt rregullativ për administrimin e përdoruesve në të cilin të përcaktohen procedurat që do të ndiqen për administrimin dhe monitorimin e tyre.

Sistemi e DM

- Në sistemin e DM janë aktiv 206 përdorues nga 387 në total. Nuk ka as datë fillimi dhe as datë mbarimi për përdoruesit e krijuar në sistemin eDM kjo është fushë e paplotësuar ‘NULL’.
- Nga 387 përdorues 127 prej tyre e kanë fushën NID të paplotësuar ‘NULL’.

Sistemi e DPSHTRR

- Në sistemin eDPSHTRR janë 30 role me të drejta në sistem dhe 21 role pa të drejta në skemën e re. Nga 2 013 përdorues në total, 284 prej tyre janë migruar nga sistemi i vjetër me gjendjen e tyre të fundit.
- Për 1163 përdorues nuk është plotësuar e dhëna për adresën e email;
- Nuk ka një format standard të krijimit të përdoruesve në sistem. Konstatohen raste që ky format është: germa e parë e emrit mbiemër, emër.mbiemër, germa e parë e emrit.mbiemër, etj.,
- Ka përdorues të cilët e kanë fushën ‘Zyra’ apo ‘Drejtoria’ të paplotësuar.
- Ka përdorues aktiv si psh., përdoruesi me Username ‘sa’, ‘user_online’, etj.

Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike

Auditimi mbi shkallën e sigurisë së dhomës së serverave u krye në bazë të manualit të auditimit IT, ISSAI 5310 dhe ISO 27001 si dhe rregullores për ndërtimin e dhomës së serverave (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK për administratën publike. Duke qenë se dhoma e serverave është një pikë e rëndësishme e një sistemi informatik dhe përqendrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është më i lartë se në ambientet e tjera të punës, dëmet eventuale të shkaktuara në këtë ambient do të sillnin probleme serioze në funksionimin e të gjithë sistemit. Për këtë qëllim, grupi i auditimit, të shoqëruar nga personat përgjegjës të DPSHTRR-së vizitoi on-site pajisjet fizike të këtij institucioni. Për funksionimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në DPSHTRR është në funksionim një dhomë serverash.

Disa nga mangësitë e konstatuara janë:

- Nuk janë kryer kolaudime për sistemin kundër zjarrit;
- Nuk ka një plan testimi të sensorëve të zjarrit si dhe nuk ka një plan testimi mirëmbajtje për sistemin elektrik;
- Instalimi elektrik i dhomës së serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm të godinës;

- Nuk ka të instaluar BMS (Building Management System) sistemi i alarmit. Sistem i cili sinjalizon problemet me rrymën elektrike, prezencën e ujit, temperaturës, sigurisë së aksesit në ambientin fizik.

Si konkluzion, ambienti fizik i dhomës së serverave ku janë hostuar serverat e sistemeve si dhe disa pajisje të tjera nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara në Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (*Versioni 1.0, datë 02.12.2008*) miratuar nga AKSHI (*Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit*).

1. Titulli i gjetjes: Mungesë e planifikimit strategjik mbi teknologjinë e informacionit.

Situata: Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor nuk ka një strategji institucionale si dhe nuk ka një strategji mbi teknologjinë e informacionit. Rrjedhimisht nuk ka një plan për të mbështetur dhe adresuar qartë objektivat e institucionit. Për periudhën objekt auditimi DPSHTRR nuk ka ndërmarrë masa për hartimin dhe implementimin e një strategjie mbi Teknologjinë e Informacionit, me qëllim identifikimin e proceseve për zhvillimin në mbështetje të objektivave institucionale.

Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30 Datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin E Aktiveve Në Njësitë E Sektorit Publik”.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e një strategjie mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së institucionit.

Shkaku: Mos zbatimi i praktikave më të mira në zhvillimin dhe menaxhimin institucional.

Rëndësia: E Lartë

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie institucionale ku të përfshihet një plan mbi Teknologjinë e Informacionit me qëllim identifikimin e proceseve për zhvillimin në mbështetje të objektivave të institucionit.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.1, datë 13.11.2023, protokolluar në DPSHTRR me nr. 17659/1, datë 13.11.2023 si dhe trajtuar në faqet 6-15 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin janë paraqitur observacione protokolluar në KLSH me nr.599/3, datë 04.01.2024.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me rekomandimin 1.1, nga DPSHTRR në raportin për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të DPSHTRR-së dhe në planin e veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dërguar në MIE me shkresën nr. 4763/1 Prot, datë 23.02.2022 dhe nr. 3866/1 Prot, datë 27.02.2023, janë parashikuar dhe përcaktuar aktivitetet e planifikuara për t’u ndërmarrë, me qëllim zgjidhjen e mangësive të zbuluara gjatë përgatitjes së raporteve vjetore mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, ku përfshihen dhe objektivat ose masat që do të merren mbi Teknologjinë dhe Informacionin si implementimi dhe zhvillimi i sistemeve TIK apo dhe përmirësimi i vazhdueshëm i sistemeve ekzistuese me qëllim arritjen e objektivave të institucionit dhe funksionimin e sistemit të MFK-së në të gjitha fushat.

Në lidhje me rekomandimin 1.2, në zbatim të nenit 8, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2011 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) i lind detyrimi për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik gjatë çdo viti. Në rastet kur ka pasur ndryshime në strukturat drejtuese janë reflektuar duke bërë ndryshimet apo shtesa në urdhrat për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik. Grupi i Menaxhimit Strategjik i ngritur me urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm në DPSHTRR, janë zhvilluar takime periodike.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se, konstatimi i grupit të auditimit në lidhje me rekomandimin 1.1 qëndron në mungesën e strategjisë që institucioni duhet të disponojë,

argumenti juaj se dispononi një regjistër risku nuk qëndron. Për sa më lart, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim. *Për sa më sipër, nuk pasqyrohet asnjë ndryshim në gjetje dhe rekomandim për këtë pikë në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Observacionet e subjektit për gjetjen dhe rekomandimin 1.2 sqarojmë se është marrë në konsideratë dhe është reflektuar në raportin përfundimtar të auditimit.*

2. Titulli i gjetjes: Mungesa e procedurave të backup-it dhe planeve të vazhdimësisë së punës me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash.

Situata: Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor:

- Nuk ka Politika të Sigurisë së Informacionit dhe një drejtim strategjik të përshtatshëm si mbështetje për sigurinë e informacionit;
- Nuk janë mirë përcaktuar përgjegjësitë për sigurinë e informacionit;
- Procedura e ndjekur për kryerjen e backup-it nuk është e pasqyruar apo dokumentuar në asnjë dokument administrativ ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup, procesi i ruajtjes së të dhënave etj, për sistemet në përdorim nga punonjësit e DPSHTRR;
- Nuk disponon dokument të planeve të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofat (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash;
- Nuk ka identifikuar sistemet ose pjesët e tyre të cilat janë kritike për ofrimin e shërbimit 24 orë në 7 ditë të javës;
- Nuk ka hartuar politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT.

Kriteri: VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar, manuali i auditimit IT, praktikat më të mira.

Ndikimi/Efekti: Humbje e të dhënave dhe risk për vazhdimësinë e punës dhe ndërprerjes së shërbimeve.

Shkaku: Mos zbatim i standardeve të sigurisë mbi ruajtjen dhe përpunimin e informacionit.

Rëndësia: E Lartë

2.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit dhe uljen e riskut për ndërprerjen e shërbimeve dhe vazhdimësisë së punës. Gjithashtu të merren masa për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve, problemeve dhe ndryshimeve.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.1, datë 13.11.2023, protokolluar në DPSHTRR me nr. 17659/1, datë 13.11.2023 si dhe trajtuar në faqet 6-15 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin janë paraqitur observacione protokolluar në KLSH me nr.599/3, datë 04.01.2024.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me rekomandimin 2.1, për ofrimin e vazhdueshmërisë së punës, DPSHTRR në bashkëpunim me AKSHI-n në ndërtimin dhe implementimin e sistemeve ka ndjekur parimin e identifikimit të pjesëve kritike dhe ka aplikuar skema që ofrojnë disponueshmëri të lartë, redundancë dhe rikthim në gjendje pune në rast dështimi të një prej nyjeve.

DPSHTRR angazhohet të dokumentojë këto procese në dokumente administrative brenda 6 mujorit të parë të vitit 2024.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nisur nga fakti që DPSHTRR angazhohet në zbatimin e rekomandimit, nuk pasqyrohet asnjë ndryshim në gjetje dhe rekomandim për këtë pikë në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

3. Titulli i gjetjes: Mungesa e një strukture për mbulimin e sigurisë së informacionit.

Situata: Nga auditimi u konstatua se, detyrat dhe përgjegjësitë mbi sigurinë e informacionit nuk janë kryer as nga AKSHI dhe as nga DPSHTRR e cila në zbatim të VKM nr. 673 prot., datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, nuk ka në strukturën e saj njësi të teknologjisë së informacionit.

Kriteri: VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Risk në mos përmbushje të objektivave të përcaktuara.

Shkaku: Mungesa e një strukture e cila të mbuloj sigurinë e informacionit në DPSHTRR.

Rëndësia: E Lartë

3.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor të marrin masa për miratimin e një strukture funksionale mbi sigurinë e informacionit me qëllim ofrimin e këtij shërbimi.

4. Titulli i gjetjes: Mungesë e parashikimit dhe zhvillimit të trajnimeve.

Situata: Nga auditimi u konstatua se nga niveli drejtues i DPSHTRR-s për periudhën objekt auditimi nuk janë identifikuar apo planifikuar trajnime të nevojshme në drejtim të teknologjisë së informacionit.

Kriteri: Standardet ndërkombëtare të TIK për rritjen e kapaciteteve, manuali i auditimit IT.

Ndikimi/Efekti: Risk i mos përmbushjes së veprimtarisë institucionale dhe përgjigjes ndaj emergjencave.

Shkaku: Mungesë planifikimi për zhvillimin e trajnimeve për burimet njerëzore.

Rëndësia: E Lartë

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor të marrë masa për identifikimin e nevojave dhe trajnimin e punonjësve të strukturës së Drejtorisë së Administrimit dhe Monitorimit, si dhe të hartojë e miratojë plane trajnimi mbi drejtime specifike të teknologjisë së informacionit.

5. Titulli i gjetjes: Identifikimi i risqeve në Teknologjinë e Informacionit.

Situata: Nga auditimi u konstatua se, në identifikimin e risqeve për vitet 2021-2022 janë identifikuar risqet mbi sistemet e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, por nuk ka risqe të identifikuara për teknologjinë e informacionit. Në risqet e identifikuara për vitin 2023 është përfshirë në *Objektivin 40: ‘Ruajtja e sigurt e të dhënave të regjistrave elektronik’*, e cila përcakton si risk mungesën e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të vazhdueshëm me Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, për rritjen e sigurisë së sistemeve.

Kriteri: Neni 11, pika 2, neni 12 pika 3/d dhe nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos identifikim, mos adresim i problematikave që mund të shfaqen, shkelje e sigurisë.

Shkaku: Mos përfshirja e çdo elementi të teknologjisë së informacionit duke përfshirë në të edhe burimet njerëzore, strukturën e sigurisë së teknologjisë së informacionit etj.

Rëndësia: E Lartë

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor të marrë masa për identifikimin e risqeve në drejtim të teknologjisë së informacionit, vlerësimin dhe

adresimin tek personat përgjegjës duke përfshirë dhe rastet kur risku paraqitet si rezultat i mungesës së bashkëpunimit ndërmjet AKSHI-t dhe DPSHTRR-s.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.1, datë 13.11.2023, protokolluar në DPSHTRR me nr. 17659/1, datë 13.11.2023 si dhe trajtuar në faqet 6-15 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin janë paraqitur observacione protokolluar në KLSH me nr.599/3, datë 04.01.2024.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me rekomandimin 5.1, DPSHTRR në regjistrin e riskut miratuar me shkresën nr. 3866/2, datë 28.02.2023 ka të parashikuar edhe identifikimin dhe analizimin e risqeve mbi sigurinë e informacionit. Regjistri i Riskut dhe formularët e tjerë në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2011 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dërgohen brenda muajit shkurt të çdo viti edhe në MIE. Plotësimi i plotë i këtij rekomandimi është i kushtëzuar edhe nga krijimi i strukturës përkatëse, për të cilën kërkohet bashkëpunim/miratim edhe nga struktura jashtë DPSHTRR-së.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se janë dhënë rekomandime të cilat lidhen me struktura të dedikuara të sigurisë si nga AKSHI ashtu dhe për pozicionin e Oficerit të Sigurisë në DPSHTRR. Me plotësimin e këtyre strukturave, DPSHTRR duhet të mbajë në konsideratë identifikimin e risqeve në sigurinë e të dhënave, por dhe risqe që identifikohen si mungesë bashkëpunimi dhe ndarje përgjegjësish ndërmjet AKSHI-t dhe DPSHTRR-s.

Për sa më sipër, nuk pasqyrohet asnjë ndryshim në gjetje dhe rekomandim për këtë pikë në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

6. Titulli i gjetjes: Administrimi i përdoruesve të sistemit e DPSHTRR dhe e DM.

Situata: Nga auditimi u konstatua se:

- Nuk disponohet një akt rregullativ për administrimin e përdoruesve, mbi procedurat që duhet të ndiqen për krijimin, ndryshimin dhe mbylljen tyre;
- Në detyrat funksionale të përgjegjësit të sektorit të suportit në Drejtorinë e Administrimit dhe Monitorimit nuk është përcaktuar nëse mund të kryhen funksionet mbi administrimin e përdoruesve.

Kriteri: Neni 27, Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Ligji nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”, ISO/IEC 27001 “Information security management”.

Ndikimi/Efekt: Keq administrim i përdoruesve të sistemeve që DPSHTRR ka në përdorim krijon kushte për shkelje të sigurisë.

Shkaku: Mos hartimi dhe miratimi i akteve rregullative.

Rëndësia: E Lartë

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor të marrë masa për hartimin e një akti rregullativ për administrimin e përdoruesve, në të cilin të përcaktohen procedurat që do të ndiqen për krijimin, ndryshimin dhe mbylljen e tyre. Gjithashtu, të përditësohen përshkrimet e punës për pozicionet që angazhohen me administrimin e përdoruesve të brendshëm dhe të jashtëm të sistemeve të DPSHTRR-s.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.1, datë 13.11.2023, protokolluar në DPSHTRR me nr. 17659/1, datë 13.11.2023 si dhe trajtuar në faqet 6-15 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin janë paraqitur observacione protokolluar në KLSH me nr.599/3, datë 04.01.2024.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me rekomandimin 6.1, DPSHTRR angazhohet të dokumentojë këto procese në dokumente administrative brenda 3 mujorit të parë të vitit 2024.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nisur nga fakti që DPSHTRR angazhohet në zbatimin e rekomandimit, nuk pasqyrohet asnjë ndryshim në gjetje dhe rekomandim për këtë pikë në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

7. Titulli i gjetjes: Ambienti fizik i dhomës së serverave nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara në Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverëve të AKSHIT si dhe praktikat më të mira.

Situata: Disa nga mangësitë e konstatuara në ambientin fizik të dhomës së serverave janë:

- Nuk janë kryer kolaudime për sistemin kundër zjarrit;
- Nuk ka një plan testimi të sensorëve të zjarrit si dhe nuk ka një plan testimi mirëmbajtje për sistemin elektrik;
- Instalimi elektrik i dhomës së serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm të godinës;
- Nuk ka të instaluar BMS (Building Management System) sistemi i alarmit. Sistem i cili sinjalizon problemet me rrymën elektrike, prezencën e ujit, temperaturës, sigurisë së aksesit në ambientin fizik.

Kriteri: Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverave (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit), praktikat më të mira.

Ndikimi/Efekti: Shkelje të sigurisë, humbje të informacionit risk në shkatërrim të aseteve.

Shkaku: Mos krijimi i ambientit fizik në përputhje me praktikat më të mira, si dhe standardet e përcaktuara në udhëzimet e AKSHI-t.

Rëndësia: E Lartë

7.1 Rekomandimi: Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor në projektin për ndërtimin e objektit të ri për zyrat qendrore të mbajë në konsideratë zbatimin e standardit dhe parametrave që nevojiten për dhomën e serverave.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.1, datë 13.11.2023, protokolluar në DPSHTRR me nr. 17659/1, datë 13.11.2023 si dhe trajtuar në faqet 6-15 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin janë paraqitur observacione protokolluar në KLSH me nr.599/3, datë 04.01.2024.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me rekomandimin 7.1, sqarojmë se aksesit në dhomën e serverave rregullohet sipas nenit 13 “Hyrja në Dhomën e Serverave të personave të autorizuar”, të rregullores së brendshme të Qendrës së Monitorimit, miratuar me Urdhrin nr. 667 datë 20.10.2020, protokolluar me shkresën nr. 19817/1 datë 20.10.2020.

Për sistemin BMS (Building Management System) të instaluar në dhomën e serverit, DPSHTRR nuk ka investuar në riparim/mirëmbajtje pasi kjo dhomë serverash do të prishet dhe do të rindërtohet nga e para sipas projektit “Ndërtimi i godinës së Drejtorisë së Përgjithshme DPSHTRR”, sipas kontratës nr. 18631/64 datë 30.08.2023.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Përsa i përket observacioneve mbi rregulloren e miratuar për personat e autorizuar që mund të hyjnë në dhomën e serverave, sqarojmë se janë pranuar dhe janë reflektuar në raportin përfundimtar të auditimit. Ndërsa, përsa i përket konstatimeve të tjera, ju sqarojmë se ato duhet të mbahen në konsideratë për t’u zgjidhur me rindërtimin e godinës së re në të cilën keni parashikuar dhe ndërtimin e dhomës së serverave.

III.2.2 Zhvillimi dhe blerja në teknologjinë e informacionit

a. Investimet në teknologjinë e informacionit

Procedurat mbi pajisje të teknologjisë së informacionit, realizuar nga DPSHTRR për periudhën objekt auditimi, janë:

Nr	Procedura	Fondi limit (lek pa TVSh)	Vlera e Kontratës (lek pa TVSh)
1	Blerje paisje Informatike	17,394,500	16,170,007
2	Blerje paisje ndihmëse për Drejtorinë e Drejtuesve të Mjeteve	26,220,461	24,160,428
3	Zbatimi i masave organizative dhe teknike sipas ligjit nr.2/2017 "Për Sigurinë Kibernetike"	996,667	968,000
4	Automatizim të procedurave online web	1,000,000	749,800
5	Blerje USB Dongle - Security	950,000	907,500
6	Moduli në web për ndërveprimin me përdoruesit	750,000	649,900
7	Mirëmbajtje faqe Web të DPSHTRR-së	800,000	569,000

Nga procedurat e realizuara në DPSHTRR, grupi auditori procedurat si më poshtë:

I. Prokurimi me objekt "Blerje pajisje ndihmëse për Drejtorinë e Drejtuesve të Mjeteve", me datë zhvillimi të procedurës 21.05.2021, me referencë 96112.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: nr. 181, datë 11.03.2021	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: L. Ç. A. Ç. E. D.	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: L. Ç. A. Ç. E. D.
2. Fondi Limit (pa TVSh) 26,220,461 lekë.		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur", me mjete elektronike.	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: N. B. B. G. L. Ç.	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: D. A. A. Sh. K. L.
8. Data e hapjes së tenderit: 14.06.2021	9. Operatori fitues: BOE – S. & Co dhe I. S. Vlera e ofertës fituese 24,160,428 lekë pa TVSh:	10. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 2,060,033 lekë
11. Pjesëmarrës në tender BOE: S. & Co dhe I. S.	12. Operatore të Kualifikuar: 1 (një)	13. Operatorë të s'kualifikuar: 1 (një)
14. Ankimimet: Nuk ka	15. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka
17. Lidhja e kontratës: nr. 14398 prot, datë 23.07.2021	18. Vlera e kontratës (me TVSh): 28,992,513.6 lekë	19. Afati i kontratës është 10 ditë.

a. Identifikimi i nevojave për mallra dhe shërbime

Me shkresën nr.4953, datë 10.03.2021, drejtuar Drejtorisë së Prokurimeve është kërkuar nga Drejtori i Drejtorisë së Administrimit dhe Drejtori i Drejtorisë Ekonomike fillimi i procedurës së prokurimit për pajisje të nevojshme në Drejtorinë e Drejtuesve të Mjeteve si më poshtë:

1 - Inverter dhe bateri:

- 6KW – 5 copë
- 4KW – 4 copë
- 8KW – 3 copë
- 12KW – 1 copë

2 - Aparat fotografik (set komplet), kartë memorie 16gb, tripod – 50 copë;

3 - Shënjes shkrimi elektronik – 50 copë;

4 - Router Cisco – 10 copë

5 - Server Storage – 1 copë, ku të realizohet grumbullimi dhe ruajtja e informacionit të të gjitha NVR-ve në Drejtoritë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

b. Hartimi i specifikave teknike, përlogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit
Me urdhrin e titullarit nr.181, datë 11.03.2021, protokolluar me shkresën nr.5225, datë 11.03.2021 është ngritur komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, argumentimin e sasisë dhe kriterëve teknike të kualifikimit si dhe të fondit limit.

Me shkresën nr.6119, datë 25.03.2021, komisioni ka hartuar specifikimet teknike për pajisjet që kërkohen për këtë procedurë. Për argumentimin e sasive, komisioni shprehet në dokument se është mbështetur në kërkesën për fillim procedure me nr. 4953, datë 10.03.2021.

Nga auditimi u konstatua se komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, argumentimin e sasisë dhe kriterëve teknike të kualifikimit si dhe të fondit limit, nuk ka argumentuar sasinë e pajisjeve bazuar në urdhrin e titullarit nr. 181, datë 11.03.2021.

Shkresa nr.4953, datë 10.03.2021, që komisioni i referohet se është bazuar, nuk ka të argumentuar sasinë.

Me shkresën nr.6119/1, datë 02.04.2021, komisioni ka hartuar kriteret teknike të kualifikimit si dhe fondin limit, në të cilin ka argumentuar vetëm kërkesat për:

- ISO 9001 – Menaxhimi i Cilësisë;
- ISO 27001 – Menaxhimi Sigurisë së Informacionit;
- ISO 14001 – Menaxhimi i Mjedisit.

Nga auditimi u konstatua se komisioni nuk ka argumentuar mënyrën e përzgjedhur për përlogaritjen e fondit limit si dhe kriteret teknike të kualifikimit duke filluar nga pika 4 deri në pikën 15 të këtij dokumenti, në kundërshtim me nenet 59 dhe 61 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar” si dhe urdhrin e titullarit nr. 181, datë 11.03.2021.

Megjithëse kërkesa për fillimin e procedurës së prokurimit është iniciuar dhe nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike, Drejtoria e Prokurimeve kërkon përsëri kësaj drejtorie miratimin e fondit limit dhe përfshirjen e këtij objekti prokurimi në planin e investimeve dhe shpenzimeve me qëllim reflektimin e fondit në regjistrin e parashikimit si shtesë të prokurimeve për vitin 2021. Fondi përfundimtar është konfirmuar dhe miratuar nga titullari i DPSHTRR me shkresën nr.4953/2, datë 27.04.2021.

Me urdhrin e prokurimit nr.340, datë 10.05.2021, është ngritur njësi e prokurimit për procedurën e hapur elektronike me objekt “Blerje pajisje ndihmëse për Drejtorinë e Drejtuesve të Mjeteve” dhe fond limit në vlerën 26,220,461 lekë pa TVSH.

Njësi e prokurimit ka hartuar kriteret e përgjithshme të kualifikimit si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit. Kriteret e veçanta të hartuara nga njësi janë të njëjta me kriteret që ka hartuar komisioni i ngritur me urdhrin e titullarit nr. 181, datë 11.03.2021.

Në procesverbalin për argumentimin e kriterëve që ka vendosur njësi citohet se “*Kriteri i vendosur në reference të nenit 77/4 të ligjit të prokurimit publik i cili përcakton se në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra, konsiderohet si kriter i lidhur ngushtësisht me objektin e kontratës që prokurohet.*”

Bazuar në përgjigjen e kërkesës për asistencë tek APP, njësia e prokurimit ka reflektuar ndryshime të sugjeruara në lidhje me kërkesat e vendosura në specifikimet teknike, kriteret e veçanta të kualifikimit si dhe argumentimin e tyre.

Nga auditimi u konstatua se me gjithë rekomandimet e APP-s:

- Nuk është argumentuar mënyra e përzgjedhur në përllogaritjen e fondit limit;
- Nuk është argumentuar teknikisht numri prej 10 punonjësish të kërkuar, kur numri i punonjësve të specializuar për të gjitha instalimet dhe konfigurimet që kërkohen është 6.
- Nuk është argumentuar teknikisht numri prej 3 punonjësish për instalimin e pajisjeve Server/Storage kërkuar në kapacitetin teknik si më poshtë:
 - 2 punonjës të certifikuar për pajisje server/storage të nivelit ekspert i avancuar, me certifikata të lëshuara nga prodhuesi i pajisjes, në mënyrë që të sigurojë instalimin e server/storage konform normave teknike.
 - 1 punonjës të diplomuar në fushën e teknologjisë së informacionit të certifikuar MCSE ose ekuivalent, për të garantuar instalimin e softwareve dhe konfigurimin përkatës në Server Storage.

Për sa më sipër, këto parregullsi janë në kundërshtim me:

- Nenin 59 “Përllogaritja e vlerës limit të kontratës” të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, ku citohet se: “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”;
- Nenin 61 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, ku citohet se: “Hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”;
- Urdhrin e titullarit nr. 181, datë 11.03.2021 dhe urdhrin e titullarit nr. 181, datë 11.03.2021.

c. Vlerësimi i Ofertave

Me urdhrin e titullarit nr. 452/1, datë 21.05.2021 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura. Për procedurën e sipërpërmendur, ky komision ka hartuar procesverbalin e vlerësimit në datën 14.06.2021.

Pjesëmarrës në këtë procedurë ka qenë bashkimi i operatorëve ekonomik S. & Co shpk me NUIS KxxxxxxxxxF dhe I. S. shpk me NUIS JxxxxxxxxxC me ofertë financiare në vlerën 24,160,428 lekë pa TVSh.

KVO ka dokumentuar me procesverbalin nr. 5 të mbajtur në datën 28.06.2021 verifikimin e ofertës dhe si të vlefshme në këtë procedurë. Me verifikimin e dokumentacionit dhe të paraqitjes së mostrave në datën e hapjes së ofertave është shpallur fitues BOE i vetëm pjesëmarrës.

Formulari i njoftimit të fituesit është protokolluar me shkresën nr. 12632, datë 29.06.2021 dhe publikuar në sistemin elektronik të prokurimit.

d. Zbatimi i kontratave dhe marrëveshjeve në nivel shërbimi

Me urdhrin e titullarit nr. 730, datë 27.07.2021 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave që do të furnizohen sipas kontratës nr. 14398, datë 23.07.2021 me objekt “Blerje pajisje ndihmëse për Drejtorinë e Drejtuesve të Mjeteve”.

Anëtarët e këtij komisioni janë:

- A. Q. – Kryetar;
- A. Ç. – Anëtar;
- F. M. – Anëtare.

Me shkresën nr.14612, datë 27.07.2021, institucioni është njoftuar nga BOE për gatishmërinë e lëvrimit të mallrave të parashikuar në kontratë. Komisioni i marrjes në dorëzim me shkresën

nr.14622/1 prot, datë 30.07.2021, ka dokumentuar marrjen në dorëzim për pajisjet e kërkuara, certifikatat përkatëse të produkteve si dhe fletë garancitë, pra brenda kohës së përcaktuar në kontratë.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.3, datë 13.11.2023, protokolluar në DPSHTRR me nr. 17659/3, datë 13.11.2023 si dhe trajtuar në faqet 15-32 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin janë paraqitur observacione protokolluar në KLSH me nr.599/3, datë 04.01.2024.

Pretendimi i subjektit: Kundërshtojmë gjetjen e grupit të auditimit:

Së pari: Pas verifikimit rezultoi që dokumenti i administruar në protokoll si dhe kopja e administruar pranë Drejtorisë Ekonomike, janë të nënshkruara nga të dy Drejtorët e dy Drejtorive përkatëse. Kopja që është administruar në dosjen e prokurimit do jete harruar pa nënshkrimin e njërit drejtor (lapsus), pasi ishte e pamundur të sigurohej shpërndarja e këtij dokumenti pa u kompletuar me siglat përkatëse. Për hollësi, bashkëlidhur gjeni fotokopje të këtij dokumenti i sigluar nga dy Drejtorët e dy Drejtorive përkatëse.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit për pikën e parë: Po është e vërtetë që vetëm dokumenti që gjendej në dosjen e prokurimit nuk është nënshkruar. Ky konstatim nuk është shënuar në përshkrimin e gjetjes, që do të thotë se nga ana jonë është marrë në konsideratë që në Projekt Raportin e Auditimit.

Së dyti : Për argumentimin e pajisjeve përkatëse objekt të kësaj procedure ju informojmë që: Sasia e pajisjeve është bërë mbi nevojat specifike të domosdoshme në Drejtorinë Rajonale duke u bazuar në funksionin e secilës prej tyre, si dhe bazuar në "Kërkesën për fillim procedure" me Nr.4953 Prot, datë 10.03.2021 (depozituar në dosje).

Bateritë ishin të domosdoshme për mos ndërprerjen e shërbimit online ndaj qytetareve të cilët bënin aplikime për lejet e drejtimit.

Aparate Fotografik dixhital janë specifik dhe të domosdoshëm pasi janë për realizimin e shërbimit të pajisjes së qytetareve me leje drejtimi (LD), duke qenë procesi i pajisjes me LD kërkon fotografimin e personit që ka aplikuar për te, dhe bëhet në mënyre digjitale pranë Drejtorive Rajonale. Sasia është sipas posteve që kryejnë këtë funksion në DR.

Karta Memorie SD dhe Tripod janë të domosdoshme për të bërë të funksionojnë aparatet fotografik.

Router është pajisje rrjeti që bën të mundur lidhjen e degëve (DR) dhe Drejtorinë e Përgjithshme.

Server Storage është i domosdoshëm për ruajtjen e të dhënave dhe informacionit për arkivin e lejeve të drejtimit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit për pikën e dytë: Sqarojmë se argumentimi i nevojës për pajisje sipas dokumentit që i referoheni nuk është bërë duke filluar nga pika 4 deri në pikën 15 të këtij dokumenti, në kundërshtim me nenet 59 dhe 61 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar" si dhe urdhrin e titullarit nr. 181, datë 11.03.2021.

Përderisa nga ana juaj është dhënë një argumentim për këto pajisje në observacione, kjo tregon se nuk mungojnë kapacitetet për t'i hartuar ato. Referojuni akteve ligjore për argumentimin ligjor dhe teknik që kërkojnë në çdo rast të pajisjeve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit. Ky argumentim kërkohet ligjor dhe teknikisht dhe duhet të mbahet në konsideratë në çdo procedurë prokurimi në të cilën kërkohet argumentim.

Së treti: Lidhur me argumentimin e mënyrës së zgjedhur për përllogaritjen e fondit limit si dhe kriteret teknike të kualifikimit.

Fillimisht në Urdhrin e Autoritetit Kontraktor nr.181 datë 11.03.2021, me nr.5225 prot., është përcaktuar që ky komision do të hartojë specifikimet teknike, përcaktojë dhe argumentojë kriteret teknike të kualifikimit si dhe argumentojë dhe përllogaritjen e fondit limit të prokurimit me këtë objekt.

E DPSHTRR të Ligjit nr.162 datë.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku citohet “Përpara se të nisnin një procedurë prokurimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të studiojnë tregun, me qëllim që të përgatisin prokurimin dhe të informojnë operatorët ekonomikë për planet dhe kërkesat e tyre për prokurim”.

Metoda e testimit të tregut është përzgjedhur për faktin që malli objekt prokurimi është një mall vlera e të cilit është e ndryshueshme, dhe referuar luhatjeve të çmimit në treg, me qëllim argumentimin e saktë të fondit limit, u mendua që kjo është mënyra më e drejtë në përlogaritjen e fondit limit për këtë prokurim.

Gjithashtu komisioni nuk mund të bazohet në nenet 59 dhe 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (i cili ishte në zbatim të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar), pasi kjo VKM duhet të zbatohet deri në masën që nuk binte në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Lidhur me hartimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike, Autoriteti Kontraktor i është referuar nenit 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” pika 2 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku citohet “Në rastet kur njësia e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, këto përgatiten nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon. Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.” duke ngritur një komision nga struktura të specializuara.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit për pikën e tretë: Sqarojmë se nuk janë shkelur aktet ligjore duke përzgjedhur studimin e tregut për përlogaritjen e fondit limit. Ajo që mungon është argumentimi përse u zgjodh kjo mënyrë dhe jo një çmim i bazuar në kontrata të ngjashme, që dokumentacioni të konsiderohet i plotë.

Së katërti: Lidhur me argumentimin teknikisht të përcaktimit të numrit të punonjësve Përcaktimi dhe argumentimi i numrit të punonjësve është pasqyruar në proces verbalin e argumentimit të mbajtur nga Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike.

Është parë e nevojshme vendosja e 10 punonjësve duke patur parasysh dhe zëvendësimin në raste se ndodhte ndërprerja apo defekte gjatë implementimit të pajisjeve (Inverter, Storage Server, Router).

Është parë e arsyeshme për instalimin dhe konfigurimin e server/storage punësimi i 2 (dy) punonjësve të certifikuar për pajisje server/storage të nivelit ekspert i avancuar, me certifikata të lëshuara nga prodhuesi i pajisjes.

Duke qenë se Sistemi i Operimit që do të instalohet në server ishte minimum Microsoft Windows Server 2016, është parë e nevojshme punësimi i 1 (një) punonjësi të diplomuar në fushën e teknologjisë së informacionit të certifikuar MCSE.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit për pikën e katërt: Sqarojmë se observacionet juaj për të zëvendësuar punonjësin që mund të mungojë për arsye të ndryshme nuk qendron, sepse personi zëvendësues duhet të jetë i certifikuar. Numri i të certifikuarve maksimalisht është 6, megjithëse në këtë rast një punonjës ka më shumë se një certifikim. Argumentimi teknik mbi kriteret e veçanta të kualifikimit nuk është bërë nga strukturat e ngarkuara me këtë detyrë.

Për observacionet që i referohen mungesës së argumentimit, ju sqaroj se punonjësit e IT duke qenë teknik në detyrat e tyre, në përgjithësi janë të painformuar me aktet ligjore. Për këtë arsye duhet të marrin trajnimet e nevojshme për të kuptuar dhe vënë në zbatim argumentimin që kërkojnë aktet ligjore e nënligjor të prokurimit publik, sidomos kur ato i referohen procedurave me objekt Teknologjinë e Informacionit.

Për sa më sipër, grupi i auditimit pasi shqyrtoi me kujdes observacionet, vlerëson se gjetja është bazuar në aktet ligjore duke sqaruar sipas pikave që observoni dhe qëndrimin e mbajtur.

Për sa më sipër, nuk pasqyrohet asnjë ndryshim në gjetje dhe rekomandim për këtë pikë në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

II. Prokurimi me objekt “Blerje pajisje informatike”, me datë zhvillimi të procedurës 24.02.2021, me referencë 88197.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës që është prokuruar. DPSHTRR, me shkresën nr.1687 prot., datë 25.01.2021 i është drejtuar AKSHI-t me kërkesën për blerje të disa pajisjeve informatike duke i vënë në dispozicion specifikimet teknike, sasitë që kërkohen, fondin limit në dispozicion si dhe afatin e lëvrimit të tyre që është data 10.02.2021. Po në këtë dokument citohet se specifikimet teknike dhe çmimet për njësi janë marrë nga AKSHI.

Me shkresën nr.1687/2prot., datë 28.01.2021 është protokolluar kthimi i përgjigjes nga AKSHI në të cilën thuhet se afati i vendosur nga DPSHTRR nuk mund të respektohet dhe në rast urgjence, referuar ligjit të prokurimit publik, procedura të kryhet në një mënyrë tjetër.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: nr. 115, datë 16.02.2021	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: V. M.	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: V. M.
2. Fondi Limit (pa TVSh) 17,394,500 lekë.		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike.	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: A. Gj. V. M. B. Gj.	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: D. A. A. Ç. L. Ç.
8. Data e hapjes së tenderit: 23.03.2021	9. Operatori fitues: I. S. Vlera e ofertës fituese 16,170,007 lekë pa TVSh:	10. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,224,493 lekë
11. Pjesëmarrës në tender BOE: A. C. shpk B. E. shpk I. S. shpk P. S. shpk	12. Operatore të Kualifikuar: 1 (një)	13. Operatorë të s’kualifikuar: 3 (tre)
14. Ankimimet: Nga P. S.	15. Përgjigje Ankesës nga AK Jo	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: Vendimi nr.176/1, datë 27.04.2021
17. Lidhja e kontratës: nr. 8345 prot, datë 30.04.2021	18. Vlera e kontratës (me TVSh): 19,404,008.4 lekë	19. Afati i kontratës është 10 ditë.

a. Identifikimi i nevojave për mallra dhe shërbime

Me shkresën nr.1687/3, datë 09.02.2021, drejtuar Drejtorisë së Prokurimeve është kërkuar nga Drejtori i Drejtorisë së Administrimit dhe Drejtori i Drejtorisë Ekonomike fillimi i procedurës së prokurimit për blerje të disa pajisjeve informatike, në sasitë dhe vlerat përkatëse si më poshtë:

Emërtimi	Sasia	Çmimi për njësi	Vlera në Lekë
Kompjutera Desktop 1	100	85,428	8,542,800
UPS 600 VA	120	6,920	830,400
Kompjutera Workstation Advanced (Sipas prodhuesit)	20	288,565	5,771,300
Server	2	1,125,000	2,250,000
<i>Totali pa TVSh</i>			17,394,500

Drejtori i Drejtorisë së Administrimit dhe Monitorimit në dokument është shprehur se specifikimet teknike dhe çmimet për njësi janë marrë nga AKSHI, ndërsa specifikimet teknike për serverat dhe çmimet janë marrë nga studimi i tregut.

Konfirmimi i fondeve është miratuar nga titullari me shkresën nr.1687/4, datë 01.03.2021, në vlerën 20,873,400 me TVSh.

Procedura është e hapur dhe afati që përcakton neni 33 “Procedura e Hapur”, pika 4/b e VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, citohet se: “Në procedurën e hapur, me vlerë ndërmjet kufirit të lartë e të ulët monetar, afati kohor minimal për marrjen e ofertave është 30 ditë nga dita kur është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të APP-së”, të cilin DPSHTRR e ka respektuar.

Nga auditimi u konstatua se nuk janë dokumentuar nevojat dhe si është përlogaritur kjo sasi pajisjesh informatike.

b. Hartimi i specifikave teknike, përlogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit

Nga auditimi u konstatua se për këtë procedurë nuk është ngritur një komision për studimin e tregut, përlogaritjen e fondit limit si dhe argumentimin e tyre nisur nga fakti që bëjnë pjesë dhe dy servera, specifikat e të cilëve nuk janë referuar atyre që janë publikuar nga AKSHI. Drejtori i Drejtorisë së Administrimit dhe Monitorimit ka dokumentuar në kërkesën për blerje drejtuar Drejtorisë së Prokurimeve, se specifikimet teknike për serverat dhe çmimet janë marrë nga studimi i tregut.

Në vijim të urdhrin të prokurimit nr.115, datë 16.02.2021, protokolluar në DPSHTRR me nr.3346, datë 16.02.2021, njësia e prokurimit ka mbajtur në datën 22.02.2021 procesverbalin për hartimin e dokumenteve të procedurës me objekt “Blerje pajisje informatike”.

Në DST është përcaktuar se gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Nga auditimi u konstatua se nuk është marrë miratim nga AKSHI për pajisjet server, megjithëse në DST përcaktohet se gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standardet janë të pa-aplikueshme, është marrë miratimi paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Njësia e prokurimit ka kërkuar në datën 22.02.2021 nëpërmjet sistemit elektronik asistencë nga APP për hartimin e dokumenteve të tenderit. Në datën 23.02.2021 është kthyer përgjigje nga APP me sugjerimet për ndryshimin apo argumentimin e kriterëve të veçanta vendosur nga AK. Me gjithë rekomandimet e APP-s, se kriteri “Lëvrimi i mallrave, është brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e lidhjes së kontratës” kufizon pjesëmarrjen për OE të cilët nuk i disponojnë pajisjet fizikisht, nuk ka ndryshuar nga njësia.

Komisioni nuk e ka ndryshuar afatin e lëvritimit duke argumentuar se është në kushtet e emergjencës, pasi puna në sektorin e Kontrollit Teknik të mjeteve motorikë është ndërprerë dhe nuk ofrohet asnjë shërbim, ndërkohë që afati për vënien në punë të këtij sektori është data 31.03.2021. Pajisjet që kërkohen me këtë objekt prokurimi do ti shërbejnë sistemit të ri të DPSHTRR që do të vihej në funksion për shërbimin e Kontrollit Teknik të Mjeteve Motorikë.

c. Vlerësimi i Ofertave

Me urdhrin e titullarit nr. 127/1, datë 24.02.2021 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura. Për procedurën e sipërpërmendur, ky komision ka hartuar procesverbalin e vlerësimit në datën 14.06.2021.

Pjesëmarrës në këtë procedurë të zhvilluar me mjete elektronike kanë qenë:

- A. shpk, me ofertë financiare 10,500,000 lekë pa TVSh;

- B. E. shpk, me ofertë financiare 15,238,500 lekë pa TVSh;
- I. S. shpk, me ofertë financiare 16,170,007 lekë pa TVSh;
- P. S. shpk, me ofertë financiare 14,029,200 lekë pa TVSh.

Në procesverbalin nr.3 të datës 23.03.2021, të mbajtur nga KVO dhe Njësia e Prokurimit njoftohet se OE pjesëmarrës do të njoftohen mbi klasifikimin e tyre brenda datës 06.04.2021. Operatori pjesëmarrës A. shpk ka paraqitur një kërkesë për t'u tërhequr nga procedura protokolluar me shkresën nr.6337, datë 29.03.2021, për arsye se administratori i shoqërisë është infektuar me Covid-19 dhe ndodhet në gjendje të rëndë shëndetësore duke penguar vazhdimin me procedurat e tenderit.

Oferta e këtij operatori është shpallur e pavlefshme në procesverbalin nr.4 të mbajtur në datën 29.03.2021 nga KVO. Ky komision ka marrë në shqyrtim ofertat e mbetura.

P. S. shpk:

- Ka plotësuar kërkesat e përgjithshme.
- Ky operator nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit lidhur me kapacitetin teknik pasi nuk ka paraqitur Vetë deklaram që distributori i mallrave të ofertuara është autorizuar nga prodhuesi. Noterizimi i katalogëve dhe i certifikatave të stafit nuk është bërë konform ligjit mbi noterinë pasi nuk janë nënshkruar dhe vulosur nga noterë dhe përkthyes të autorizuar të Ministrisë së Drejtësisë.
- Numri i slotëve PCI për Workstation Advanced nuk është i njëjtë me atë të kërkuar në specifikimet teknike.

Për sa më sipër, komisioni i vlerësimit të ofertave ka vendosur të shpallë të parregullt ofertën e Operatorit P. S. shpk.

B. E. shpk:

- Ka plotësuar kërkesat e përgjithshme.
- Ky operator nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit lidhur me kapacitetin teknik për përkthimin në gjuhën shqipe të katalogëve teknik të produkteve të ofruara.
- Katalogu për UPS është paraqitur në gjuhën shqipe por i pa noterizuar dhe pa vërtetim përkthimi.
- Frekuenca në dalje tek UPS sipas katalogut të ofruar është 50+/-1%Hz ose 50+/-0.5Hz, ndërkohë që në specifikimet teknike është kërkuar 50+/-5%Hz ose 50+/-2.5Hz.

Për sa më sipër, komisioni i vlerësimit të ofertave ka vendosur të shpallë të parregullt ofertën e Operatorit B. E. shpk.

I. S. shpk:

- Ka plotësuar kërkesat e përgjithshme.
- Ka plotësuar kërkesat e veçanta të kualifikimit.
- Oferta teknike është paraqitur sipas kërkesave të dokumenteve të tenderit.

Për sa më sipër, komisioni i vlerësimit të ofertave ka vendosur të shpallë të rregullt ofertën e Operatorit I. S. shpk.

Mbi këtë klasifikim të bërë nga AK, operatori P. S. ka paraqitur ankesë në KPP e cila në vendimin nr.176/1, datë 27.04.2021, është shprehur se nuk e ka marrë parasysh ankesën e operatorit P. S. dhe AK të vijojë me hapat e tjerë të procedurës.

Formulari i njoftimit të fituesit është protokolluar me shkresën nr. 8231, datë 28.04.2021.

d. Zbatimi i kontratave dhe marrëveshjeve në nivel shërbimi

Me urdhrin e titullarit nr. 321, datë 30.04.2021 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave që do të furnizohen sipas kontratës nr. 8345, datë 30.04.2021 me objekt “*Blerje pajisje informatike*”. Anëtarët e këtij komisioni janë:

- A. Q. – Kryetar;
- D. B. – Anëtar;

F. M. – Anëtare.

Me shkresën nr.8345/3, datë 05.05.2021, komisioni i marrjes në dorëzim ka bërë verifikimin e mallit të dorëzuar dhe inspektimin e tyre, ku i ka rezultuar se produktet janë në sasinë e kërkuar dhe në përputhje me specifikimet.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, kontrata është nënshkruar në 30.04.2021 dhe pajisjet janë dorëzuar në datën 05.05.2021.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.3, datë 13.11.2023, protokolluar në DPSHTRR me nr. 17659/3, datë 13.11.2023 si dhe trajtuar në faqet 15-32 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin janë paraqitur observacione protokolluar në KLSH me nr.599/3, datë 04.01.2024.

Pretendimi i subjektit: Kundërshtojmë gjetjen e grupit të auditimit:

Prokurimi i zhvilluar për objektin "Blerje pajisje informatike" me referencë 88197 është një prokurim që zhvillohet në kushtet e emergjencës pas kalimit e QKT-ve nën administrimin e DPSHTRR-së miratuar me Urdhrin nr.349, datë 14.12.2020 "Për delegim kompetence", të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, pika 2,... DPSHTRR është caktuar si institucioni që do të marrë në dorëzim dhe në administrim të gjitha Qendrat e Kontrollit Teknik, dokumentacionin përkatës për kryerjen e inventarizimit të aseteve që të kalojnë në pronësi të tyre.

Nga DAM dhe Drejtoria Ekonomike është përcjellë shkresa për fillimin e prokurimit me këtë objekt duke përcaktuar sasinë dhe vlerat përkatëse. Sa i përket specifikimeve teknike si dhe çmimet për njësi janë marrë nga AKSHI, ndërsa specifikimet teknike për serverët janë hartuar nga DAM, duke u bazuar në specifikimet teknike të përafërta në serverat e DPSHTRR dhe eDM si dhe çmimet janë marrë nga studimi i tregut.

Referuar urgjencës së krijuar për këtë mall për shkak të afatit të përcaktuar mbi vënien në funksionim të gjitha QKT-ve në varësi të DPSHTRR-së, nga DAM pas marrjes së konfirmimit nga institucioni i AKSHI-it mbi vazhdimësinë e prokurimit me këtë objekt, nga Drejtoria e DAM-se si Drejtoria kryesore dhe përgjegjëse për menaxhimin dhe përdorimin e mallit objekt prokurimi, në bazë të organizimit të brendshëm brenda kësaj drejtorie u krijua një komision me specialistë të fushës, të cilët pas studimit të gjendjes mbi të gjitha QKT-të, analizuan situatën si Drejtori, mbi gjendjen e pajisjeve informatike dhe pasqyruan me procesverbal të veçantë argumentimin mbi sasinë dhe specifikimet teknike për serverët që nevojiteshin duke bërë edhe testimin e tregut vetëm për serverët, meqenëse nuk disponohen nga AKSHI çmimet për këtë mall.

Pas këtij veprimi të kryer nga Drejtoria e DAM-së duke marrë në konsideratë kushtet e emergjencës për këtë mall u hartua edhe kërkesa me specifikimet teknike dhe çmimet përkatëse për këtë mall, kërkesë e cila u përcoll për vazhdimësinë e procedurave të prokurimit pranë Drejtorisë së Prokurimeve. Për hollësi bashkëlidhur observacionit është bashkëlidhur edhe kopje e proces verbalit të mbajtur nga specialistet e DAM-se, proces verbal i cili është administruar në praktiken shkresore për këtë objekt të kësaj Drejtorie. Kopje e këtij proces verbal nuk i është bashkëlidhur praktikës së përcjellë pranë Drejtorisë së Prokurimeve duke u konsideruar si e ezauruar brenda Drejtorisë së DAM ku mbulon të gjithë veprimtarinë e Teknologjisë së Informacionit, brenda institucionit.

Sa i përket afatit të lëvrimit, argumentimi mbi këtë afat është përcaktuar referuar urgjencës për këtë mall. Theksojmë këtu që lidhur me këtë afat nuk është paraqitur asnjë ankese para hapjes dhe pranimit të ofertave. Gjithashtu kontrata e nënshkruar për këtë objekt është realizuar brenda afatit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Sqarojmë se është kuptuar nga ana jonë se procedura me objekt "Blerje pajisje informatike" me referencë 88197 është një prokurim që zhvillohet në kushtet e emergjencës pas kalimit të QKT-ve nën administrimin e DPSHTRR-së, por sqarojmë

se nisur nga fakti që procedura është zhvilluar "E hapur", nevojitej që dhe dokumentacioni i mbajtur të hartohej sipas përcaktimeve të procedurës së kësaj natyre.

Për sa më sipër, grupi i auditimit pasi shqyrtoi me kujdes observacionet, vlerëson se gjetja është bazuar në aktet ligjore duke sqaruar dhe qëndrimin e mbajtur. Për sa më sipër, nuk pasqyrohet asnjë ndryshim në gjetje dhe rekomandim për këtë pikë në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

III. Prokurimi me objekt "Zbatimi i masave organizative dhe teknike sipas ligjit nr.2/2017 për Sigurinë Kibernetike", me datë zhvillimi të procedurës 18.05.2023, me referencë 65898.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: nr. 675, datë 29.05.2023	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: F. K. O. H. F. H.	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: F. K. O. H. F. H.
2. Fondi Limit (pa TVSh) 996,667 lekë		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Blerje me vlerë të vogël", me mjete elektronike"	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: M. A. G. P. E. Ç.	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: M. A. G. P. E. Ç.
8. Data e hapjes së tenderit: 31.05.2023	9. Operatori fitues: S. Co shpk Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 968,000	10. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 28,667 lekë
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: H.-C. me vlerë të ofruar 956,000 lekë; S. CO me vlerë të ofruar 968,000 lekë; iCOM me vlerë të ofruar 990,000 lekë.	12. Operatore të Kualifikuar: 2 (dy)	13. Operatorë të s'kualifikuar: 1 (një)
14. Ankimimet: Nuk ka	15. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka
17. Lidhja e kontratës: -	18. Vlera (me TVSh): 1,161,600 lekë	19. Afati i kontratës: -

a. Identifikimi i nevojave për mallra dhe shërbime

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike – AKCESK, në përfundim të auditimit mbi infrastrukturën kritike sistemet eDM dhe eDPSHTRR, ka dërguar raportin e auditimit të protokolluar në DPSHTRR me shkresën nr.18177/2, datë 30.09.2021.

Në këtë raport evidentohet se:

- DPSHTRR nuk ka asnjë dokumentacion për masat e sigurisë të cilat caktohen si detyrim ligjor sipas "Rregullores mbi përmbajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave të sigurisë". Bazuar në VKM nr.553, datë 15.07.2020 "Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit" është klasifikuar si infrastrukturë kritike informacioni dhe si e tillë lind detyrimi ligjor për aplikimin e masave të caktuara të sigurisë organizative dhe teknike të përcaktuara në ligjin për Sigurinë Kibernetike dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

- Nuk janë përmbushur detyrimet ligjore të ligjit për Sigurinë Kibernetike në nenet: 7, 8, 9, 11 dhe 18.

Për marrjen e masave korigjuese, bazuar në nenin 20 të ligjit nr.2/2017 për Sigurinë Kibernetike është ngarkuar DPSHTRR, që brenda një afati 6 mujor të përcaktuar nga AKCESK të veprojë duke marrë masa organizative dhe teknike të cilat janë detajuar në këtë raport.

Në vitin 2023 AKCESK ka kërkuar informacion në DPSHTRR, duke vënë në dijeni dhe AKSHI-n me shkresën nr.7142, datë 18.04.2023, në lidhje me statusin e implementimit të masave të sigurisë, për infrastrukturën kritike të informacionit që janë ndërmarrë në adresimin e rekomandimeve të raportit të Auditit nr.190/1, datë 27.09.2021.

Nga auditimi u konstatua se nga DPSHTRR, nuk është ngritur asnjë grup dhe nuk është hartuar asnjë plan masash me qëllim zbatimin e rekomandimeve të AKCESK për sigurinë kibernetike.

Me urdhrin e titullarit të DPSHTRR-s nr. 545, datë 25.04.2023, protokolluar me shkresën nr.7142/1, datë 25.04.2023 është ngritur komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, argumentimin e kriterëve teknike të kualifikimit si dhe të fondit limit.

Po në të njëjtën ditë, DPSHTRR i përgjigjet AKCESK me shkresën nr.7142/2, datë 25.04.2021, se grupi i përbashkët ndërmjet AKSHI-t dhe DPSHTRR-s nuk ka arritur asnjë rezultat konkret.

Me shkresën vijuese nr.7142/3, datë 05.05.2023, këshilltari i Drejtorit të Përgjithshëm të institucionit, ka paraqitur informacion se për infrastrukturën e DPSHTRR-s janë marrë masa për Sigurinë Kibernetike, konkretisht marrja e shërbimit të konsulencës për “Kryerjen e vlerësimit dhe analizën e riskut, për të përcaktuar masat e nevojshme për mbrojtjen minimale në aspektin e sigurisë kibernetike”.

DPSHTRR ka ngritur një grup për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta me 3 punonjës ku 1 prej tyre është specialist në fushën e teknologjisë së informacionit.

Nga auditimi u konstatua se prej vitit 2021, kur AKCESK ka përcjellë marrjen e masave në drejtim të sigurisë kibernetike me raportin paraprak nr.190, datë 27.09.2021, nuk është vepruar nga DPSHTRR si Operator Administrues i infrastrukturave kritike përcaktuar me VKM nr.553, datë 15.07.2020 “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, i ndryshuar.

Nga auditimi u konstatua se prej vitit 2021, kur AKCESK ka përcjellë marrjen e masave në drejtim të sigurisë kibernetike me raportin paraprak nr.190, datë 27.09.2021, nuk është vepruar për disa nga masat e sigurisë kibernetike ku përgjegjës është AKSHI, si administrator i rrjetit dhe sistemeve, përcaktuar me VKM nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit”, i ndryshuar.

AKSHI, bazuar në aktet ligjore që rregullojnë aktivitetin e tij institucional, është përgjegjës për disa nga kërkesat që përcakton ligji për Sigurinë Kibernetike, dhe përputhshmëria me këtë ligj kërkon që të adresohen tek të gjitha infrastrukturën elementët e sigurisë së informacionit. Për sa më sipër, nuk u siguroa asnjë evidencë se janë marrë masa zbatuese nga AKSHI për llogaritë të DPSHTRR-s, për sa i takon sigurinë kibernetike.

b. Hartimi i specifikave teknike, përlllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit

Me urdhrin e titullarit nr.545, datë 25.04.2023, protokolluar me shkresën nr.7142/1, datë 25.04.2023 është ngritur komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, argumentimin e kriterëve teknike të kualifikimit si dhe të fondit limit. Ky komision, në varësi të termave të referencës dhe specifikimeve teknike kërkohet të argumentojë dhe fondin limit.

Me shkresën nr.7142/4, datë 12.05.2023, komisioni ka hartuar relacionin përmbledhës mbi specifikimet teknike si dhe argumentimin e fondit limit për këtë procedurë.

Nga sa vihet re në dokumentacionin e mbajtur, fondi limit është përlllogaritur bazuar në vlerën mesatare aritmetike të 3 ofertave dhe jo në mesataren e ponderuar siç shprehet komisioni.

Objektivi mbi të cilin është studiuar tregu është mbi “Kryerjen e vlerësimit dhe analizën e riskut, për të përcaktuar masat e nevojshme për mbrojtjen minimale në aspektin e sigurisë kibernetike”.

Objektivat e projektit sipas specifikimeve teknike, hartuar nga komisioni janë:

- Të kryhet një analizë gjithë përfshirëse e mangësive të Information Security Management System - ISMS aktuale të Autoritetit Kontraktor kundrejt standardit ISO/IEC 27001:2022;
- Të identifikohet çdo boshllëk ose mangësi e “ISMS” të Autoritetit Kontraktor;
- Të jepen rekomandime për përmirësimin e “ISMS” të Autoritetit Kontraktor;
- Të zhvillohet një udhërrëfyes për zbatimin e përmirësimeve të rekomanduara të sigurisë.

Nga auditimi mbi përlogaritjen e fondit limit u konstatua se, vlera e përlogaritur ka vijuar në këtë mënyrë:

- Ftesa për ofertë drejtuar operatorëve nuk është shoqëruar me specifikimet teknike të hartuara nga komisioni i ngritur për këtë qëllim;
- Specifikimet teknike janë protokolluar pasi janë dhënë oferta nga OE.

Nga auditimi u konstatua se në specifikimet teknike kërkohet që të vlerësohet situata aktuale e ISMS, ndërkohë që DPSHTRR nuk disponon një të tillë, por vetëm një rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Kjo tregon se njohuritë e grupit që është ngritur për këtë procedurë janë të pakta në drejtim të standardizimit ISO/IEC 27001:2022 dhe kërkesave të ligjit nr. nr.2/2017 për Sigurinë Kibernetike.

Me shkresën nr.7142/4, datë 12.05.2023, komisioni ka hartuar gjithashtu kriteret mbi kapacitetin teknik për këtë procedurë.

Kriteret e vendosura kërkojnë që Operatori ekonomik të ketë minimumi 10 punonjës të punësuar për periudhën Janar 2023 - Mars 2023 nga të cilët në mënyrë të kombinuar, ku punonjësi të disponojë certifikimet e mëposhtme:

- 1 punonjës të pajisur me certifikatë të konsulentit për sigurinë kibernetike;
- 1 punonjës të pajisur me certifikatë në nivelin GDPR Data Protection Officer;
- 1 punonjës të pajisur me certifikatë ITIL për menaxhimin dhe cilësinë e shërbimeve në fushën e TI;
- 1 punonjës të pajisur me certifikatë për menaxhimin e projekteve në nivel profesional;
- 1 inxhinier të pajisur me certifikatë nga Microsoft në nivel MCSE;
- 1 inxhinier të certifikuar për sigurinë e rrjetit në nivel profesional.

Inxhinierët e kërkuar duhet të jenë diplomuar në Informatikë, Elektronike, Telekomunikacion të vërtetuar me diplomën përkatëse. Të gjitha certifikimet e mësipërme duhet të jenë të vlefshme përgjatë afatit të shërbimit:

- Diplomat për inxhinierët e kërkuar;
- Certifikatat e kualifikimit duhet të jenë të verifikueshme ose të paraqiten kontakte të vlefshme në rast nevojë për verifikim. Duke patur parasysh nivelin e rëndësisë së projektit dhe ndikimin që këto sisteme kanë në institucion si infrastrukturë kritike, kërkohen vetëm certifikime në nivel profesional të lëshuara nga subjekte të njohura dhe të akredituara ndërkombëtare;
- Vërtetimi nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Janar 2023 – Mars 2023, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) ku të figurojnë punonjësit e mësipërm;
- Një punonjës, mund të ketë një ose disa certifikime;
- Të ketë kryer punë te ngjashme minimalisht në 1 rast;

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.

Nga auditimi mbi kriteret e veçanta të kualifikimit konstatohet se, argumentimi i dhënë nga grupi i ngritur me urdhrin nr. 545, datë 25.04.2023 është i përgjithshëm dhe nuk shpreh teknikisht nevojën e këtyre kriterëve për realizimin e kontratës.

Në dokumentin argumentues të mbajtur nga grupi i ngritur për hartimin e specifikave dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit, nuk janë argumentuar teknikisht kriteret për:

- Të ketë minimumi 10 punonjës të punësuar për periudhën Janar 2023 -Mars 2023, kur numri I punonjësve që do të kryejnë punimet nisur nga certifikimet është 6, ndërsa numri i punonjësve që i disponojnë këto certifikime është 3;
- Kriteri për “1 inxhinier të pajisur me certifikatë nga Microsoft në nivel MCSE” jo vetëm që nuk është argumentuar, por nuk është i domosdoshëm për këtë objekt prokurimi.
- Kriteri për “1 inxhinier të certifikuar për sigurinë e rrjetit në nivel profesional” nuk është argumentuar dhe nuk janë dhënë detaje mbi llojin e pajisjeve network që disponon institucioni.
- Kriteri për “1 punonjës të pajisur me certifikatë ITIL për menaxhimin dhe cilësinë e shërbimeve në fushën e TI” jo vetëm që nuk është argumentuar, por nuk është i domosdoshëm për këtë objekt prokurimi, derisa është kërkuar që Operatori të ketë 1 punonjës të pajisur me certifikatë për menaxhimin e projekteve në nivel profesional, gjithashtu të disponojë 3 certifikimet ISO:
 - 9001: 2015 – Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë;
 - 20001:2018 – Për Sistemin e Menaxhimit të Shërbimit;
 - 27001:2013 – Për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit.

Nga auditimi konstatohet se, nuk është vendosur kriteri për 1 punonjës të certifikuar si Auditor/ Lead Auditor, për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001, si kriter që lidhet ngushtësisht me kërkesat e vendosura në specifikime teknike dhe me rekomandimet e AKCESK.

Për sa më sipër, nga auditimi mbi kriteret e kapacitetit teknik, në procedurën “*Kryerjen e vlerësimit dhe analizën e riskut, për të përcaktuar masat e nevojshme për mbrojtjen minimale në aspektin e sigurisë kibernetike*” konstatohet se, kriteret për numrin total të punonjësve si dhe 6 certifikimet e punonjësve nuk janë argumentuar teknikisht dhe nuk janë vendosur në përputhje me specifikimet teknike të cilat i përkasin standardit ISO 27001, në kundërshtim me VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e përkatësisht me:

- Nenin 2 “Dokumentimi i procesit”, pika 2/c;
- Nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 2, pika 4/a, pika 4/b.

Me urdhrin e prokurimit nr. 675, datë 28.05.2023 është nisur procedura me vlerë të vogël dhe objekt prokurimi: Zbatimi i masave organizative dhe teknike sipas Ligjit nr.2/2017 “Për sigurinë Kibernetike”.

Bazuar në komunikimin e brendshëm ndërmjet Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtorisë së Prokurimeve përkatësisht shkresat nr. 9071, datë 16.05.2023 dhe nr. 9071/1, datë 19.05.2023 ku thuhet se ky shpenzim nuk është planifikuar për programin ekonomik financiar të vitit 2023 miratuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë. Grupi i menaxhimit strategjik në zbatim të masave të sigurisë kibernetike dhe rekomandimeve të lëna nga sipas raportit të Auditit nr.190, datë 27.09.2021 si dhe në zbatim të ligjit nr.2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”, ka shprehur domosdoshmërinë e miratimit të këtij fondi, duke propozuar rialokim shpenzimesh, pa ndryshuar rezultatin financiar të vitit 2023.

Ftesa për ofertë është publikuar në sistemin e prokurimit publik në datën 29.05.2023. Data e zhvillimit të procedurës do të jetë 31.05.2023, ora 13:00.

Vlerësimi i Ofertave

Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël në datën 31.05.2023, është dokumentuar pjesëmarrja e 3 OE. Për vlerësimin e tyre, komisioni është bazuar në udhëzimin nr.5, datë 25.06.2021 të APP-s.

OE pjesëmarrës janë:

- H.-C. me vlerë të ofruar 956,000 lekë. Ky OE është s'kualifikuar për arsye se objekti i veprimtarisë sipas QKB-s nuk është në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit;
- S. C. me vlerë të ofruar 968,000 lekë. Ky OE është kualifikuar dhe shpallur fitues si oferta më e ulët;
- iCOM me vlerë të ofruar 990,000 lekë. Ky OE është kualifikuar.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e dorëzuar të OE, vlerësimin si dhe shpalljen fitues të kësaj procedure u konstatua se:

- Kriteret mbi kualifikimet janë plotësuar nga 3 punonjës, ku një prej tyre disponon 4 nga 6 certifikimet e kërkuara, çfarë tregon se kërkesa për 10 punonjës nuk është e domosdoshme për këtë procedurë;
- Punonjësi i kualifikuar që përmbush kriterin për certifikatë të konsulentit për sigurinë kibernetike, bazuar në dokumentacion është i kualifikuar për Ethical Hacking. Kualifikimi Ethical Hacking ndryshon nga kualifikimi mbi Sigurinë Kibernetike dhe Sigurinë e Informacionit;
- Me punonjës të vetëm të certifikuar për rrjetin me certifikatën CCNA – Cisco Certified Network Associate, nuk është përmbushur kriteri për 1 inxhinier të certifikuar për sigurinë e rrjetit në nivel profesional. Certifikimi CCNA nuk i takon nivelit profesional të sigurisë në rrjet, por atij fillestar për pajisjet fizike Cisco.
- OE ka paraqitur si kontratë të ngjashme një faturë me objekt “Shërbim Konsulence për sistemet e menaxhimit” në vlerën 231,000 lekë pa TVSH. Shërbimi i realizuar sipas faturës që është bërë pjesë e kësaj procedure nuk tregon se ka realizuar shërbim lidhur me sigurinë kibernetike apo sigurinë e informacionit, por shërbim konsulence për një sistem menaxhimi i cili nuk është shoqëruar me asnjë dokument tjetër për të kuptuar nëse shërbimi i realizuar është i ngjashëm me objektin e prokurimit.

Për sa më sipër, nga auditimi mbi vlerësimin e KVO për kapacitetin teknik që është kërkuar u konstatua se, OE S. C. i shpallur fitues, nuk ka përmbushur kriteret e kërkuara në procedurë.

Në njësinë e prokurimit për këtë procedurë e cila ka vepruar dhe si KVO, nuk ka asnjë anëtar ekspert të fushës së teknologjisë së informacionit megjithëse në të janë vendosur kriteret specifike, për të cilat nga njësitë nuk është bërë një vlerësim i drejtë.

Ndërmjet OE dhe AK, nuk është nënshkruar kontratë shërbimi duke u bazuar në nenin 56, pika 10 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku citohet se “Faturat e lëshuara kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë mundur të nënshkruajnë një të tillë”.

c. Zbatimi i kontratave dhe marrëveshjeve në nivel shërbimi

Me urdhrin e titullarit nr. 746, datë 06.06.2023 është ngritur grupi për të ndjekur zbatimin e shërbimit për “Zbatimi i masave organizative dhe teknike sipas ligjit nr.2/2017 Për Sigurinë Kibernetike”, të cilët janë:

- F. K.;
- A. Q.;
- Sh. L..

Në shkresën me nr.9071/6, datë 08.07.2023 grupi i punës dhe OE fitues, kanë hartuar një situacion punimesh në të cilën përcaktojnë se kanë zhvilluar dhe janë përfunduar proceset e parashikuara në këtë procedurë, në përputhje me specifikimet teknike.

Fatura mbi shërbimin dhe raporti përfundimtar i analizës së boshllëqeve referuar procedurës së prokurimit, zhvilluar në datën 31.05.2023 nga DPSHTRR është përcjellë me shkresën nr.9071/7, datë 10.07.2023.

Grupi i marrjes në dorëzim të këtij shërbimi, me shkresën nr. 9071/8, datë 21.07.2023 ka hartuar dokumentin e quajtur “Certifikatë mbi realizimin e shërbimit të procedurës së prokurimit me objekt “Zbatimi i masave organizative dhe teknike sipas ligjit nr.2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”. Grupi i marrjes në dorëzim ka kryer verifikimet, ku ka rezultuar se shërbimet janë konform specifikimeve teknike të vendosura në ftesën për ofertë.

Nga auditimi mbi Raportin Përfundimtar u konstatua se:

- Produkti i marrë në dorëzim është një raport i mangësive me rekomandimet e nevojshme, lidhur me kërkesat dhe kontrollet e standardit ISO 27001:2022.
- Me këtë raport janë dokumentuar masat vepruese që duhen ndërmarrë nga ana e AKSHI-t, DPSHTRR-s dhe palët e treta ku bëjnë pjesë OE që ofrojnë shërbime mirëmbajtje apo zhvillime në asetet e teknologjisë së informacionit që disponon DPSHTRR.
- Ky raport vlerësimi nuk është dorëzuar i gjithë në gjuhën shqipe, por është lënë në gjuhën angleze në disa faqe si: faqja 15 si dhe faqet 215-230, megjithëse produkti përfundimtar kërkohet në gjuhën shqipe dhe në zbatimin e tij nevojiten të jenë të kuptueshme termat nga të gjitha palët, sidomos kur nuk janë njohës të këtij standardi.

Nga auditimi mbi procedurën e prokurimit me objekt “Zbatimi i masave organizative dhe teknike sipas ligjit nr.2/2017 për Sigurinë Kibernetike”, u konstatua se:

- Objekti i prokurimit i referohet zbatimit të masave sipas Ligjit nr.2/2017 për Sigurinë Kibernetike, ndërsa sipas specifikimeve teknike është kërkuar rivlerësim i situatës aktuale të ISMS mbi sigurinë kibernetike. DPSHTRR nuk ka vepruar për përmbushjen e mangësive organizative që janë vënë në dukje nga auditimi i kryer nga AKCESK, me raportin paraprak të Auditimit nr.190/1, datë 27.09.2021, ndërsa në vitin 2023 është prokuruar shërbim rivlerësimi i situatës;
- Raporti “Gap Analyses”, është një detajim i çështjeve organizative dhe teknike që janë identifikuar me mangësi nga AKCESK. Megjithëse është prokuruar shërbimi për zbatimin e masave organizative dhe teknike, DPSHTRR aktualisht ndodhet në hartimin dhe miratimin e akteve rregullativ të elementëve të ISMS.
- DPSHTRR si Operator Administrues i infrastrukturave kritike e DM dhe e DPSHTRR dhe AKSHI si institucioni përgjegjës për sigurinë, nuk janë mbledhur në grupe të përbashkëta, për ndarjen e përgjegjësive dhe detyrave në mangësitë organizative dhe teknike që ka konstatuar AKCESK. Pa kryer më parë ndarjen e përgjegjësive të secilës palë dhe atyre që lindin nga bashkëpërgjegjësia me AKSHI-n, nuk është e mundur të zbatohen plotësisht rekomandimet dhe këshillimet që janë dhënë nga AKCESK.

DPSHTRR ka vepruar duke prokuruar një shërbim rivlerësimi mbi situatën aktuale të ISMS-s në kushtet dhe ndikimet e faktorëve të mëposhtëm:

- Kërkesat e vazhdueshme të AKCESK mbi marrjen e masave organizative dhe teknike në drejtim të sigurisë kibernetike;
- Në mungesë të njohurive të nevojshme nga ana e stafit të angazhuar në të gjitha fazat e kësaj procedure;
- Në mungesë të strukturës së sigurisë që AKSHI duhej të angazhonte për DPSHTRR;
- Në mungesë të plotë bashkëpunimi me AKSHI-n për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive mbi politikat dhe masat teknike që nevojiten të ndërmerren për llogari të DPSHTRR-s, për aq

sa përcakton VKM nr.673 datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.3, datë 13.11.2023, protokolluar në DPSHTRR me nr. 17659/3, datë 13.11.2023 si dhe trajtuar në faqet 15-32 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin janë paraqitur observacione protokolluar në KLSH me nr.599/3, datë 04.01.2024.

Pretendimi i subjektit: Komisioni ka hartuar specifikimet teknike/termat e referencës, kriteret teknike të kualifikimit, si dhe fondin limit për kryerjen e kësaj procedure, e cila është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm me shkresën nr. 7142/4 prot., datë 12.05.2023. Ftesat për ofertë drejtuar subjekteve me shkresat nr. 8784 Prot, datë 11.05.2023, nr. 8785 Prot, datë 11.05.2023 dhe nr. 8786 Prot, datë 11.05.2023, për të paraqitur ofertën për realizimin e objektit të prokurimit, ku secila prej tyre ka patur të bashkangjitur specifikimet teknike të hartuara nga komisioni sipas objektit të urdhrat nr. 545 datë 25.04.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm.

Lidhur me pretendimin e ngritur nga ana juaj, sa i përket që DPSHTRR nuk disponon ISMS sqarojmë se, me termin ISMS i referohemi të gjithë pjesës së strukturës, sigurisë së informacionit si nga ana e software-ve dhe nga ana fizike, politike bërjes nga menaxhimet dhe pjesës së trajnimit të stafit, si dhe komisioni i ngritur ka në përbërje 1 punonjës të fushës, 1 punonjës Jurist dhe një punonjës Ekonomist, marrë parasysh dhe fakti që hapi që po ndërmerret është kryerja e vlerësimit dhe analizës së riskut, për të përcaktuar masat e nevojshme që duhen marrë për mbrojtjen minimale në aspektin e sigurisë kibernetike, pra janë hapat përgatitor dhe i kërkohet vlerësim i situatës momentale të ISMS-së.

Lidhur me pretendimin e ngritur nga ana juaj për përfshirjen e një punonjësi të certifikuar si Auditor/Lead Auditor sqarojmë se, në pikën 1 germa a), i jemi referuar dhe kërkohet që konsulenti të jetë i certifikuar për sigurinë kibernetike, gjithashtu në pikën 1 germa d) kërkohet që punonjësi të jetë i certifikuar për menaxhimin e projekteve në nivel profesional dhe menaxherial.

Qendrimi i Grupit të Auditimit: Sqarojmë se konstatimet e grupit janë bazuar mbi dokumentacionin e arkivuar në dosjen e prokurimit të realizuar për këtë qëllim. Në këtë dosje protokollimi i kërkesave për ofertë ishte më herët se miratimi i specifikimeve teknike që do të thotë se këto specifika nuk kanë qenë aprovuar kur është kërkuar oferta. Sqarojmë gjithashtu se nuk është rastësi përdorimi i termit ISMS, i cili është egzaktesisht termi i certifikimit për ISO 27001. Nga ana tjetër megjithëse keni përdorur termin ISMS që i përket ISO 27001, nuk keni vlerësuar kriterin kryesor atë të Lead Auditorit i cili nuk është i njëjtë me certifikimin për menaxhimin e projekteve në nivel profesional dhe menaxherial.

Pretendimi i subjektit: Në Udhëzimin nr.05, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës mbi blerjen me vlerë të vogël dhe zhvillimet e saj me mjete elektronike” pika 2, citojmë.... Titullari i autoritetit/entit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në fillim të vitit kalendarik, ngre një Komision të veçantë, të përbërë prej 3 (tre) anëtarësh, nga të cilët njëri është kryetar. Si Komision i blerjeve të vogla kemi funksionuar si Njësi Prokurimi dhe si Komision i vlerësimit të ofertave duke u bazuar në specifikimet dhe kriteret teknike të cilat janë hartuar nga specialistë të fushës. Komisioni ka realizuar vlerësimin bazuar në çmimin më të ulët të ofruar dhe fitues ka rezultuar operatori ekonomik “Sinteza CO” shpk në vendin e parë. Pas dorëzimit të dokumentacionit Komisioni ka shqyrtuar materialin e dërguar dhe referuar procesverbalit subjekti i renditur në vendin e parë ka plotësuar numrin e punonjësve, apo certifikimet dhe kualifikimet përkatëse. Sqarojmë se në ftesën për ofertë është përcaktuar që një punonjës mund të disponojë një ose disa certifikime. Në lidhje me përvojën e ngjashme nga AK është kërkuar që të paraqitet minimalisht një rast dhe nga Komisioni është gjykuar të merret në konsideratë fatura e paraqitur me objekt “Shërbim konsulence për sistemet e menaxhimit”. Komisioni ka vlerësuar këtë zë shërbimi si përvojë e mëparshme për shkak të ngjashmërisë me shërbimin objekt prokurimi. Nga Komisioni është gjykuar se ngjashmëria konsiston në

trajtimin e informacionit dhe mbrojtjen e privatësisë së të dhënave në sistemet e menaxhimit. Në të njëjtën mënyrë siguria kibernetike përfshin mbrojtjen e informacionit dhe të dhënave nga rreziqet e mundshme të krimit kibernetik. Kërkesa për përvojën e mëparshme është vlerësuar e rëndësishme për të njohur përvojën e ofertuesve, me qëllim që fituesi i mundshëm të zotërojë kapacitetet dhe përvojën e duhur si dhe të realizojë me sukses realizimin e shërbimit objekt kontrate, dhe referuar raportit të grupit për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës shërbimi është realizuar me sukses. Për sa më sipër subjekti fitues Sinteza CO shpk ka plotësuar kërkesat e vendosura në ftesën për oferte, kërkesa të cilat janë hartuar nga specialistë të fushës të caktuar nga titullari i AK.

Megjithatë AK do të marrë në konsideratë rekomandimin e grupit të auditit dhe për procedurat specifike në vijim do të përfshihet në Komisionin e blerjeve të vogla një specialist i fushës për vlerësimin e ofertave.

Qendrimi i Grupit të Auditimit: Grupi i auditimit i konsideron observacionet e subjektit si sqaruese nisur nga angazhimi juaj për përfshirjen në grupet e KVO të një specialist të Teknologjisë së Informacionit, në rastet kur do të zhvilloni procedura të kësaj natyre qofshin ato dhe me vlerë të vogël.

Për sa më sipër, nuk janë pasqyruar ndryshime në gjetje dhe rekomandim për këtë pikë në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

1.Titulli i gjetjes: Nga auditimi i procedurave të prokurimit, realizuar në teknologjinë e informacionit, u konstatua se nuk është argumentuar mënyra e përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit.

Situata: *Nga auditimi mbi procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pajisje ndihmëse për Drejtorinë e Drejtuesve të Mjeteve” për vitin 2021, u konstatua se:*

- Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, argumentimin e sasisë dhe kriterëve teknike të kualifikimit si dhe të fondit limit, nuk ka argumentuar sasinë e pajisjeve bazuar në urdhrin e titullarit nr. 181, datë 11.03.2021.
- Komisioni nuk ka argumentuar mënyrën e përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit si dhe kriteret teknike të kualifikimit duke filluar nga pika 4 deri në pikën 15 të këtij dokumenti, në kundërshtim me nenet 59 dhe 61 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar” si dhe urdhrin e titullarit nr. 181, datë 11.03.2021.
- Nuk është argumentuar teknikisht numri prej 10 punonjësish të kërkuar, kur numri i punonjësve të specializuar për të gjitha instalimet dhe konfigurimet që kërkohen është 6.
- Nuk është argumentuar teknikisht numri prej 3 punonjësish për instalimin e pajisjeve Server/Storage kërkuar në kapacitetin teknik, përkatësisht në kriteret për 2 punonjës të certifikuar për pajisje server/storage të nivelit ekspert i avancuar dhe 1 punonjës të diplomuar në fushën e teknologjisë së informacionit të certifikuar MCSE ose ekuivalent.

Nga auditimi mbi procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pajisje informatike” për vitin 2021, u konstatua se nuk janë dokumentuar nevojat dhe si është përllogaritur kjo sasi pajisjesh informatike si dhe nuk është argumentuar mënyrën e përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit për pajisjet server, çmimet e të cilave nuk publikohen nga AKSHI.

Nga auditimi mbi procedurën e prokurimit me objekt “Zbatimi i masave organizative dhe teknike sipas ligjit nr.2/2017 për Sigurinë Kibernetike” për vitin 2023, u konstatua se;

- Në specifikimet teknike kërkohet që të vlerësohet situata aktuale e ISMS, ndërkohë që DPSHTRR nuk disponon një të tillë, por vetëm një rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.
- Nuk janë argumentuar teknikisht kriteret për 10 punonjës të punësuar për 3 muaj, si dhe kriteret për:
 - 1 inxhinier të pajisur me certifikatë nga Microsoft në nivel MCSE;
 - 1 inxhinier të certifikuar për sigurinë e rrjetit në nivel profesional;
 - 1 punonjës të pajisur me certifikatë ITIL për menaxhimin dhe cilësinë e shërbimeve;

- Nuk është vendosur kriteri për 1 punonjës të certifikuar si Auditor/ Lead Auditor, për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001, si kriter që lidhet ngushtësisht me kërkesat e vendosura në specifikime teknike dhe me rekomandimet e AKCESK.

Kriteri: Nenin 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës” të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, ku citohet se: “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”;

- Neni 78 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;

- Nenin 61 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, ku citohet se: “Hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”;

- Urdhrin e titullarit nr. 181, datë 11.03.2021;

- Urdhrin e titullarit nr. 545, datë 25.04.2023;

VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e përkatësisht me:

- Nenin 2 “Dokumentimi i procesit”, pika 2/c;

- Nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 2, pika 4/a, pika 4/b.

Ndikimi/Efekt: Mungesë e gjurmës dokumentare të kërkuar me akte ligjore e nënligjore nëse kriteri është në vendosur në përputhje me objektin e prokurimit.

Shkaku: Komisioni ka interpretuar zbatimin e ligjit në terma juridikë, por jo teknike.

Rëndësia: E lartë

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, të mbajë në konsideratë se krahas argumentimit ligjor të kriterëve të veçanta të kualifikimit, nevojitet të argumentohet mënyra e përzgjedhur për përlllogaritjen e fondit limit si dhe në terma teknike çdo kriter apo specifikë e kërkuar në prokurimet që zhvillohen në drejtim të Teknologjisë së Informacionit.

2.Titulli i gjetjes: Në komisionin e vlerësimit të ofertave, për procedurën me objekt “Zbatimin i masave organizative dhe teknike sipas ligjit nr.2/2017 për Sigurinë Kibernetike”, nuk ka asnjë anëtar në grup ekspert të fushës së teknologjisë së informacionit.

Situata: Për 5 procedurat e prokurimit me vlerë të vogël në njësitë e prokurimit të cilat kanë vepruar dhe si KVO për blerjet e vogla, nuk ka asnjë anëtar në grup ekspert të fushës së teknologjisë së informacionit, megjithëse janë vendosur kriterë të veçanta kualifikuese dhe specifike.

Kriteri: Neni 75, pika 1, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Ndikimi/Efekt: Vlerësim jo i saktë i kriterëve të veçanta kualifikuese me impakt në përzgjedhjen e OE pjesëmarrës në procedurat me vlerë të vogël.

Shkaku: Trajtimi i procedurave me blerje të vogla në drejtim të teknologjisë së informacionit njëjtë si në gjithë llojet e tjera.

Rëndësia: E lartë

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të marrë masa duke caktuar ekspertë të fushës në hartimin e specifikimeve teknike si dhe të kriterëve të veçanta kualifikuese, në komisionet e vlerësimit të ofertave, për procedurat e blerjeve të vogla që janë investime apo shërbime në Teknologjinë e Informacionit.

3.Titulli i gjetjes: Mungesa e ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi që përcaktojnë akte të ndryshme ligjore.

Situata: Nga auditimi mbi zbatimin e masave organizative dhe teknike për Sigurinë Kibernetike”, u konstatua se DPSHTRR ka vepruar duke prokuruar një shërbim rivlerësimi mbi situatën aktuale të ISMS-s në kushtet dhe ndikimet e faktorëve të mëposhtëm që janë:

- Kërkesat e vazhdueshme të AKCESK mbi marrjen e masave organizative dhe teknike në drejtim të sigurisë kibernetike;
- Në mungesë të njohurive specifike në këtë drejtim;
- Në mungesë të strukturës së sigurisë që AKSHI duhej të angazhonte për DPSHTRR;
- Në mungesë të plotësisimit të detyrimeve nga AKSHI-n mbi politikat dhe masat teknike që nevojiten të ndërmerren për llogari të DPSHTRR-s, për aq sa përcakton VKM nr.673 datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

DPSHTRR si Operator Administrues i infrastrukturave kritike dhe AKSHI si institucioni përgjegjës për sigurinë, nuk janë angazhuar dhe nuk kanë aprovuar një ndarje të përgjegjësisë dhe detyrave në mangësitë organizative dhe teknike që janë konstatuar nga AKCESK në drejtim të sigurisë kibernetike dhe masave që përcakton Ligji nr.2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”.

Kriteri: Ligji nr.2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”;

VKM nr.673 datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar;

VKM nr.553, datë 15.07.2020 “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit”, i ndryshuar me VKM nr.761, datë 12.12.2022;

ISO/IEC 27001:2013 dhe ISO/IEC 27001:2022.

Ndikimi/Efekt: Siguria e të dhënave është e cenuar dhe detyrimet ligjore në zbatim të saj do të mbeten pa përgjegjës, me mungesën e ndarjes së përgjegjësisë për secilën palë si dhe detyrimet që lindin nga bashkëpërgjegjësia me AKSHI-n.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit me AKSHI-n.

Rëndësia: E lartë

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor si institucioni përgjegjës për të dhënat e sistemeve informatike, në bashkëpunim me AKSHI-n si institucioni përgjegjës për zhvillimet teknologjike, të marrin masa për përcaktimin e termave në nivel teknik, të detyrimeve ligjorë që nevojiten të plotësojë secili prej tyre, si një zhvillim dhe domosdoshmëri në drejtim të sigurisë kibernetike. Të dy institucionet nevojiten që të mbajnë në konsideratë se siguria nuk mund të ofrohet vetëm nga një faktor, por nevojiten një përgjegjshmëri dhe ndarje eksplicite në detyrimet që ka secili prej tyre.

▪ **Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Mirëmbajtje faqe Web të DPSHTRR-së”**

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 1086, datë 10.11.2021	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: F. D. M. A. G. P.	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: F. D. M. A. N. B.
2. Fondi Limit (pa tvsh) 799,500 lekë		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: F. D. M. A. N. B.	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: F. D. M. A. N. B.
8. Data e hapjes së tenderit: 12.11.2021	9. Operatori fitues: “E. W. S.” Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 569,000 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 230,500 lekë
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender:	12. Operatorë të Kualifikuar: 9 (nëntë)	13. Operatorë të s’kualifikuar: 2 (dy)

11 (njëmbëdhjetë)		
14. Ankimimet: -	15. Përgjigje Ankesës nga AK -	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: -
17. Marrja në Dorëzim Datë 03.12.2021	18. Vlera e kontratës (me TVSh): 682,800 lekë	19. Afati i kontratës: 12 muaj

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 11 Operatorë Ekonomik. Komisioni i Blerjeve të Vogla ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël ka mbajtur procesverbal në datë 18.11.2021 në DPSHTRR për shpalljen e fituesit për ofertën e Operatorit Ekonomik të renditur në vendin e parë “E. W. S.” me vlerë 569,000 lekë pa TVSH për procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje faqe Web të DPSHTRR-së”.

- Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit:

Certifikata e pjesshme e pranimit me nr. 26165/4 Prot., datë 06.04.2022 e mbajtur nga grupi i punës ka verifikuar shërbimin e pjesshëm sipas nevojave të autoritetit dhe në sasinë e kërkuar sipas përcaktimit në ftesën për ofertë për të cilën është kryer pagesa në datë 06.04.2022 me faturë tatimore 56/2022 në vlerën 193,800.00 pa TVSH. Certifikata e pjesshme e pranimit me nr. 26165/5 Prot., datë 14.11.2022 e mbajtur nga grupi i punës ka verifikuar shërbimin e pjesshëm sipas nevojave të autoritetit dhe në sasinë e kërkuar për të cilën është kryer pagesa në datë 14.11.2022 me faturë tatimore 202/2022 në vlerën 375,200.00 pa TVSH.

Certifikata e pranimit përfundimtare me nr. 26165/6 Prot., datë 14.11.2022 e mbajtur nga grupi i punës pas verifikimit të sasisë së shërbimit përfundimtar dhe verifikimit të plotësisht të specifikimeve teknike ka rezultuar konform përcaktimeve në ftesën për ofertë.

Zhvillimi i kontratës:

- Njësia e Koordinimit të Shërbimeve dhe Projekteve Digjitale me shkresën nr. 22502 Prot., 25.10.2021 i ka drejtuar një kërkesë Drejtorisë së Prokurimeve për fillimin e procedurës me objekt “Mirëmbajtje faqe Web të DPSHTRR-së” ku ka bashkëlidhur edhe specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit.

- Me shkresën nr. 24030 Prot., datë 10.11.2021 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 1086, datë 10.11.2021 për prokurimin me vlerë të vogël nga titullari i DPSHTRR. Urdhri i prokurimit me vlerë të vogël ka si objekt “Mirëmbajtje faqe Web të DPSHTRR-së” me fond limit 799,500 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e brendshme të institucionit. Njësia e prokurimit në datë 11.11.2021 ka mbajtur procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.

- Më datë 12.11.2021 Komisioni i Blerjeve të Vogla ka mbajtur procesverbal për hapjen e ofertave për procedurën me objekt “Mirëmbajtje faqe Web të DPSHTRR-së” për të cilën ka pasqyruar 11 (njëmbëdhjetë) oferta nga OE si më poshtë:

Operatori Ekonomik	Oferta ekonomike
E. W. S.	569,000
F. E.	593,000
O. S.	700,000
X. S.	721,100
R. R.	750,000
O. T.	750,000
A. H.	762,000
O. C.	769,800
I. B. S.	788,000
O. H.	484,000
D. – C.	800,000

Operatori Ekonomik O. H. është s’kualifikuar për shkak se objekti i veprimtarisë së tij nuk përputhej me objektin e prokurimit, ndërsa Operatori Ekonomik DBC – CD është s’kualifikuar për shkak se vlera e ofruar ishte më e lartë se fondi limit.

- Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël ka mbajtur procesverbal në datë 18.11.2021 në DPSHTRR për shpalljen e fituesit për ofertën e Operatorit Ekonomik të renditur në vendin e I “E. W. S.” me vlerë 569,000 lekë pa TVSH për procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje faqe Web të DPSHTRR-së”, me treguesit e çmimit si më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia	Çmimi	Vlera pa TVSH
1	Krijimi grafik faqe interneti (platforma online)	5	40,000	200,000
2	Implementim (Htmi,CDD dhe JS) dhe integrimi me faqet aktuale të internetit (platforma online)	5	30,000	150,000
3	Hartimi dhe dorëzimi i planit të migrimit të faqes dpshttr.gov.al (platforma online)	1	100,000	100,000
4	Back UP i faqeve të internetit (platforma online)	5	23,800	119,000
Totali				569,000

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Operatori Ekonomik E. W. S. kanë nënshkruar kontratën e shërbimit me shkresën nr. 26165 Prot., datë 03.12.2021 për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Mirëmbajtje faqe Web të DPSHTRR-së” me vlerë 569,000 lekë pa TVSH.

- Me shkresën nr. 26165/1 Prot., datë 03.12.2021 Titullari i DPSHTRR ka miratuar Urdhrin nr. 1215 për ndjekjen e zbatimit të detyrimeve të kontratës nr. 26165 Prot., datë 03.12.2021, për të cilën ka ngritur një grup pune për marrjen në dorëzim të përbërë nga E. Xh., E. Ç. dhe K. P..

- Certifikata e pjesshme e pranimit me nr. 26165/4 Prot., datë 06.04.2022 e mbajtur nga grupi i punës ka verifikuar shërbimin e pjesshëm sipas nevojave të autoritetit dhe në sasinë e kërkuar sipas përcaktimit në ftesën për ofertë, ka rezultuar se është kryer për sasinë si më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia
1	Krijimi grafik faqe interneti (platforma online)	1
2	Implementim (Htmi,CDD dhe JS) dhe integrimi me faqet aktuale të internetit (platforma online)	1

3	Hartimi dhe dorëzimi i planit të migrimit të faqes dpshttr.gov.al (platforma online)	1
4	Back UP i faqeve të internetit (platforma online)	1

Përsa më sipër është kryer pagesa në datë 06.04.2022 me faturë tatimore 56/2022 në vlerën 193,800.00 pa TVSH.

- Certifikata e pjesshme e pranimit me nr. 26165/5 Prot., datë 14.11.2022 e mbajtur nga grupi i punës ka verifikuar shërbimin e pjesshëm sipas nevojave të autoritetit dhe në sasinë e kërkuar sipas përcaktimit në ftesën për ofertë, ka rezultuar se është kryer për sasinë si më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia
1	Krijimi grafik faqe interneti (platforma online)	4
2	Implementim (Htmi,CDD dhe JS) dhe integrimi me faqet aktuale të internetit (platforma online)	4
3	Back UP i faqeve të internetit (platforma online)	4

Përsa më sipër është kryer pagesa në datë 14.11.2022 me faturë tatimore 202/2022 në vlerën 375,200.00 pa TVSH.

- Certifikata e pranimit përfundimtare me nr. 26165/6 Prot., datë 14.11.2022 e mbajtur nga grupi i punës pas verifikimit të sasisë së shërbimit përfundimtar dhe verifikimit të plotësimit të specifikimeve teknike ka rezultuar konform përcaktimeve në ftesën për ofertë.

- Grupi i auditimit ka konstatuar se DPSHTRR nuk ka hartuar një raport përmbledhës mbi procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje faqe Web të DPSHTRR-së” siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe në nenin 84 të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji, autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të s’kualifikuar etj.

- Grupi i auditimit ka konstatuar se një sërë shkresash në dosjen e procedurës me vlerë të vogël me objekt “Mirëmbajtje faqe Web të DPSHTRR-së” nuk janë protokolluar nga institucioni. Shkresat të cilave i mungon numri i protokollit janë:

1. Procesverbali mbi hapjen e ofertave;
2. Procesverbali mbi dorëzimin e dokumenteve të OE “E. W. S.”;
4. Procesverbali i shpalljes së fituesit.

Mungesa e siglimit të dokumenteve të mësipërme sjell mangësi dhe nuk jep gjurmë mbi vërtetësinë e shkresave zyrtare të dosjes së tenderit në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe me “Normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

▪ **Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje USB Dongle – Security”**

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 23013/3 Prot., datë 18.10.2022	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: M. A. G. P. E. Ç.	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: M. A. G. P. E. Ç.
2. Fondi Limit (pa tvsh) 950,000 lekë		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: M. A. G. P. E. Ç.	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: M. A. G. P. E. Ç.

8. Data e hapjes së tenderit: 26.10.2022	9. Operatori fitues: "P. S." Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 907,500 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 42,500 lekë
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 11 (njëmbëdhjetë)	12. Operatore te Kualifikuar: 9 (nëntë)	13. Operatorë të s'kualifikuar: 2 (dy)
14. Ankimimet: -	15. Përgjigje Ankesës nga AK -	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: -
17. Marrja në Dorëzim Datë 02.11.2022	18. Vlera e kontratës (me TVSh): 1,089,000 lekë	19. Afati i kontratës: -

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 11 Operatorë Ekonomik. Komisioni i Blerjeve të Vogla ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

- Operatori Ekonomik "I. Gj. K." shpk i renditur në vendin e I është s'kualifikuar pasi modeli mostër nuk përputhej me specifikimet teknike;

- Operatori Ekonomik "I.A." shpk i renditur në vendin e II është s'kualifikuar pasi ka sjellë tërheqjen për arsye objektive;

- Operatori Ekonomik "O." shpk i renditur në vendin e III është s'kualifikuar pasi ka sjellë tërheqjen për shkak të ndryshimit të çmimit nga furnitori;

- Operatori Ekonomik "J. & SH." shpk i renditur në vendin e IV është s'kualifikuar pasi nuk është paraqitur brenda afatit të përcaktuar në DPSHTRR në ftesën për ofertë;

- Operatori Ekonomik "G." shpk i renditur në vendin e V është s'kualifikuar pasi nuk është paraqitur brenda afatit të përcaktuar në DPSHTRR në ftesën për ofertë;

- Operatori Ekonomik "U." shpk i renditur në vendin e VI është s'kualifikuar pasi ka sjellë tërheqjen për shkak të një gabimi në përlogaritjen e fondit limit;

- Personi fizik i renditur në vendin e tetë "H. P." shpk i renditur në vendin e VII u njoftua në sistemin e APP-së ku pas njoftimit OE dorëzoi dokumentacionin në zyrën e protokollit me nr.23013/5 Prot., datë 01.11.2022 pas dorëzimit të dokumentacionit dorëzoi dhe mostrën ku rezulton se janë sipas specifikimeve teknike në ftesën për ofertë

- Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit:

- Më datë 02.11.2022 në DPSHTRR është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim nga Komisioni i Blerjeve të Vogla të përbërë nga M. A., G. P. dhe E. Ç..

Zhvillimi i kontratës:

- Drejtorja e Prokurimeve me shkresën nr. 23013 Prot., 07.10.2022 i ka drejtuar një kërkesë për çelje dhe miratim fondi për prokurimin me objekt "Blerje USB Dongle-security". Drejtorja

e Prokurimeve e ka miratuar çeljen e fondit me vlerë 1,140,000 lekë me TVSH me shkresën nr. 23013/1, datë 12.10.2022.

Nga grupi i auditimit u konstatua se fondi i miratuar është me TVSH në kundërshtim me nenin 34, pika 10 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku thuhet se “Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti ose enti kontraktor, duke përfshirë çdo pagesë siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Kur autoriteti ose enti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, ai duhet t'i mbajë ato parasysh kur përlllogarit vlerën e prokurimit”.

- Me shkresën nr. 23013/3 Prot., datë 18.10.2022 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 1459, datë 18.10.2022 për prokurimin me vlerë të vogël nga titullari i DPSHTRR. Urdhri i prokurimit me vlerë të vogël ka si objekt “Blerje USB Dongle-Security” me fond limit 950,000 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e brendshme të institucionit.

Grupi i auditimit ka konstatuar se DPSHTRR për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje USB Dongle-Security” në kundërshtim me pikën 8 të Udhëzimit nr. 05, datë 25.06.2021 nuk duhet të kishte përcaktuar fondin limit me objektin konkret.

- Më datë 25.10.2022 është mbajtur një procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim ku janë përcaktuar kriteret e veçanta të kualifikimit, kriteret teknike lidhur me objektin e procedurës së prokurimit në të cilin përcaktohet se OE pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar 1 inxhinier informatike, po ashtu në procesverbal janë të pasqyruara edhe specifikimet teknike për mallin objekt prokurimi konform ligjit për Prokurimin Publik.

Grupi i auditimit ka konstatuar se DPSHTRR për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje USB Dongle-Security” ka nxjerrë urdhrin e prokurimit para se të bënte përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta në kundërshtim me nenin 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” dhe me pikën 7 të Udhëzimit nr. 05, datë 25.06.2021 ku përcaktohet se “Përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit nga titullari i autoritetit/entit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës duhet të përlllogarisë fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, në përputhje me nenin 76 të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posaçme. Kjo përlllogaritje do t'i shërbejë komisionit të prokurimit me vlerë të vogël për të bërë krahasimin e ofertave të paraqitura gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit”.

- Më datë 25.10.2022 është bërë ftesa për ofertë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ku përcaktohet dokumentacioni që duhet të paraqesë OE dhe afatet përkatëse. Procesverbal i mbajtur më 26.10.2022 mbi hapjen e ofertave të procedurës me vlerë të vogël ka pasqyruar 11 (njëmbëdhjetë) oferta nga OE si më poshtë:

Operatori Ekonomik	Oferta ekonomike
O. shpk	840,000
G. shpk	148,000
G. shpk	879,000
H. P. shpk	907,500
I. B. S. shpk	922,000
I. shpk	750,600
I. Gj. K. shpk	530,000
J. & SH. shpk	875,000
O. N. shpk	920,000
R. T. shpk	225,000
U. shpk	890,000

- Procesverbali i mbajtur në datë 27.10.2022 nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël pas shqyrtimit të ofertave ka s'kualifikuar 2 Operatorë Ekonomikë përkatësisht OE "G." shpk dhe OE "R. T." shpk, me arsyetimin se bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 56, pika 6 "Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor të marrë në konsideratë për realizimin e objektit të kontratës vetëm operatorët ekonomikë, oferta e të cilëve, nuk është ulur më shumë se 50% e fondit limit të përlogaritur". Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka shpallur fitues OE "I. Gj. K." shpk.

- Komisioni i Blerjeve të Vogla në datë 27.10.2022 ka mbajtur procesverbal mbi dorëzimin e dokumentacionit si dhe një mostre të mallit objekt prokurimi nga OE "I. Gj. K." shpk. Gjatë testimit nga specialistët ka rezultuar se nuk ka plotësuar disa prej kriterëve të vendosura në ftesën për ofertë. Komisioni i Blerjeve të Vogla në datë 28.10.2022 ka mbajtur procesverbal mbi kthimin e mostrës pasi nuk përputhet me specifikimet teknike.

- Komisioni i Blerjeve të Vogla në datë 02.11.2022 ka mbajtur procesverbal në DPSHTRR ku ka pasqyruar:

- a) Operatori Ekonomik "I. Gj. K." shpk i renditur në vendin e I është s'kualifikuar pasi modeli mostër nuk përputhej me specifikimet teknike;
- b) Operatori Ekonomik "I." shpk i renditur në vendin e II është s'kualifikuar pasi ka sjellë tërheqjen për arsye objektive;
- c) Operatori Ekonomik "O." shpk i renditur në vendin e III është s'kualifikuar pasi ka sjellë tërheqjen për shkak të ndryshimit të çmimit nga furnitori;
- d) Operatori Ekonomik "J. & SH." shpk i renditur në vendin e IV është s'kualifikuar pasi nuk është paraqitur brenda afatit të përcaktuar në DPSHTRR në ftesën për ofertë;
- e) Operatori Ekonomik "G." shpk i renditur në vendin e V është s'kualifikuar pasi nuk është paraqitur brenda afatit të përcaktuar në DPSHTRR në ftesën për ofertë;
- f) Operatori Ekonomik "U." shpk i renditur në vendin e VI është s'kualifikuar pasi ka sjellë tërheqjen për shkak të një gabimi në përlogaritjen e fondit limit;
- g) Personi fizik i renditur në vendin e tetë "H. P." shpk i renditur në vendin e VII u njoftua në sistemin e APP-së ku pas njoftimit OE dorëzoi dokumentacionin në zyrën e protokollit me nr.23013/5 Prot., datë 01.11.2022 pas dorëzimit të dokumentacionit dorëzoi dhe mostrën ku rezulton se janë sipas specifikimeve teknike në ftesën për ofertë.

- Komisioni i Blerjeve të Vogla i përbërë nga M. A., G. P. dhe E. Ç. në datë 02.11.2022 ka mbajtur procesverbal në DPSHTRR mbi marrjen në dorëzim të mallit me objekt "Blerje USB dongle - security", me këtë tregues çmimi:

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera pa TVSH	Vlera me TVSH
1	USB Dongle-Security	Copë	150	6,050	907,500	1,089,000

- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Operatori Ekonomik fitues, personi fizik H. P. nuk kanë lidhur një kontratë ndërmjet tyre por fatura tatimore nr. 12/2022 me vlerë 907,500 lekë pa TVSH ka vlerën e kontratës së lidhur në rastin e procedurave me vlerë të vogël, mbështetur në nenin 56 të VKM 285, datë 19.05.2021 "Pagesa për prokurimet me vlerë të vogël bëhet sipas legjislacionit tatimor në fuqi. Në çdo rast, faturat e mallrave apo të shërbimeve duhet të jenë të rregullta sipas legjislacionit në fuqi. Faturat e lëshuara kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë mundur të nënshkruajnë një të tillë".

- Grupi i auditimit ka konstatuar se DPSHTRR, nuk ka hartuar një raport përmbledhës mbi procedurën e prokurimit siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe në nenin 84 të VKM 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" ku parashikohet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji, autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të s'kualifikuar etj.

- Grupi i auditimit ka konstatuar se një sërë shkresash në dosjen e procedurës me vlerë të vogël me objekt “Blerje USB Dongle-Security” nuk janë protokolluar nga institucioni. Shkresat të cilave i mungon numri i protokollit janë:

1. Procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim;
2. procesverbali mbi hapjen e ofertave;
3. Procesverbali nr. 3 mbi shqyrtimin e ofertave të prokurimit me vlerë të vogël “Blerje USB Dongle-Security”;
4. Procesverbali mbi dorëzimin e dokumenteve të OE “I. Gj. K.”;
5. Procesverbali mbi kthimin e mostrës për OE “I. Gj. K.”;
6. Procesverbali mbi dorëzimin e dokumenteve të personit OE “H. P.”;
7. Procesverbalet mbi kalimin tek Operatori Ekonomik i radhës dhe s’kualifikimi i tyre;
8. Procesverbali i shpalljes së fituesit;
9. Procesverbali mbi marrjen në dorëzim të mallit.

Mungesa e siglimit të dokumenteve të mësipërme sjell mangësi dhe nuk jep gjurmë mbi vërtetësinë e shkresave zyrtare të dosjes së tenderit në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe me “Normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

- **Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Automatizim të procedurave online web”.**

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 137., datë 14.02.2022	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: F.D. M. A. G. P.	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: F.D. M. A. G. P.
2. Fondi Limit (pa tvsh) 1,000,000 lekë		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: F.D. M. A. G. P.	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: F.D. M. A. G. P.
8. Data e hapjes së tenderit: 05.01.2022	9. Operatori fitues: “O. C.” Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 749,800 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 250,200 lekë
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 4 (katër)	12. Operatore te Kualifikuar: 4 (katër)	13. Operatorë të s’kualifikuar: -
14. Ankimimet: -	15. Përgjigje Ankesës nga AK -	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: -
17. Marrja në Dorëzim Datë 08.07.2022	18. Vlera e kontratës (me TVSh): 899,760 lekë	19. Afati i kontratës: -

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në për llogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në

dokumentacion përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 4 Operatorë Ekonomik. Komisioni i Blerjeve të Vogla ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël ka mbajtur procesverbal në datë 18.02.2022 në DPSHTRR për shpalljen e fituesit për ofertën e Operatorit Ekonomik të renditur në vendin e I “O. C.” shpk me vlerë 749,800 lekë pa TVSH për procedurën e prokurimit me objekt “Automatizim të procedurave online në web”.

- Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit:

- Me shkresën nr. 17797/1 Prot., datë 15.07.2022 grupi i marrjes në dorëzim i përbërë nga E. Xh., M. Sh. dhe M. K. i ka dërguar Sektorit të Financës dhe Sektorit të Prokurimit Publik Certifikatën e pranimit, datë 08.07.2022.

Zhvillimi i kontratës:

- Njësia e Koordinimit të Shërbimeve dhe Projekteve Digjitale me shkresën nr. 1481 Prot., 20.01.2022 i ka drejtuar një kërkesë Drejtorisë së Prokurimeve për fillimin e procedurës me objekt “Automatizim të procedurave online në web” me argumentimin për një platformë sa më funksionale në shërbim të qytetarëve.

- Drejtoria e Prokurimeve me shkresën nr. 1481/1 Prot., 24.01.2022 i ka drejtuar një kërkesë për miratim fondi për prokurimin me objekt “Automatizim të procedurave online në web”. Drejtoria e Prokurimeve me shkresën nr. 1481/2, datë 28.01.2022 e ka miratuar fondin limit me vlerë 1,000,000 lekë me TVSH, me kusht që kontrata me OE të mos lidhet përpara miratimit të Programit Ekonomiko – Financiar të vitit 2022, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Nga grupi i auditimit u konstatua se fondi i miratuar është me TVSH në kundërshtim me nenin 34, pika 10 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku thuhet se: *“Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti ose enti kontraktor, duke përfshirë çdo pagesë siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Kur autoriteti ose enti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, ai duhet t'i mbajë ato parasysh kur përllogarit vlerën e prokurimit”*.

- Me shkresën nr. 1481/3 Prot., datë 14.02.2022 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 137, datë 14.02.2022 për prokurimin me vlerë të vogël nga titullari i DPSHTRR. Urdhri i prokurimit me vlerë të vogël ka si objekt “Automatizim të procedurave online në web” me fond limit 1,000,000 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e brendshme të institucionit. Njësia e prokurimit në datë 14.02.2022 ka mbajtur procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

- Më datë 14.02.2022 është bërë ftesa për ofertë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ku përcaktohet dokumentacioni që duhet të paraqesë OE dhe afatet përkatëse. Procesverbali i mbajtur më 15.02.2022 mbi hapjen e ofertave të procedurës me vlerë të vogël ka pasqyruar 4 (katër) oferta nga OE si më poshtë:

Operatori Ekonomik	Oferta ekonomike
O. C. shpk	749,800
O. S. shpk	789,000
iC. shpk	860,000
O. T. shpk	950,000

- Komisioni i Blerjeve të Vogla në datë 17.02.2022 ka mbajtur procesverbal mbi dorëzimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit me objekt “Automatizim të procedurave online në web” nga OE “O. C.” shpk me shkresën 1481/4 Prot., datë 16.02.2022. OE “O. C.” shpk në datë 18.02.2022 ka dorëzuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor

një demo të aplikacionit mobile të instalueshëm në platformën Android e cila u shqyrtua nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël dhe rezultoi se ishte në përputhje me specifikimet teknike dhe sipas formatit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Nga grupi i auditimit u konstatua se demo e sjellë në DPSHTRR nga OE “O. C.” ka qenë jashtë afatit të përcaktuar në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 16 ku thuhet se: “Operatori Ekonomik duhet të paraqitet pranë autoritetit kontraktor brenda 24 orëve nga momenti i njoftimit të fituesit dhe duhet të dorëzojë me usb/cd një *demo* të aplikacionit mobile të instalueshëm në platformën Android (duke plotësuar të gjitha kërkesat sipas specifikimeve teknike)”.

- Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël ka mbajtur procesverbal në datë 18.02.2022 në DPSHTRR për shpalljen e fituesit për ofertën e Operatorit Ekonomik të renditur në vendin e I “O. C.” shpk me vlerë 749,800 lekë pa TVSH për procedurën e prokurimit me objekt “Automatizim të procedurave online në web”.

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera pa TVSH	Vlera me TVSH
1	Automatizim të procedurave online në web	Shërbim	1	749,800	749,800	899,760

- Me urdhrin nr. 280, datë 21.02.2022 për ndjekjen e zbatimit të marrjes në dorëzim nga Titullari i DPSHTRR është ngritur grupi i punës i përbërë nga E. Xh., M. Sh. dhe M. K.

- Me shkresën nr. 17797/1 Prot., datë 15.07.2022 grupi i marrjes në dorëzim i ka dërguar Sektorit të Financës dhe Sektorit të Prokurimit Publik Certifikatën e pranimit, datë 08.07.2022 ku rezulton se janë kryer procedurat e verifikimit të shërbimit dhe të plotësimit të specifikimeve teknike si dhe kushteve të tjera të përcaktuara në kërkesën për ofertë. Pagesa për kryerjen e shërbimit është bërë në datë 08.07.2022 me faturë tatimore nr. 1/2022 në vlerën 749,800 lekë pa TVSH.

- Grupi i auditimit ka konstatuar se DPSHTRR, nuk ka hartuar një raport përmbledhës mbi procedurën e prokurimit me objekt “Automatizim të procedurave online në web” siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe në nenin 84 të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji, autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të s’kualifikuar etj.

- Grupi i auditimit ka konstatuar se një sërë shkresash në dosjen e procedurës me vlerë të vogël me objekt “Automatizim të procedurave online në web” nuk janë protokolluar nga institucioni. Shkresat të cilave i mungon numri i protokollit janë:

1. Procesverbali mbi hapjen e ofertave;
2. Procesverbali mbi dorëzimin e dokumenteve të OE “O. C.” shpk;
3. Procesverbali mbi dorëzimin e një demo;
4. Procesverbali i shpalljes së fituesit.

Mungesa e siglimit të dokumenteve të mësipërme sjell mangësi dhe nuk jep gjurmë mbi vërtetësinë e shkresave zyrtare të dosjes së tenderit në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe me “Normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

- **Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Moduli në web për ndërveprimin me përdoruesit”.**

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 1800, datë 21.12.2022	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: M. A.	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit:
--	---	---

2. Fondi Limit (pa tvsh) 750,000 lekë	G. P. E. Ç.	M. A. G. P. E. Ç.
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: M. A. G. P. E. Ç.	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: M. A. G. P. E. Ç.
8. Data e hapjes së tenderit: 22.12.2022	9. Operatori fitues: “F. B. G.” Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 649,900 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 100,100 lekë
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 5 (pesë)	12. Operatore te Kualifikuar: 5 (pesë)	13. Operatorë të s’kualifikuar: -
14. Ankimimet: -	15. Përgjigje Ankesës nga AK -	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: -
17. Marrja në Dorëzim Datë 01.03.2023	18. Vlera e kontratës (me TVSh): 778,800 lekë	19. Afati i kontratës: 12 muaj

Nga auditimi u konstatua:

- **Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:** Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- **Hartimi i dokumenteve të tenderit:** Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- **Përzgjedhja e operatorit fitues:** Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 5 Operatorë Ekonomik. Komisioni i Blerjeve të Vogla ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:
Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël ka mbajtur procesverbal në datë 27.12.2022 në DPSHTRR për shpalljen e fituesit për ofertën e Operatorit Ekonomik të renditur në vendin e I “F.B. G.” me vlerë 649,900 lekë pa TVSH për procedurën e prokurimit me objekt “Moduli në web për ndërveprimin me përdoruesit”

- **Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit:**

Me shkresën nr. 27202/5 Prot., datë 30.12.2022 Titullari i DPSHTRR ka miratuar Urdhrin nr.1800/1 për ndjekjen e zbatimit të marrjes në dorëzim, për të cilën ka ngritur një grup pune për të përbërë nga F. K., E. Ç. dhe K. P. Me shkresën nr. 829/1 Prot., datë 13.01.2023 Titullari i DPSHTRR ka miratuar Urdhrin nr. 44/1 për një ndryshim në Urdhrin nr. 1800/1 për ndjekjen e zbatimit të marrjes në dorëzim ku kryetarja e grupit të punës F. K. është zëvendësuar nga L. P..

Në datë 28.02.2023 është bërë pagesa me faturën tatimore 202/2022 në vlerën 616,666.67 lekë pa TVSH, për 8 nga 9 zërat që janë pasqyruar në ftesën për ofertë. Për zërin nr. 9 “Menaxhimi i detyrave të ndryshme që i referohen përdoruesit” nga dokumentacioni dhe fatura tatimore që janë vënë në dispozicion nuk rezulton asnjë e dhënë vlerën totale 649,900 lekë pa TVSH për të cilën është objekti i prokurimit. Grupi i punës në shkresën nr. 27202/6 Prot., datë 01.03.2023

ka deklaruar se shërbimi është i plotë sipas nevojave të autoritetit dhe në sasinë e kërkuar në ftesën për ofertë.

Zhvillimi i kontratës:

- Njësia e Koordinimit të Shërbimeve dhe Projekteve Digjitale me shkresën nr. 27202 Prot., 21.12.2022 ka parashtruar një kërkesë Drejtorisë së Prokurimeve për fillimin e procedurës me objekt “Moduli në web për ndërveprimin me përdoruesit” ku ka bashkëlidhur edhe specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit.
- Me shkresën nr. 27202/2 Prot., datë 21.12.2022 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 1800, datë 21.12.2022 për prokurimin me vlerë të vogël nga titullari i DPSHTRR. Urdhri i prokurimit me vlerë të vogël ka si objekt “Moduli në web për ndërveprimin me përdoruesit” me fond limit 750,000 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e brendshme të institucionit.
- Më datë 22.12.2022 Komisioni i Blerjeve të Vogla ka mbajtur procesverbal për hapjen e ofertave për procedurën me objekt “Moduli në web për ndërveprimin me përdoruesit” për të cilën kanë ardhur 5 (pesë) oferta nga OE si më poshtë:

Operatori Ekonomik	Oferta ekonomike
F. B. G.	649,900
A. D.	685,000
O. T.	713,333
S.	725,000
J. G.	733,333

- Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël ka mbajtur procesverbal në datë 27.12.2022 në DPSHTRR për shpalljen e fituesit për ofertën e Operatorit Ekonomik të renditur në vendin e I “F. B. G.” me vlerë 649,900 lekë pa TVSH për procedurën e prokurimit me objekt “Moduli në web për ndërveprimin me përdoruesit”, me treguesit e çmimit si më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Njësia	Vlera pa TVSH	Vlera me TVSH
1	Moduli në web për ndërveprimin me përdoruesit	Shërbim	649,900	778,800
Totali				778,800

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Operatori Ekonomik “F.B.G.” kanë nënshkruar kontratën e shërbimit me shkresën nr. 27202/4 Prot., datë 29.12.2022 për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Moduli në web për ndërveprimin me përdoruesit” me vlerë 649,900 lekë pa TVSH.

- Me shkresën nr. 27202/5 Prot., datë 30.12.2022 Titullari i DPSHTRR ka miratuar Urdhrin nr. 1800/1 për ndjekjen e zbatimit të marrjes në dorëzim, për të cilën ka ngritur një grup pune për të përbërë nga F. K., E. Ç. dhe K. P.. Me shkresën nr. 829/1 Prot., datë 13.01.2023 Titullari i DPSHTRR ka miratuar Urdhrin nr. 44/1 për një ndryshim në Urdhrin nr. 1800/1 për ndjekjen e zbatimit të marrjes në dorëzim ku kryetarja e grupit të punës F. K. është zëvendësuar nga L.P. Me shkresën nr. 27202/6 Prot., datë 01.03.2023 grupi i punës ka kryer verifikimin e shërbimit përfundimtar si në tabelën më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia
1	Sistemi menaxhimit të problematikave sipas departamenteve	1
2	Login i përshtatur sipas udhëzuesit të institucionit	1
3	Administrimi i roleve sipas kategorisë të përdoruesit	1
4	Menaxhimi i problematikave sipas grupeve	1
5	Gjenerimi i statistikave sipas datave të filtruara	1
6	Mundësi për realizimin e analizave dhe raporteve të ndryshme	1
7	Sistemi i njoftimeve për të gjithë përdoruesit	1
8	Personalizimi i kontentit të emaileve që realizohen automatikisht	1
9	Menaxhimi i detyrave të ndryshme që i referohen përdoruesit	1

Përsa më sipër është kryer pagesa në datë 28.02.2023 me faturë tatimore 202/2022 në vlerën 616,666.67 lekë pa TVSH, për 8 nga 9 zërat që janë pasqyruar në tabelën e mësipërme. Për zërin nr. 9 “Menaxhimi i detyrave të ndryshme që i referohen përdoruesit” nga dokumentacioni dhe fatura tatimore që janë vënë në dispozicion nuk rezulton asnjë e dhënë për vlerën totale 649,900 lekë pa TVSH për të cilën është objekti i prokurimit. Grupi i punës në shkresën nr. 27202/6 Prot., datë 01.03.2023 ka deklaruar se shërbimi është i plotë sipas nevojave të autoritetit dhe në sasinë e kërkuar në ftesën për ofertë.

- Grupi i auditimit ka konstatuar se DPSHTRR nuk ka hartuar një raport përmbledhës mbi procedurën e prokurimit me objekt “Moduli në web për ndërveprimin me përdoruesit” siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe në nenin 84 të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji, autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të s’kualifikuar etj.

- Grupi i auditimit ka konstatuar se një sërë shkresash në dosjen e procedurës me vlerë të vogël me objekt “Moduli në web për ndërveprimin me përdoruesit” nuk janë protokolluar nga institucioni. Shkresat të cilave i mungon numri i protokollit janë:

1. Procesverbali mbi hapjen e ofertave;
2. Procesverbali mbi dorëzimin e dokumentave të OE “F. B. G.”;
4. Procesverbali i shpalljes së fituesit.

Mungesa e siglimit të dokumenteve të mësipërme sjell mangësi dhe nuk jep gjurmë mbi vërtetësinë e shkresave zyrtare të dosjes së tenderit në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe me “Normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

1.Titulli i gjetjes: DPSHTRR nuk ka hartuar raportet përmbledhës për procedurat e prokurimit.

Situata: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor nuk ka hartuar një raport përmbledhës për asnjë nga procedurat e prokurimit me vlerë të vogël që parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe në nenin 84 të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të s’kualifikuar etj.

Kriteri: Neni 99 i Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 84 i VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

Ndikimi/efekti: -

Shkaku: Mos zbatimi i praktikave më të mira në zhvillimin dhe menaxhimin institucional.

Rëndësia: E lartë

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse duhet të hartojë një raport përmbledhës për çdo procedurë me vlerë të vogël që do të zhvillojë në vijimësi.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 2, datë 13.11.2023, protokolluar në DPSHTRR me shkresën nr. 17659/2 datë 13.11.2023, si dhe është trajtuar në Projektraportin e Auditimit faqe 32-47, mbi të cilin janë paraqitur observacione protokolluar në KLSH me nr.599/3, datë 04.01.2024.

Pretendimi: Referuar Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, në nenin 41 citohet se: Për prokurimet me vlerë nën kufirin e ulët monetar të mallrave, shërbimeve, apo punëve, Autoriteti Kontraktor mund të përdorë procedura të thjeshtuara, të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Neni 84 i VKM nr.285, datë 19.05.2021 përcakton se raporti dërgohet për miratim pas afatit të ankimimit dhe përpara shpalljes së fituesit pas ankimimit. Në procedurat me vlerë të vogël,

Komisioni i ngritur në fillim të vitit nga titullari dhe i përbërë nga tre anëtarë, dokumenton të gjitha fazat e blerjes në procesverbale dhe vepron si Njësi Prokurimi dhe Komision vlerësues. Në procedurën me vlerë të vogël Komisioni shpall operatorin ekonomik fitues pas ankimimit në sistemin elektronik të prokurimeve duke e gjeneruar vetë sistemi pas përfundimit të afatit dy ditor. Gjithashtu referuar nenit 56 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, për procedurat me vlerë të vogël nuk zbatohen të gjitha dispozitat e LPP, si psh ofertat anomalisht të ulëta, afatet e ankimimit etj. Raporti përmbledhës hartohet nga KVO në rastet e procedurave mbi kufirin e ulët monetar, pasi me miratimin e këtij raporti nga titullari vijohet me shpalljen e fituesit pas ankimimit. Procedurat e blerjeve të vogla karakterizohen si të thjeshtuara dhe në shumicën dërrmuese të tyre janë me vlera financiare relativisht të ulëta. Kështu që hartimi i raportit përmbledhës do sillte kosto të efektivitetit në punë, duke ezauruar kohën për përpunimin e të dhënave të cilat praktikisht janë pjesë e procesverbaleve të mbajtura dhe e vetë raportit që gjeneron sistemi elektronik i prokurimeve. Për procedurat me vlerë të vogël të realizuara nga Institucioni ynë nuk është hartuar raport përmbledhës por është bërë pjesë e dosjes raporti i printuar nga sistemi elektronik, dhe nuk ka rezultuar gjetje në asnjë rast të Auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Sa më sipër mendojmë se veprimet e Komisionit nuk janë në kundërshtim me LPP nr.162, datë 23.12.2020, VKM nr.285, datë 19.05.2021 dhe Udhëzimin nr.5, datë 25.06.2021. Gjithashtu shpresojmë të merret në konsideratë pasi përpunimi i të dhënave për hartimin e këtij raporti është një barrë shtesë duke patur parasysh dinamikën që karakterizon procedurat me vlerë të vogël.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se, në asnjë prej dosjeve nuk ndodhet raporti përmbledhës që parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku thuhet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të s’kualifikuar etj. Argumenti juaj se hartimi i raportit do sillte kosto të efektivitetit në punë nuk merret në konsideratë, pasi mangësia e dokumentacioneve në dosjet e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël vërteton të kundërtën. Hartimi i një raporti bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi është një përmbledhje e procedurës së prokurimit në të cilën pasqyrohen të dhënat e saj dhe ndihmojnë në gjurmën e auditimit. *Për sa më lart, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.*

2. Titulli i gjetjes: Në dosjet e auditimit gjenden shkresa pa numrin e protokollit.

Situata: Nga auditimi u konstatua se në 4 dosjet e prokurimit me vlerë të vogël është konstatuar se pjesa më e madhe e shkresave zyrtare nuk janë protokolluar nga institucioni. Mungesa e numrit të protokollit nuk lë gjurmë mbi vërtetësinë e dokumenteve zyrtare të tenderit.

Kriteri: Ligji nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe “Normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

Ndikimi/efekti: Mungesa e numrit të protokollit nuk lë gjurmë mbi vërtetësinë e dokumentacionit.

Shkaku: Neglizhenca e personave përgjegjës mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit.

Rëndësia: E lartë

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të mbajë në konsideratë që çdo shkresë zyrtare pjesë e dosjes së procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, të jetë e protokolluar nga institucioni.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 2, datë 13.11.2023, protokolluar në DPSHTRR me shkresën nr. 17659/2 datë 13.11.2023, si dhe është trajtuar në Projektraportin e Auditimit faqe 32-47, mbi të cilin janë paraqitur observacione protokolluar në KLSH me nr.599/3, datë 04.01.2024.

Pretendimi: Lidhur me dokumentin e administruar në dosjen e prokurimit me vlerë të vogël i cili nuk rezulton të jetë i protokolluar sqarojmë se shkresat që grupi i auditimit ka cituar janë procesverbale origjinale dhe të mbajtura nga Komisioni i blerjeve të vogla. Firma e personave që firmosin, në rastin konkret Komisioni i blerjeve të vogla, është një dokument i rëndësishëm dhe i ligjshëm që dëshmon pjesëmarrjen, vullnetin dhe shrehjen e përgjegjësisë në procedurën e prokurimit. Komisioni ka kompetencat të dokumentojë me procesverbal të gjitha fazat e hapjes, vlerësimit, dorëzimit të dokumentacionit apo shpalljes së fituesit. Gjithashtu të gjitha këto veprime janë në sistemin elektronik të prokurimeve të kryera nga llogaritë e secilit anëtar. Sqarojmë se mosprotokollimi i procesverbaleve të firmosura nga personat pjesë e procedurës sjell përparësi dhe efikasitet në krahasim me zgjatjen që sjell procesi i protokollimit. Protokollimi i çdo procesverbali do shtonte një ngarkesë të panevojshme administrative dhe nuk sjell përfitim të drejtëpërdrejtë në monitorimin e procedurës pasi Komisioni i blerjeve të vogla ka kompetencën për të vlerësuar dhe realizuar procedurën. Përsa i përket dorëzimit të dokumentacionit, subjekti fitues në çdo rast i dorëzon në protokoll dhe më pas Komisioni i blerjeve të vogla mban procesverbal në lidhje me dokumentacionin e protokolluar nëse është në përputhje me ftesën për ofertë dhe kërkesat për kualifikim. Pra Komisioni bën vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur. Paraqitja e dokumentacionit është pjesë e procesit të vlerësimit të ofertës pasi në rast të paraqitjes me mangësi të dokumentave operatori ekonomik ofertues mund të skualifikohet. Pra është kompetencë e Komisionit të mbajë procesverbal për dorëzimin e dokumentacionit në formë të shkruar. Gjithashtu procesverbali është i sigluar nga të tre anëtarët e Komisionit dhe është mbajtur brenda afateve ligjore gjë që tregon vërtetësinë e dokumentit. Mosprotokollimi i procesverbaleve të firmosura nga personat pjesë e procedurës është procedurë që Institucioni ynë ka mbajtur dhe në procedurat që kalojnë kufirin monetar të blerjes së vogël dhe nuk ka rezultuar gjetje në asnjë rast të Auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Sa më sipër mendojmë se veprimet e komisionit nuk janë në kundërshtim me LPP nr.162, date 23.12.2020, VKMnr.285, date 19.05.2021, Udhëzimin nr.5, datë 25.06.2021 apo Ligjin nr.9154, date 06.11.2003 "Per arkivat". Gjithashtu shpresojmë të merret në konsideratë pasi mosprotokollimi mund të shihet si mase që redukton barrën administrative dhe përmirëson efikasitetin e procesit të prokurimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se, çdo procesverbal i mbajtur në çdo fazë duhet të firmoset nga të gjithë anëtarët si dhe të protokollohet nga institucioni për vërtetësinë e dokumentacionit si dhe lënien e gjurmës së auditimit. Shkresat që janë pjesë e dosjes jo të gjitha janë origjinale dhe rekomandimi për protokollimin e shkresave zyrtare është detyrim ligjor mbi vërtetësinë e tyre. Argumenti juaj nuk qëndron pasi çdo shkresë që është pjesë e dosjes duhet të jetë zyrtare dhe e protokolluar. *Për sa më lart, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.*

3.Titulli i gjetjes: DPSHTRR nuk ka llogaritur saktë vlerat e parashikuara për procedurat e prokurimit.

Situata: Nga grupi i auditimit u konstatua se për procedurat e prokurimit me objekt "Blerje USB Dongle-Security" e vitit 2022 dhe "Automatizim të procedurave online në web" për vitin 2022 fondi i miratuar është me TVSH në kundërshtim me nenin 34, pika 10 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Kriteri: Neni 34, pika 10 e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Ndikimi/efekti: Llogaritja jo e saktë e të dhënave bën që vlerat të mos rakordojnë me vlerat reale të procedurave të prokurimit.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore dhe nënligjore.

Rëndësia: E lartë

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor të marrë masa që për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël, të bëjë përlllogaritjen e vlerës pa TVSH në zbatim të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 2, datë 13.11.2023, protokolluar në DPSHTRR me shkresën nr. 17659/2 datë 13.11.2023, si dhe është trajtuar në Projektraportin e Auditimit faqe 32-47, mbi të cilin janë paraqitur observacione protokolluar në KLSH me nr.599/3, datë 04.01.2024.

Pretendimi: Në nenin 34, pika 1, e ligjit nr.162, date 23.12.2020 “ Për Prokurimin Publik” citohet: “Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti ose enti kontraktor, duke përfshirë çdo pagesë siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Kur autoriteti ose enti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, ai duhet t’i mbajë ato parasysh kur përlllogarit vlerën e prokurimit.

Me shkresën nr.23013 prot., date 07.10.2022, nga Drejtoria e Prokurimeve është kërkuar miratimi i fondit i cili sipas tabelës rezulton të jetë 950.000 leke pa tvsh. Me shkresën nr.23013/1 prot., date 12.10.2022 është miratuar fondi nga Drejtoria Ekonomike sipas të ciles konfirmohet fondi prej 1.140.000 leke me tvsh. Sqarojme se nga komisioni i blerjeve të vogla është testuar tregu dhe fondi është dërguar për miratim pa tvsh. Drejtoria ekonomike e cila ka kompetencë menaxhimin dhe miratimin e fondeve, ka miratuar fondin limit të procedurës në total se bashku me vlerën e tvsh-së, por nga komisioni është respektuar dispozita ligjore dhe rezulton që llogaritja e vlerës së parashikuar është bazuar në testimin e tregut referuar çmimeve pa tvsh.

Sa më sipër mendojmë se veprimet e komisionit nuk janë në kundërshtim me LPP nr.162, date 23.12.2020, VKM nr.285, date 19.05.2021, apo Udhëzimin nr.5, datë 25.06.2021. Shpresojme të merret në konsideratë nga ju riargumentimi ynë, pasi nga ana e komisionit është zbatuar me përpikëri dispozita ligjore e cituar me sipër mbi përlllogaritjen e fondit limit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se, për procedurat e prokurimit me objekt “Blerje USB Dongle-Security” dhe “Automatizim të procedurave online në web” fondi i miratuar është me TVSH në kundërshtim me nenin 34, pika 10 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku thuhet se “Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti ose enti kontraktor, duke përfshirë çdo pagesë siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Kur autoriteti ose enti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, ai duhet t’i mbajë ato parasysh kur përlllogarit vlerën e prokurimit”. Për sa më lart, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

4.Titulli i gjetjes: DPSHTRR nuk ka hartuar specifikimet teknike para nxjerrjes së Urdhrit të Prokurimit.

Situata: DPSHTRR për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje USB Dongle-Security” për vitin 2022 ka nxjerrë urdhrin e prokurimit para se të bënte përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta në kundërshtim me nenin 56, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” dhe me pikën 7 të Udhëzimit nr. 05, datë 25.06.2021.

Kriteri: Neni 56, pika 4 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” dhe pika 7 e Udhëzimit nr. 05, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Ndikimi/efekti: -

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore dhe nënligjore.

Rëndësia: E lartë

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa për zbatimin kronologjik të dispozitave ligjore dhe nënligjore për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël që do të zhvillojë.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 2, datë 13.11.2023, protokolluar në DPSHTRR me shkresën nr. 17659/2 datë 13.11.2023, si dhe është trajtuar në Projektraportin e Auditimit faqe 32-47, mbi të cilin janë paraqitur observacione protokolluar në KLSH me nr.599/3, datë 04.01.2024.

Pretendimi: Ne lidhje me specifikimet teknike për të cilat grupi i auditimit shprehet se janë hartuar pas nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit sqarojmë se specifikimet teknike për këtë procedurë janë dërguar nepermjet emailit zyrtar nga drejtuesi i Njesise së Personalizimit z.A. Sh.Emaili i ardhur me datë 04.10.2022 ka të bashkelidhur specifikimet teknike dhe rekomandimin e AKSHI-t për fillimin e procedurës. Emaili gjendet i bashkelidhur me urdhrin e prokurimit në dosjen perkatese të procedurës.

Dispozitat ligjore që rregullojnë dokumentin zyrtar perfshijne si forme paraqitje të dokumentit edhe dokumentin elektronik në të cilin perfshihet dhe emaili zyrtar.

Emaili zyrtar është një dokument elektronik i cili verteton dhe ploteson kriteret e autenticitetit dhe konsiderohet dokument zyrtar. Institucioni ynë e ka përdorur këtë formë komunikimi për shkak të formës së procedurës “Blerje e vogël”, dhe mënyrës së shpejte dhe efektive të realizimit. Gjithashtu emaili i dërguar mbi specifikat e mallit që do të blihet për procedurën e sipërpermendur është dërguar nga Drejtuesi i Njesise, i cili ka tagrin edhe të sigloje shkresën zyrtare nëse do të ishte dërguar dokumenti i printuar.

Sa më sipër mendojmë se veprimet e komisionit nuk janë në kundërshtim me LPP nr.162, datë 23.12.2020, VKMnr.285, datë 19.05.2021 dhe Udhëzimin nr.5, datë 25.06.2021. Shpresojmë që të merret në konsideratë riargumentimi ynë pasi kemi të bëjmë me dokument të dërguar nga emaili zyrtar i një zyrtari drejtues në një nga strukturat e DPSHTRR-se.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se, email-i bashkelidhur dosjes së procedurës së prokurimit nuk është dokumenti zyrtar sipas formatit të kërkuar nga dispozitat ligjore dhe nënligjore mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim. *Për sa më lart, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.*

5.Titulli i gjetjes: Operatori Ekonomik fitues nuk ka dorëzuar demo-n brenda afatit të përcaktuar.

Situata: Nga grupi i auditimit u konstatua se demo e sjellë në DPSHTRR nga OE “O. C.” për procedurën e prokurimit me objekt “Automatizim të procedurave online web” për vitin 2022 ka qenë jashtë afatit të përcaktuar në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 16 ku thuhet se: “Operatori Ekonomik duhet të paraqitet pranë autoritetit kontraktor brenda 24 orëve nga momenti i njoftimit të fituesit dhe duhet të dorëzojë me usb/cd një demo të aplikacionit mobile të instalueshëm në platformën Android (duke plotësuar të gjitha kërkesat sipas specifikimeve teknike)”.

Kriteri: Udhëzimi nr. 05, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 16 dhe Kriteret e veçanta të kualifikimit në ftesën për ofertë mbi procedurën e prokurimit me vlerë të vogël.

Ndikimi/efekti: Vlerësim në mënyrë jo të duhur të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Shkaku: Mos zbatim i dispozitave ligjore dhe nënligjore.

Rëndësia: E lartë

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël duhet të sigurohet që operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet e përcaktuara në ftesën për ofertë, në zbatim të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 2, datë 13.11.2023, protokolluar në DPSHTRR me shkresën nr. 17659/2 datë 13.11.2023, si dhe është trajtuar në Projektraportin e Auditimit faqe 32-47, mbi të cilin janë paraqitur observacione protokolluar në KLSH me nr.599/3, datë 04.01.2024.

Pretendimi: Dokumentacioni në formë të shkruar së bashku me demon e aplikacionit është paraqitur nga subjekti fitues brenda afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë sipas procesverbalit të datës 17.02.2023. Pra demo ka qenë pjesë e dokumentacionit të dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar në ftesën për ofertë. Komisioni ka mbajtur një procesverbal më vete, së bashku me specialistin e fushës znj.E.K. në datën 18.02.2023 me qëllim verifikimin se demo e aplikacionit është sipas formatit të kërkuar dhe në përputhje me specifikimet teknike. Pas konfirmimit se demo është në përputhje me specifikimet teknike Komisioni ka dërguar njoftimin e fituesit për të vijuar me pritjen e afatit të ankimit. Pra demoja është dorëzuar në datën 17.02.2023 bashkëlidhur dokumentave në protokollin e DPSHTRR-së.

Sqarojmë se veprimet e Komisionit nuk janë në kundërshtim me LPP nr.162, datë 23.12.2020, VKM nr.285, datë 19.05.2021, apo Udhëzimin nr.5, datë 25.06.2021 dhe shpresojmë të merret në konsideratë pasi afatet e përcaktuara në ftesën për ofertë janë respektuar nga operatori ekonomik dhe Komisioni i blerjeve të vogla.

***Qëndrimi i grupit të auditimit:** Sqarojmë se, pas hapjes së ofertave në datë 15.02.2022 dhe brenda afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë i cili ishte 24 orë, OE fitues duhet të kishte dorëzuar një demo sipas kërkesave të veçanta për kualifikim nga vetë institucioni. Dorëzimi i dokumenteve të OE është bërë në datë 17.02.2022 dhe demo e aplikacionit mobile të instalueshëm në platformën Android është dorëzuar në datë 18.02.2022, pra jashtë afatit të përcaktuar. Për sa më lart, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.*

b. Marrëveshjet e nivelit të shërbimit

Procedurat e prokurimit që ka kryer AKSHI, ku për periudhën objekt auditimi ku përfitues është DPSHTRR, janë:

Nr	Procedura	Periudha e zbatimit	Vlera totale e kontratës në lekë, pa TVSH
1	Implementimi i platformës elektronike e Transport	12 muaj implementim dhe 48 muaj mirëmbajtje	188,652,000
2	Plotësimi i Sistemit të Lejedrejtimit EDM	6 muaj implementim dhe 48 muaj mirëmbajtje	156,200,000
3	Upgrade i sistemit e DPSHTRR	6 muaj implementim dhe 24 muaj mirëmbajtje	100,988,920
4	Përmirësim i e DPSHTRR dhe financiar	12 muaj implementim	265,888,000
5	Fiskalizimi	6 muaj implementim	50,780,000

Nga procedurat që zbatohen në DPSHTRR, grupi auditoi zbatimin mbi procedurat si më poshtë:

I. Zbatimi i kontratave dhe marrëveshjeve në nivel shërbimi për kontratën me nr.4698, datë 24.09.2020.

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës nr.4698, datë 24.09.2020 me objekt “*Implementimi i platformës elektronike eTransport*”, me vlerë 188,652,000 lekë pa TVSH, ku vlera e

implementimit është 131,700,000 lekë pa TVSh me afat implementimi 12 muaj dhe vlerë mirëmbajtje 56,952,000 lekë pa TVSh dhe me afat 48 muaj nga ata e lidhjes së kontratës.

Nga auditimi u konstatua se kjo kontratë është nënshkruar nga 3 palët që përfshihen në këtë kontratë, që janë: Autoriteti Kontraktor - AKSHI, Operatori Ekonomik dhe Autoriteti Përfitues-DPSHTRR.

DPSHTRR nuk është vetëm përfitues i këtij shërbimi, por është dhe Autoriteti që ka kryer pagesën e implementimit dhe vijon të kryejë pagesat e mirëmbajtjes për 48 muaj që shërbimi është kontraktuar.

Nisur nga fakti që për ndjekjen e zbatimit të kontratës, DPSHTRR është përfaqësuar nga një punonjës z.O.C., ndërsa AKSHI me 3 punonjës, por që nuk janë njohës të proceseve të punës në eTransport.

Sipas dokumentacionit që disponon ndjekësi i kontratës, punonjës i DPSHTRR-s, implementimi ka përfunduar në datën 23.09.2021. Pas kësaj periudhe ka filluar faza e mirëmbajtjes, për të cilën pjesa më e madhe e raportimit është administruar nëpërmjet sistemit të menaxhimit të kontratave.

Nga auditimi u konstatua se DPSHTRR është përfaqësuar vetëm nga një punonjës në profilin jurist për ndjekjen e kontratës me nr. 4698, datë 24.09.2020 me objekt “Implementimi i platformës elektronike eTransport”, ndryshe nga praktikat e ndjekura për ndjekjen e kontratave të tjera në shërbime informatike. Me 3 përfaqësues nga AKSHI si AK dhe 1 përfaqësues nga DPSHTRR si Operator Përfitues, është formuar një grup prej 4 firmëtarësh në ndjekjen e kontratave duke mos respektuar numrin tek të punonjësve në këtë grup. DPSHTRR nevojitet të marrë masa për shtimin e një punonjësi njohës i proceseve dhe të të dhënave që përpunohen në të, për ndjekjen e kontratës në periudhën e mbetur nisur nga volumi i kontrolleve që janë raportuar në 6 muaj të vitit 2023.

Nisur nga kushtet e vendosura në kontratë, për sa i takon pranimit të shërbimit në nenin 10/ pika 10.3 cilësohet se “Dorëzimet do të quhen të pranuar në çdo rast, për veçse kur Autoriteti Kontraktor identifikon tek to mangësi të tilla që:

- a. Pengojnë funksionimin e komponentëve objekt të kësaj kontrate nga përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe Përfituesit e shërbimit, apo palë të tjera;
 - b. Shkaktojnë kufizime në realizimin e funksioneve të rëndësishme të komponentëve objekt të kësaj kontrate, të tilla që nuk mund të zgjidhen brenda një intervali të arsyeshëm kohe.
 - c. Janë zgjidhje provizore që mundësojnë funksionimin e shërbimit por nuk janë konform standardeve teknike apo pengojnë ri zhvillimin në kohë të mëvonshme.
 - d. Performanca e funksionaliteteve është e ulët dhe e padobishme për institucionin përfitues.
- Kontraktuesi duhet të zgjidhë çdo mangësi që mund të jetë evidentuar nga përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe Përfituesit të shërbimit në protokollet e pranimit.

Nëse ndonjë nga testimet e pranimit nuk është realizuar brenda 3 ditë pune nga data e instalimit të dorëzimeve, ose nëse përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe Përfituesit nuk kanë njoftuar që dorëzimet janë të pranuar brenda afatit 3 ditor, atëherë dorëzimet konsiderohen të pranuar.

Nga auditimi u konstatua se nënshkrimi i dokumenteve periodikë që janë Shkresa përcjellëse, Raporti Mujor, Fatura dhe Procesverbali, janë nënshkruar elektronikisht në sistemin e menaxhimit të kontratave pothuajse në të gjitha rastet pas 30 ditësh ose më shumë.

Bazuar në të dhënat që nevojiten të kontrollohen në raportet periodike si nga AK ashtu dhe nga OP si dhe detyrat e tjera funksionale që mbulojnë në pozicionin e punës që ndodhen ndjekësit e kontratës, vlerësojmë se afati i përcaktuar në kontratë prej 3 ditësh nuk është në favorin e AK dhe Operatorit Përfitues, por të Operatorit Ekonomik.

Nga auditimi u konstatua se në raportimin e muajit korrik 2023 nga ana e OE, jo të gjitha janë zgjidhur deri në korrik të vitit 2023. Po në këtë muaj nuk është pranuar nga përfaqësuesi i DPSHTRR-s marrja e shërbimit, duke e kthyer dokumentacionin me shënimin mbi çështje që janë ende në proces. OE ka vepruar në të njëjtën periudhë për zgjidhjen e tyre, por aktualisht API për mobile i këtij sistemi nuk gjendet i publikuar në platformat e sistemeve IOS dhe Android.

Nga sa vihet re në raportet e mirëmbajtjes, nga OE është raportuar se është përshtatur browseri për mobile dhe tabletë. API aktualisht mund të shërbejë si mjet informues, pasi bileta që është produkti përfundimtar i këtij informatizimi, do të përfundojë në një fazë tjetër të projektit.

II. Zbatimi i kontratave dhe marrëveshjeve në nivel shërbimi për kontratën me nr.4721, datë 06.08.2019.

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës nr.4721, datë 06.08.2019 me objekt “*Upgrade i sistemit qendror eDPSHTRR, pajisjet HW dhe aplikimit eDPSHTRR. Ridizenjim i infrastrukturës HW dhe ndërtimi i sistemit të menaxhimit. Upgrade i sistemeve operative të serverave dhe databazës eDPSHTRR. Upgrade i sistemit informatik eDPSHTRR, përmirësimi i funksionaliteve aktuale, shtim shërbimesh*”, me vlerë 100,988,920 lekë pa TVSh. Vlera e implementimit për këtë kontratë është 67,901,920 lekë pa TVSh me afat implementimi 6 muaj nga data e lidhjes së kontratës dhe vlera e mirëmbajtjes është 33,387,000 lekë pa TVSh me afat 24 muaj nga lidhja e kontratës.

Gjatë periudhës objekt auditimi kjo kontratë ka qenë në periudhën e mirëmbajtjes, ndërkohë që 4 muajt e fundit të mirëmbajtjes shkurt, mars, prill, maj 2022, janë ndjekur dhe nëpërmjet sistemit të menaxhimit të kontratave SMK.

Nga auditimi u konstatua se dokumentet respektive për muajt shkurt – maj, që janë Shkresa përcjellëse, raporti mujor dhe fatura, janë nënshkruar elektronikisht nga OE që ka bërë dhe ngarkimin e tyre në sistemin e menaxhimit të kontratave, por nuk janë nënshkruar elektronikisht nga ndjekësit e kontratës. Kjo periudhë duke qenë se përkon me fillimin e vënies në punë të sistemit SMK, dokumentacioni është kërkuar të dorëzohet dhe fizikisht në DPSHTRR, nisur nga problemet e sistemit të menaxhimit të kontratave.

Nga auditimi mbi dokumentacionin fizik të mirëmbajtjes, për periudhën 28 shkurt - 27 mars, protokolluar në DPSHTRR me shkresën përcjellëse nr.7884, datë 28.03.2022, u konstatua se:

- Faturat janë nënshkruar nga OE respektivë dhe vetëm nga një përfaqësues i grupit të ndjekjes së kontratës V. M..
- Raporti mujor i shërbimit të mirëmbajtjes, për periudhën 28.02.2022-27.03.2022 është nënshkruar nga përfaqësues të I, I., AKSHI dhe DPSHTRR.
 - Përfaqësues të AKSHIT që kanë nënshkruar janë: E. L. dhe Dh. L..
 - Përfaqësues të DPSHTRR që kanë nënshkruar janë: L. Ll., V. M. dhe E. T..
- Listat e kontroleve periodike realizuar brenda këtij muaji, janë nënshkruar vetëm nga një përfaqësues i grupit të ndjekjes së kontratës V. M..

Akt marrja në dorëzim e hartuar nga grupi i ndjekjes së kontratës për shërbimin dhe dokumentimin e tij është nënshkruar nga të 5 anëtarët.

Nga auditimi mbi dokumentacionin fizik të mirëmbajtjes, për periudhën 28 mars - 27 prill, protokolluar në DPSHTRR me shkresën përcjellëse nr.11873, datë 28.04.2022, u konstatua se:

- Faturat janë nënshkruar nga OE respektivë dhe vetëm nga një përfaqësues i grupit të ndjekjes së kontratës V. M..

- Raporti mujor i shërbimit për periudhën 28.03.2022-27.04.2022 është nënshkruar nga përfaqësues të I., I., AKSHI dhe DPSHTRR.
 - Përfaqësues të AKSHIT që kanë nënshkruar janë: E. L. dhe Dh. L.
 - Përfaqësues të DPSHTRR që kanë nënshkruar janë: L. Ll., V. M. dhe E. T.
- Listat e kontroleve periodike realizuar brenda këtij muaji, janë nënshkruar vetëm nga një përfaqësues i grupit të ndjekjes së kontratës V. M.. Në një rast lista e kontrollit e datës 22.04.2022, është nënshkruar nga një tjetër përfaqësues i grupit të ndjekjes së kontratës L. Ll.. Akt marrja në dorëzim e hartuar nga grupi i ndjekjes së kontratës për shërbimin dhe dokumentimin e tij është nënshkruar nga 4 anëtarë, ndërsa nuk është nënshkruar nga E. T. anëtar përfaqësues i DPSHTRR-s.

Nga auditimi mbi dokumentacionin fizik të mirëmbajtjes, për periudhën 28 prill - 27 maj, protokolluar në DPSHTRR me shkresën përcjellëse nr.14353, datë 31.05.2022, u konstatua se:

- Faturat janë nënshkruar nga OE respektivë dhe vetëm nga një përfaqësues i grupit të ndjekjes së kontratës V. M..
- Raporti mujor i shërbimit për periudhën 28.04.2022-27.05.2022 është nënshkruar nga përfaqësues të I., I., AKSHI dhe DPSHTRR.
 - Përfaqësues të AKSHIT që kanë nënshkruar janë: E. L..
 - Përfaqësues të DPSHTRR që kanë nënshkruar janë: L. Ll., V. M..
- Listat e kontroleve periodike brenda muajit aktual të shërbimit janë nënshkruar nga I. S. dhe V. M., ndërsa lista e kontrollit e datës 20.05.2022 për shërbimet infrastrukturore, nuk është nënshkruar nga asnjë palë. Akt marrja në dorëzim e hartuar nga grupi i ndjekjes së kontratës për shërbimin dhe dokumentimin e tij është nënshkruar nga 3 anëtarë, ndërsa nuk është nënshkruar nga E. T. anëtar përfaqësues i DPSHTRR-s dhe A. H. anëtar përfaqësuese e AKSHI-t.

Nga auditimi mbi dokumentet elektronike të ngarkuara në sistemin e ndjekjes së kontratave u konstatua se, është ngarkuar në sistem një urdhër me nr.4721/7 prot, datë 28.06.2022 ku një nga anëtarët e ndjekjes së kontratës, përfaqësues i AKSHI-t është zëvendësuar me një tjetër anëtar, në kushtet kur në këtë periudhë ndjekja e kontratës ka përfunduar me raportin e fundit të mirëmbajtjes dorëzuar për periudhën 28 prill - 27 maj të vitit 2022.

Megjithëse DPSHTRR është institucion përfitues i disa shërbimeve kontratat e të cilave janë nënshkruar nga AKSHI, punonjësit që kryejnë detyrat e ndjekjes së kontratës nuk janë informuar për detyrat dhe përgjegjësitë e këtij roli që kryejnë në SMK. Audituesit e teknologjisë së informacionit të KLSH-s kanë konstatuar parregullsi apo mangësi në sistemin e menaxhimit të kontratave dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve ku dhe është rekomanduar të kërkohen rregullimet përkatëse që sjellin impakt tek punonjësit e institucioneve që angazhohen për ndjekjen e kontratës.

1.Titulli i gjetjes: Nënshkrimet e kontratave të shërbimit me Autoritet Kontraktor AKSHI-n, nuk janë kryer sipas të njëjtës praktikë.

Situata: Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave u konstatua se:

1. Nuk është ndjekur e njëjta praktikë në drejtim të nënshkrimit të marrëdhënies kontraktuale, megjithëse jemi në kushtet që asetet ndodhen në regjistrin e DPSHTRR-s dhe pagesat për këto kontrata kryhen nga ky institucion:

- Kontrata me nr.4698, datë 24.09.2020 me objekt “*Implementimi i platformës elektronike eTransport*” është nënshkruar ndërmjet 3 palëve që janë: Autoriteti Kontraktor që është AKSHI, Autoriteti Përfitues që është DPSHTRR si dhe Operatorit Ekonomik.

- Kontrata me nr.4721, datë 06.08.2019 me objekt “Upgrade i sistemit qendror eDPSHTRR...” është nënshkruar ndërmjet 2 palëve që janë: Autoriteti Kontraktor që është AKSHI dhe Operatorit Ekonomik.

2. Nuk është ndjekur e njëjta praktikë në caktimin e punonjësve ndjekës të kontratave, ku:

- Për kontratën me nr.4698, datë 24.09.2020 me objekt “Implementimi i platformës elektronike eTransport”, institucioni i DPSHTRR-s përfaqësohet me 1 punonjës ndërsa AKSHI me 3 punonjës;

- Për kontratën me nr.4721, datë 06.08.2019 me objekt “Upgrade i sistemit qendror eDPSHTRR...” institucioni i DPSHTRR-s përfaqësohet me 2 punonjës ndërsa AKSHI me 3 punonjës;

Kriteri: -

Ndikimi/Efekti: Ndjekja e kontratave të nënshkruara nga AKSHI, shërbimet e të cilave kryhen në asete të cilat janë në regjistrat e Autoritetit Përfitues, nuk mund të trajtohen në të njëjtën mënyrë me ndjekjen e kontratave të nënshkruara nga AKSHI, për të cilat shërbimet kryhen në asete të cilat janë aktualisht regjistrat e AKSHIT.

Shkaku: Mirë administrimi i fondeve është detyrë e nivelit drejtues të çdo institucioni dhe veprimet financiare të një institucioni nuk mund të urdhërohen nga drejtues i një institucioni tjetër për arsye se kjo bie ndesh me disa nga aktet ligjore më të rëndësishme në vend.

Rëndësia: E lartë

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masa për përcaktimin e termave në kontratë dhe nënshkrimin e tyre me përfaqësimin e dy institucioneve që janë AKSHI si Autoriteti Kontraktor dhe DPSHTRR si Autoriteti Përfitues, për investime në teknologjinë e informacionit apo shërbime që aplikohen mbi asete të cilat ndodhen në regjistrat e aktiveve të institucioneve përfitues të shërbimit.

1.2 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masa që në çdo kontratë investimi apo shërbimi në teknologjinë e informacionit ku asetet hardware dhe software regjistrohen në institucionin përfitues, numri i ndjekësve të kontratës nevojitet të jetë një numër tek punonjësish, ku numri më i lartë të jetë nga Institucioni Përfitues si ndjekës dhe monitorues i funksionaliteteve dhe administrator i fondeve të shpenzuara në drejtim të teknologjisë së informacionit.

Sistemi informatik i dedikuar për menaxhimin e kontratave - SMK, prej fillimit të vitit 2022 ka filluar të popullohet me kontratat ku AKSHI është në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe është menduar t’ju vijë në ndihmë AK, kontraktuesve, institucioneve përfituese dhe personave përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave, duke ruajtur të gjithë dokumentacionin teknik si dhe duke monitoruar mbarëvajtjen e gjithë procesit deri në përfundimin e zbatimit të kontratës. Krahas përfitimeve që kryerja e veprimeve në një proces të informatizuar mund të ketë, konstatohen de problematika të cilat nevojiten të raportohen nga përdoruesit fundor të tij të cilët janë në rolet e ndjekësve të kontratës, pavarësisht faktit nëse janë punonjës të Autoritetit Kontraktor apo Autoritetit Përfitues.

Nga auditimi mbi rregulloren dhe manualin e përdorimit të Sistemit të Menaxhimit të Kontratave që shërbejnë si dokumentacionin udhëzues për ndjekësit e kontratës, u vu re se nuk jepet informacion udhëzues se:

- Cilat veprime kryhen nga përdoruesit që janë në rolin e ndjekësit të kontratës dhe punonjës i financës, dy role që nevojiten të përdoren nga DPSHTRR;

- Cili dokument duhet të pajiset me një numër protokollit e cili prej tyre jo, si element kontrolli i ndjekësve të kontratës;

- Cili dokument nevojitet të aprovohet dhe nënshkruhet elektronikisht nga ndjekësit dhe cili dokument aprovohet dhe nënshkruhet nga punonjësit e financës.

Pra në zbatim të cilit akt ligjor veprohet në këtë sistem;

- Çfarë raportesh realizohen në këtë sistem si ndjekës kontrate apo punonjës finance.

2.Titulli i gjetjes: Nga auditimi u konstatuan disa problematika që i paraqiten ndjekësit të kontratës dhe punonjësit të financës, dy funksione që përmbushen nga DPSHTRR në sistemin e menaxhimit të kontratave - SMK.

Situata: Nga auditimi mbi ndjekjen e zbatimit të kontratave nëpërmjet sistemit të menaxhimit të kontratave-SMK, u konstatuan disa problematika që i paraqiten ndjekësit të kontratës dhe punonjësit të financës, dy funksione që përmbushen nga Autoriteti Përfitues i shërbimeve të cilat janë:

- Dokumenti i paraqitur nga OE pasi është kthyer nga ndjekësit e kontratës për korrigjim nuk pajiset me numrin e protokollit që ka marrë dokumenti kur ngarkohet për herë të parë, por ndjekësit janë të detyruar të nënshkruajnë dokumentin e radhës pa numër dhe datë protokollit;
- Sistemi është konceptuar dhe ndërtuar për nënshkrime në grup të dokumenteve periodike si dhe dokumenteve përfundimtare të zbatimit të kontratës, megjithëse aprovimi dhe nënshkrimi i dokumenteve do të duhej të ishte më dinamik, duke patur parasysh se fatura nuk mund të nënshkruhet nëse nuk është konfirmuar marrja e shërbimit të realizuar, ose procesverbali i pranimit të shërbimit nuk mund të nënshkruhet përpara se raporti të jetë nënshkruar.

Fatura elektronike nevojitet të gjenerohet vetëm dhe vetëm pasi shërbimi apo produktet e ofruara janë pranuar nga grupi i marrjes në dorëzim apo ndjekësit e kontratës;

- Plani i zbatimit të kontratës nuk nënshkruhet nga OE dhe ky dokument nuk pajiset me numër dhe datë protokollit;
- Procesverbali i gjeneruar automatikisht nga sistemi në fakt duhet të ishte një akt-pranimi me të drejta editimi dhe jo një model i standardizuar për arsye se grupi në rast se duhet të dokumentojë një veprim, i nevojitet të mbajë një tjetër dokument të quajtur procesverbal dhe ta ngarkojë atë në sistem në formatin pdf si dokumentet e tjerë;
- Dokumentet e ngarkuar nga anëtarë të grupit të ndjekjes së kontratës nuk marrin numër dhe datë protokollit;
- Nuk janë mundësuar kërkime me numër protokollit, raporte të ndryshme që nevojiten të gjenerojë çdo përdorues me qëllim kontrollimin e veprime të kryera prej tij.

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;

VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;

Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;

Rregullorja e përdorimit të sistemit të menaxhimit të kontratave - SMK;

Ndikimi/Efekt: Mangësitë e sistemit SMK, janë hapësira që krijojnë mundësinë që ndjekja të mos jetë në përputhje me aktet ligjore që rregullojnë zbatimin e kontratës.

Shkaku: Mënyra e konceptimit, ndërtimi i sistemit jo konform me aktet ligjore që rregullojnë ndjekjen e kontratave

Rëndësia: E lartë

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, të adresojë tek AKSHI si Autoritet Kontraktor për Sistemin e Menaxhimit të Kontratave – SMK, problematikat e konstatuara nga auditimi gjatë përdorimit të këtij sistemi, që nevojiten të zgjidhen me qëllim sigurimin e veprimeve të duhura dhe gjurmimin e tyre gjatë zbatimit të kontratave, për të paktën dy pozicionet që DPSHTRR përfshihet si ndjekës kontrate dhe punonjës finance.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.4, datë 13.11.2023, protokolluar në DPSHTRR me nr. 17659/4, datë 13.11.2023 si dhe trajtuar në faqet 48-53 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione.

III.2.3 Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat Input / Output.

Në zbatim të pikës 3 “*Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat Input / Output*”, është audituar sistemi informatik eDPSHTRR.

Në DPSHTRR janë ushtruar auditime nga:

- Komisioneri për të drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili ka marrë vendimin nr.51, datë 24.11.2022, dokumentuar në shkresën nr.381/2 prot, datë 24.11.2022;
- Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike - AKCESK, i cili në përfundim të auditimit mbi infrastrukturën kritike të sistemeve EDM dhe eDPSHTRR, ka dërguar raportin e protokolluar në DPSHTRR me shkresën nr.18177/2, datë 30.09.2021.

Ky sistem është ndërtuar si pjesë e kontratës me objekt “*Automatizim i Aktivitetit të DPSHTRR-së*”, objektivat e të cilit ishin:

- Ndërtimi i infrastrukturës HW qendrore dhe backup;
- Informatizimi i shërbimeve të Regjistrimit të Mjeteve dhe krijimi i Regjistrimit Elektronik Kombëtar të mjeteve;
- Informatizimi i shërbimeve për mbledhjen e taksave;
- Informatizimi i shërbimeve për lëshimin e Licencave dhe Certifikatave për ata që ushtrojnë veprimtari në fushën e shërbimeve të transportit rrugor si edhe për mjetet e tyre;
- Raportimin dhe administrimin e gjobave të kontrollit rrugor.

Sistemi eDPSHTRR është bërë upgrade në vitin 2019 me kontratën me objekt “*Upgrade i sistemit qendror eDPSHTRR, pajisjet HW dhe aplikimet eDPSHTRR. Ridizenjim i infrastrukturës HW dhe ndërtimi i sistemit të menaxhimit. Upgrade i sistemeve operative të serverave dhe databazës eDPSHTRR. Upgrade i sistemit informatik eDPSHTRR, përmirësimi i funksionaliteteve aktuale, shtim shërbimesh*” - Për DPSHTRR, objektivat e të cilit ishin:

- Informatizimi i disa shërbimeve, në lidhje me regjistrimin e mjetit të cilat nuk ofroheshin elektronikisht;
- Riinxhinierime, ndryshime në funksionalitete, si dhe rregullime të problematikave të sistemit;
- Upgrade i infrastrukturës të sistemit eDPSHTRR;
- Upgrade i sistemeve operative të serverave dhe databazës eDPSHTRR;
- Ndërtimi i raporteve të reja;
- Mirëmbajtjen e sistemit të përmirësuar pas implementimit.

Në sistemin eDPSHTRR kemi disa dhënës informacioni me të cilët popullohet baza e të dhënave. Më konkretisht, dhënësit e informacionit për sistemin eDPSHTRR janë:

- Qendra Kombëtare e Biznesit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Nëpërmjet tyre, sistemi i eDPSHTRR popullon bazën e të dhënave me informacionin bazë të Aplikantëve, të cilët mund të jenë Individë ose Biznese;
- Sistemi eDPSHTRR ndërvepron me Sistemin e Interpolit dhe Sistemin Maha-VR. Nëpërmjet tyre, sistemi i eDPSHTRR në varësi të përgjigjes dhe të kriterëve të shërbimit lejon/pengon marrjen e tij;
- Sistemi eDPSHTRR ndërvepron me Sistemin e Tatimeve për procedurat e fiskalizimit;
- Të dhënat doganore popullohen në sistem nga specialisti përkatës, pasi raporti eksportohet manualisht nga sistemi ASYCUDA.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor është Operator Administrues i sistemeve eDPSHTRR dhe eDM në listën e infrastrukturave kritike, miratuar me VKM nr.553, datë 15.07.2020 “Për miratimin e listës së Infrastrukturave Kritike të Informacionit dhe të listës së Infrastrukturave të Rëndësishme të Informacionit”, e ndryshuar me VKM nr.761, datë 12.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 553, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave”.

Mirëmbajtja për sistemin eDPSHTRR është kontraktuar nga AKSHI tek të tretë me kontratën nr.4721, datë 06.08.2019, me afat 6 muaj implementim dhe 24 muaj mirëmbajtje. Me kërkesë të DPSHTRR, nisur nga arsye të shkaktuara nga periudha pandemike, kësaj kontrate i janë bërë dy amendime të cilat kanë shtyrë afatin e implementimit dhe të mirëmbajtjes, duke përcaktuar një afat të përfundimit të mirëmbajtjes maj 2022.

Me përfundimin e kontratës, nuk është kontraktuar shërbim për mirëmbajtjen e këtij sistemi. DPSHTRR i është drejtuar AKSHI-t me kërkesën me nr.14002 prot., datë 24.05.2022, për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes pa kosto shtesë deri në finalizimin e procedurës së prokurimit dhe nënshkrimit të kontratës se re, nisur nga kushtet që kontrata për shërbimin e mirëmbajtjes me nr.4721, datë 06.08.2019, përfundon në datën 27.05.2022. Sistemi eDPSHTRR duke qenë sistem kritik, incidentet që mund të ndodhin gjatë periudhës pa mirëmbajtje do të impaktonte në shërbimin e drejtpërdrejtë ndaj qytetarëve. Për këtë kërkesë DPSHTRR nuk ka marrë përgjigje nga AKSHI, por nisur nga nevoja e vazhdueshme për suport në këtë sistem, punonjësit e DAM kanë vazhduar të raportojnë problematika në një sistem raportimi/suporti të vënë në dispozicion gjatë zbatimit të kontratës së mëparshme nga OE, pasi disa konfigurime apo sisteme veprimesh të ndryshme, janë të nevojshme dhe nuk mund të kryhen nga vetë punonjësit.

Për çështje të rëndësishme, OE i kontraktuar për mirëmbajtjen në periudhën e mëparshme maj 2020 - maj 2022, ka ofruar suport pas kësaj periudhe në mirëkuptim duke i ndjekur në disa raste çështjet deri në zgjidhje e në disa raste jo.

Nga auditimi mbi sistemin informatik eDPSHTRR konstatohet se AKSHI prej 01.06.2022 e deri tani, në kushtet e mungesës së një marrëdhënie kontraktuale për mirëmbajtjen e këtij sistemi, ka kërkuar aksesimin e të dhënave për kontrole periodike parandaluese si dhe ekzekutimin e plan ndërhyrjeve për zgjidhjen e çështjeve të ngritura të sistemit eDPSHTRR, duke e ekspozuar sistemin eDPSHTRR ndaj një aksesimi dhe veprimi të pagjurmueshëm elektronikisht dhe të pambrojtur ligjërisht. Siguria e të dhënave nga ky aksesim mbetet në motivimin e OE dhe punonjësve të cilët angazhohen në veprime të këtij suporti.

Gjatë vitit 2023 DPSHTRR ka kërkuar disa zhvillime të reja, për të cilat AKSHI ka kryer procedurën e prokurimit për përmirësimin e sistemit eDPSHTRR. Nënshkrimi i kontratës me nr.61, datë 08.06.2023 është bërë nga 3 palë përfaqësues, një praktikë e re kjo, ndërmjet AKSHI-t si Autoritet Kontraktor, DPSHTRR-s si Autoritet Përfitues dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik të shpallur fitues.

Afati i implementimit të kësaj kontrate është 12 muaj, pra aktualisht ndodhet në muajin e 4 të zbatimit, ku bazuar në tabelën e implementimit është pikërisht në fazën e zhvillimit të përmirësimeve të sistemit software.

AKCESK me shkresën nr. 25001, datë 10.11.2022 ka kërkuar informacion mbi masat minimale të sigurisë kibernetike në lidhje me sistemet kritike ku DPSHTRR është Operator Administrues, duke vendosur dhe një afat për këtë raportim që është data 14 nëntor 2022.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, DPSHTRR me shkresën nr. 25001/1, datë 11.11.2022 i ka përcjellë kërkesën e ardhur nga AKCESK tek AKSHI se si AK në bashkëpunim me OE që mirëmbajnë sistemet kritike eDPSHTRR dhe eDM kanë aplikuar një sërë veprimesh në këto

infrastruktura me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë si dhe në menaxhim dhe administrim, për të cilat DPSHTRR nuk disponon asnjë raportim. Nga AKSHI nuk ka patur një përgjigje ku DPSHTRR të jetë vënë në dijeni lidhur me informacionin që kërkon AKCESK.

Në këtë dokument është kërkuar informacion mbi disa çështje që kanë ndikim në sigurinë kibernetike, ku ndër të tjera është kërkuar të identifikohet dhe të përcaktohet administratori me të drejta të plota në sistemet kritike.

Në vitin 2023, me shkresën nr.11006, datë 05.06.2023, AKCESK i është drejtuar disa institucioneve, ndërmjet të cilëve dhe DPSHTRR-s duke i vënë në dijeni se është shtuar aktiviteti keqdashës ndaj infrastrukturave TIK në Republikën e Shqipërisë dhe kërkohet një vigjilencë e shtuar për periudhën në vijim. Për këtë, me qëllim parandalimin e incidenteve të mundshme kibernetike të cilat mund të afektojnë infrastrukturën TIK që ju operoni, sjellim në vëmendjen tuaj:

- Rishikimin e zbatimit të masave minimale të sigurisë në infrastrukturën kritike dhe të rëndësishme të informacionit;
- Rritjen e gatishmërisë së stafit përgjegjës për çështjet e sigurisë kibernetike duke përfshirë dhe fundjavat;
- Raportimin e menjëhershëm në rast zbulimi të një incidenti të sigurisë kibernetike pranë AKCESK;
- Ndërgjegjësimin e punonjësve për mos aksesimin e faqeve dhe email-eve me përmbajtje të dyshimtë dhe email-eve phishing, me qëllim mos afektimin e infrastrukturave që janë nën administrimin tuaj.

Po në vitin 2023, me shkresën nr.7142, datë 18.04.2023, AKCESK duke vënë në dijeni dhe AKSHI-n, kërkon informacion lidhur me statusin e implementimit të masave të sigurisë kibernetike në infrastrukturën e DPSHTRR-s.

Nga auditimi u konstatua se DPSHTRR gjendet në kushte të paqarta vepruese ndaj kërkesave të vazhdueshme nga AKCESK për masat që duhet të merren për infrastrukturën kritike eDM dhe eDPSHTRR, për arsye se marrëdhënia e përgjegjësisë dhe bashkëveprimit me AKSHI-n nuk është përcaktuar në terma teknikë.

Kjo mungesë bashkëpunimi cenon dhe ndikon në objektivin e parë specifik të politikës nr.4 në VKM nr.1084, datë 24.12.2020 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Planit të Veprimit 2020-2025”, që është forcimi i bashkëpunimit institucional në nivel kombëtar.

Gjithashtu, DPSHTRR nuk disponon strukturë me burime njerëzore, të dedikuara për sigurinë e informacionit dhe siguria e informacionit duhet të përmbushet nga AKSHI, ndërsa aktet ligjore e nënligjore për infrastrukturën kritike përcaktojnë DPSHTRR si Operator Administrues për eDM dhe eDPSHTRR, bazuar në:

- Nenin 3, të Ligjit nr.2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike” ku citohet se: “Operator i infrastrukturës kritike të informacionit është një person juridik, publik ose privat, që administron infrastrukturën kritike të informacionit”;
- Nenin 8/pika 2 dhe 3 të Ligjit nr.2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”, ku përcaktohet se DPSHTRR nevojitet të zbatojë masat organizative dhe teknike të sigurisë;
- Pika 4, VKM nr.553, datë 15.07.2020 “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, i ndryshuar me VKM nr.761, datë 12.12.2022 ku citohet se “Operator i infrastrukturës kritike të informacionit” është një person juridik, publik ose privat, që administron infrastrukturën kritike të informacionit”.

Nga auditimi u konstatua se në asnjë strukturë dhe tek asnjë punonjës nuk janë përcaktuar detyrat funksionale që DPSHTRR ka detyrim të plotësojë si Operator Administrues i strukturave kritike përcaktuar me aktet ligjore e nënligjore:

- Ligji nr.2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”;
- VKM nr.553, datë 15.07.2020 “Për miratimin e listës së Infrastrukturave Kritike të Informacionit dhe të listës së Infrastrukturave të Rëndësishme të Informacionit” e ndryshuar me VKM nr.761, datë 12.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 553, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave”.

- VKM nr.1084, datë 24.12.2020 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Planit të Veprimit 2020-2025”, më konkretisht me politikën 1 për garantimin e sigurisë kibernetike në nivel kombëtar, nëpërmjet mbrojtjes së infrastrukturave të informacionit, duke fuqizuar mjetet teknologjike dhe juridike:

Objektivin nr.2: Ngritja dhe funksionimi i CSIRT-eve në të gjithë sektorët e industrisë në nivel kombëtar;

Objekti nr.3: Fuqizimi dhe implementimi i masave të sigurisë në infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit.

Nga auditimi u konstatua se për sistemin eDPSHTRR nuk është përcaktuar administratori me të drejta të plota, kërkesë kjo e përcjellë dhe nga AKCESK tek Operatorët Administrues të sistemeve kritike. Në janar të 2022, fjalëkalimi për ekzekutimin e plan ndërhyrjeve për zgjidhjen e çështjeve të ngritura të sistemit eDPSHTRR që i takonin mirëmbajtjes, aksesimi është dokumentuar se është bërë i mundur nëpërmjet lidhjeve VPN ku fjalëkalimin e përdoruesit me të drejta shkrimi në nivel databaze e dispononte 50% OE që ka ofruar mirëmbajtjen dhe 50% AKSHI.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me standardet dhe elementët e sigurisë së përcaktuar nga AKCESK ku Operator Administrues është DPSHTRR. Aktiviteti i AKSHI-t bazuar në VKM nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” i ndryshuar, nuk përcakton që AKSHI të bëjë pjesë në administratorin me të drejta të plota në këto të dhëna.

Me përfundimin e kontratës së mirëmbajtjes, ky fjalëkalim me të drejta shkrimi në nivel databaze është ndarë ndërmjet AKSHI-t dhe DPSHTRR-s të cilin e disponon drejtori i Drejtorisë së Administrimit dhe Monitorimit.

Nga auditimi u konstatua se për këtë sistem nuk janë ndërtuar mekanizma gjurmues dhe kontrollues mbi gjurmën elektronike të veprimeve që në termat teknike quhen log-s. Nuk ka asnjë evidencë se analizimi i log-eve të konfiguruar në bazën e të dhënave, analizohet dhe monitorohet nga struktura të caktuara të DPSHTRR-s.

Aksesimi i sistemit eDPSHTRR bëhet me një faktor identifikimi që është fjalëkalimi. Parametrizimi i fjalëkalimit është bazuar në këto kritere:

- Gjatësia e fjalëkalimit të mos jetë më e shkurtër se 5;
- Duhet të përmbajë të paktën një karakter si @ ose #.

Në rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale të miratuar me urdhrin e titullarit nr.667/2, datë 13.06.2022, në nenin 20 për fjalëkalimet, përcaktohen disa kritere të përgjithshme si dhe ndryshimi i tij çdo 3 ose 6 muaj.

Nga auditimi u konstatua se, janë vendosur kritere minimale në aksesimin e sistemit eDPSHTRR dhe nuk janë aplikuar elementë sigurie të detyrueshëm mbi gjatësinë, që sipas standardeve përlllogarit të jetë jo më pak se 8 karaktere, mos përsëritjen e të njëjtit fjalëkalim, bllokimin e përdoruesit në rastet e vendosjes së fjalëkalimit të gabuar nga një numër i

arsyeshëm provash të aksesimit si dhe ndërrimin e detyrueshëm pas log-imit kur fjalëkalimi është krijuar nga suporti.

Me qëllim testimin e disa shërbimeve në sistemin eDPSHTRR u vlerësua kontrolli i input/output për mjetet e përjashtuara nga taksat që janë në pronësi të kategorive “Invalid” dhe “Persona me aftësi të kufizuar”.

Për të realizuar këtë testim, u verifikua nga ndërfaqja nëse sistemi lejon që në mjetin e dytë e më shumë të një shtetasi shqiptar lejohet përjashtimi nga taksat nëse për ky përjashtim është bërë për mjetin e parë. Nga ky verifikim rezultoi se nuk është e mundur të përjashtohesh nga taksat për më shumë se një mjet pavarësisht kategorisë së zotëruesit të mjeteve që ndodhen në kategoritë “Invalid” dhe “Persona me aftësi të kufizuar”.

Në bazën e të dhënave u analizuan 16,597 rekorde që u filtruan për të verifikuar nëse ka përjashtime nga taksa për këto kategori.

Në këto raste u verifikuan 4 NID-e që kanë 3 përjashtime për të njëjtën periudhë, por nga verifikimi rezultoi se ishin për të njëjtin mjet.

Gjithashtu u verifikuan 6 raste që kanë 2 përjashtime për të njëjtën periudhë, por nga verifikimi rezultoi se ishin për të njëjtin mjet.

Në një rast, regjistrimet me përjashtim takse për 2 mjete të ndryshme të të njëjtit zotërues, rezultoi se mjeti gjatë vitit kalendarik ishte kishte ndërruar pronar, ku të dy i përkisnin kategorisë “invalid”.

Pra, për sa më sipër nga auditimi nuk u konstatua ndonjë rast ku më shumë se një mjet me zotërues në kategoritë “Invalid” dhe “Persona me aftësi të kufizuar”, të jetë i përjashtuar nga taksat. Nga testimi mbi zotëruesin për dy mjete, rezultoi se përjashtimi nga taksat për mjetin e dytë është kufizuar nëpërmjet sistemit.

Problemi më i shpeshtë i raportuar gjatë mirëmbajtjes së sistemit eDPSHTRR, janë invalidimet mbi aplikimet, ku gjatë procedurës së ndryshimit të pronësisë së mjetit nga punonjësit e Degës së Regjistrimit të Mjeteve me rolet “Specialist”, “Regjistrim Mjeti” ose “Kryetar Regjistrim Mjeti”, vendosen të dhëna gabim në ndryshimin e pronësisë, duke reflektuar ndryshime në të dhënat e prekura gabimisht.

Hapi 1 - Nisur nga ankesa e qytetarit që ka bërë aplikimin, se ndryshimi i pronësisë është realizuar për mjetin e gabuar, kryetarët e Degëve të Regjistrimit të Mjeteve, dërgojnë e-mail pranë Drejtorisë së Regjistrimit të Mjeteve në DPSHTRR, përshkrimin e problematikës dhe kërkesën për invalidim të aplikimit të gabuar duke referuar detajet mbi mjetin.

- Nga ana e Drejtorisë së Regjistrimit të Mjeteve pas kontrollit të të dhënave në sistem, saktësohen të dhënat e shërbimit që është realizuar gabim.

- Drejtoria së Regjistrimit të Mjeteve kërkon nga Drejtoria Ekonomike të shprehet si do veprohet me faturën e shërbimit.

-Drejtoria e Regjistrimit të Mjeteve dërgon në Drejtorinë e Administrimit dhe Monitorimit kërkesën për invalidimin e aplikimit të gabuar dhe lënien aktive të aplikimit të saktë (kthimin në gjendjen e mëparshme).

-Drejtoria e Administrimit dhe Monitorimit pas ardhjes së kërkesës për invalidimin e aplikimit dhe konfirmimit se si do të veprohet me faturën nga e Drejtorisë Ekonomike, kryhet kontrolli i të dhënave për mjetin të cilin janë realizuar gabim si Shërbimi, numri shasisë, numër Aplikimi, etj.

Hapi 2 - Drejtoria e Administrimit dhe Monitorimit pas verifikimeve dhe saktësimeve të nevojshme, në mungesë të një funksionaliteti në sistemin eDPSHTRR për realizimin e kësaj kërkesë, krijohet çështja në portalin e ndjekjes së kërkesave të klientit CRM me detaje që është një portal për gjurmimin e çështjeve të suportit nga Kontraktuesi që ofron shërbimin e mirëmbajtjes. Në këtë portal drejtorja e DAM sigurohet të ketë dhënë:

- Përshkrimin e problemit;

- Numrin e aplikimit me të dhëna të gabuara dhe shërbimin në të cilin ka ndodhur ky gabim që është në këtë rast “Ndryshim pronësie”;
 - Të dhënat e shasisë së mjetit;
 - Veprime që do të kryhen mbi faturën.
- Pas reklamimit në portalin CRM nga ana e Drejtorisë së Administrimit dhe Monitorimit mbahet komunikim me personat që kanë reklamuar rastin se çështja është adresuar dhe po ndiqet nga suporti.

Hapi 3 - Nga ana e suportit pas verifikimeve kontrolleve përgatitet plani i ndërhyrjes duke bërë përshkrimin dhe aktivitetet mbi të cilat kalon ndërhyrja. Së bashku me planin e ndërhyrjes dërgohet dhe konfirmohet skripti që do të ekzekutohet.

Hapi 4 - Pas konfirmimit nga ana e suportit për kalimin e planit me sukses dhe kontrolleve të nevojshme nga ana e Drejtorisë së Administrimit dhe Monitorimit, informohen strukturat përkatëse që kanë reklamuar rastin se çështja është zgjidhur.

Nisur nga rastet e vazhdueshme të reklamuar, DPSHTRR e ka parashikuar si shtim funksionaliteti në ndryshimet që do të bëhen në sistem, të cilat pritet të realizohen së bashku me një sërë ndryshimesh në kontratën me objekt “Përmirësimi i sistemit eDPSHTRR dhe sistemit financiar në shërbim të tij” që është aktualisht në periudhën e zhvillimit.

Në vitin 2023 është lidhur kontrata për “Përmirësimi i sistemit eDPSHTRR dhe sistemit financiar në shërbim të tij”, objektivat kryesore të të cilit janë:

- Përmirësimi i proceseve të prodhimit e kostifikimit të targave;
- Moduli i Targës së personalizuar dhe targa me përzgjedhje;
- Krijimi i logjikës së re të lidhjes së targës me pronarin e mjetit;
- Krijimi i one stop-shop për pagesën e gjobave të policisë rrugore;
- Krijimi i regjistrimit të mjeteve “retro” regjistrimi dhe shërbimet për mjetet retro;
- Regjistrimi dhe shërbimi për karrelin ose rimorkion me një aks deri në 750 kg;
- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe listë pagesave;
- Shtim i licencave për sistemin MS Dyn 365 BC;
- Përmirësimi i infrastrukturës fizike, etj.

Aktualisht nuk mundemi të verifikojmë zgjidhjen e ofruar, pasi kontrata e përmendur me sipër nuk e ka përfunduar zbatimin e saj.

1. Titulli i gjetjes: Në sistemin eDPSHTRR siguria e të dhënave është një detyrë e pa adresuar. **Situata:** Nga auditimi mbi sistemin eDPSHTRR rezultoi se nuk është përcaktuar administratori i të dhënave me të drejta të plota, kërkesë kjo e përcjellë dhe nga AKCESK tek Operatorët Administrues të sistemeve kritike. AKSHI në kushtet e mungesës njohurive profesionale për mirëmbajtjen e këtij sistemi ka lejuar dhe ekspozuar sistemin e DPSHTRR ndaj një aksesimi dhe veprimi të pagjurmueshëm elektronikisht, por dhe të pambrojtur ligjërisht megjithëse nuk është administratori me të drejta të plota në të dhënat e këtij sistemi.

Siguria e të dhënave nga ky aksesim ka mbetur në motivimin e OE dhe punonjësve të cilët angazhohen në veprime të këtij suporti. Sipas VKM-s nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” i ndryshuar, nuk përcaktohet që AKSHI të jetë apo të ketë administratorin me të drejta të plota në këto të dhëna.

Kriteri:

- Neni 3, i Ligjit nr.2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike” ku citohet se: “Operator i infrastrukturës kritike të informacionit është një person juridik, publik ose privat, që administron infrastrukturën kritike të informacionit”;
- Nenin 8/pika 2 dhe 3 të Ligjit nr.2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”, ku përcaktohet se DPSHTRR nevojitet të zbatohet masat organizative dhe teknike të sigurisë;

- Pika 4, VKM nr.553, datë 15.07.2020 “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, i ndryshuar me VKM nr.761, datë 12.12.2022 ku citohet se “Operator i infrastrukturës kritike të informacionit” është një person juridik, publik ose privat, që administron infrastrukturën kritike të informacionit”.

- VKM nr.1084, datë 24.12.2020 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Planit të Veprimit 2020-2025”, më konkretisht me politikën 1 për garantimin e sigurisë kibernetike në nivel kombëtar, nëpërmjet mbrojtjes së infrastrukturave të informacionit, duke fuqizuar mjetet teknologjike dhe juridike:

Politika nr.4 në VKM nr.1084, datë 24.12.2020 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Planit të Veprimit 2020-2025”, që është forcimi i bashkëpunimit institucional në nivel kombëtar;

Objektivin nr.2: Ngritja dhe funksionimi i CSIRT-eve në të gjithë sektorët e industrisë në nivel kombëtar;

Objekivi nr.3: Fuqizimi dhe implementimi i masave të sigurisë në infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit;

Standardet dhe elementët e sigurisë së përcaktuar nga AKCESK ku Operator Administrues është DPSHTRR.

VKM nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar

Ndikimi/Efekti: Cenim në sigurinë e të dhënave të sistemit eDPSHTRR.

Shkaku: Mungesa e njohurive profesionale për mirëmbajtjen e këtij sistemi nga ana e AKSHI-t si dhe e një shërbimi të kontraktuar për mirëmbajtjen e tij.

Rëndësia: E lartë

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të marrë masa për shtimin në organikë dhe hartimin e përkrahimit të punës për Oficerin e Sigurisë së të dhënave, nisur nga detyrimet ligjore dhe nënligjore që përcakton ligji për sigurinë kibernetike ku institucioni është Operator Administrues dhe si i tillë duhet të plotësojë një sërë kërkesash që burojnë nga këto akte. DPSHTRR duhet të kërkojë dhe mbajë detyrat e administratorit të të dhënave me të drejta të plota.

2.Titulli i gjetjes: nuk ka një ndarje të detyrimeve dhe përgjegjësi në lidhje me sigurinë e të dhënave ndërmjet DPSHTRR dhe AKSHI-t.

Situata: Ndërmjet DPSHTRR dhe AKSHI-t nuk ka një ndarje të detyrimeve dhe përgjegjësi në lidhje me sigurinë e të dhënave. Nga auditimi u konstatua se DPSHTRR gjendet në kushte të paqarta vepruese ndaj kërkesave të vazhdueshme nga AKCESK për masat që duhet të merren për infrastrukturat kritike eDM dhe eDPSHTRR, për arsye se marrëdhënia e përgjegjësi dhe bashkëveprimit me AKSHI-n nuk është përcaktuar në terma teknikë. Aktet ligjore e nënligjore për infrastrukturat kritike përcaktojnë DPSHTRR si Operator Administrues për eDM dhe eDPSHTRR. Në asnjë strukturë dhe tek asnjë punonjës nuk janë përcaktuar detyrat funksionale që DPSHTRR ka detyrim të plotësojë si Operator Administrues i strukturave kritike përcaktuar me aktet ligjore e nënligjore.

Kriteri:

- Neni 3, i Ligjit nr.2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike” ku citohet se: “Operator i infrastrukturës kritike të informacionit është një person juridik, publik ose privat, që administron infrastrukturën kritike të informacionit”;

- Nenin 8/pika 2 dhe 3 të Ligjit nr.2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”, ku përcaktohet se DPSHTRR nevojitet të zbatojë masat organizative dhe teknike të sigurisë;

- Pika 4, VKM nr.553, datë 15.07.2020 “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, i ndryshuar me VKM nr.761, datë 12.12.2022 ku citohet se “Operator i infrastrukturës kritike të informacionit”

është një person juridik, publik ose privat, që administron infrastrukturën kritike të informacionit”.

- VKM nr.1084, datë 24.12.2020 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Planit të Veprimit 2020-2025”, më konkretisht me politikën 1 për garantimin e sigurisë kibernetike në nivel kombëtar, nëpërmjet mbrojtjes së infrastrukturave të informacionit, duke fuqizuar mjetet teknologjike dhe juridike:

Politika nr.4 në VKM nr.1084, datë 24.12.2020 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Planit të Veprimit 2020-2025”, që është forcimi i bashkëpunimit institucional në nivel kombëtar;

Objektivin nr.2: Ngritja dhe funksionimi i CSIRT-eve në të gjithë sektorët e industrisë në nivel kombëtar;

Objekti nr.3: Fuqizimi dhe implementimi i masave të sigurisë në infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit;

Standardet dhe elementët e sigurisë së përcaktuar nga AKCESK ku Operator Administrues është DPSHTRR.

Ndikimi/Efekti: Cenim në sigurinë e të dhënave të sistemit eDPSHTRR.

Shkaku: Mungesa e njohurive profesionale për mirëmbajtjen e këtij sistemi nga ana e AKSHI-t si dhe e një shërbimi të kontraktuar për mirëmbajtjen e tij.

Rëndësia: E lartë

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor në bashkëpunim me AKSHI-n dhe AKCESK-un të marrin masa organizative për përcaktimin e detyrave që rrjedhin nga aktet ligjore ku mbështeten AKSHI dhe AKCESK, por që duhet t'i zbatojë DPSHTRR, duke ndarë në këtë mënyrë përgjegjësinë e çdo institucioni ku secili do të duhet të ndërmarrë hapat organizativë dhe teknikë në sigurimin e arsyeshem të të dhënave që ruhen në sistemin eDPSHTRR.

3.Titulli i gjetjes: Për sistemin eDPSHTRR mungojnë log-s.

Situata: Nga auditimi u konstatua se për sistemin eDPSHTRR nuk janë ndërtuar mekanizma gjurmues dhe kontrollues mbi gjurmën elektronike të veprimeve në të dhëna të rëndësishme që në termat teknikë quhen log-s. Nuk ka asnjë evidencë se analizimi i log-eve të konfiguruar në bazën e të dhënave, analizohet dhe monitorohet nga struktura të caktuara të DPSHTRR-s.

Kriteri: Standardet dhe elementët e sigurisë së përcaktuar nga AKCESK ku Operator Administrues është DPSHTRR.

Ndikimi/Efekti: Pamundësi për të gjurmuar veprimet mbi të dhëna.

Shkaku: Nuk ka qenë e mundur në sistem të ruhen elektronikisht veprimet e kryera mbi të dhëna të rëndësishme. Aktualisht një përmirësim i sistemit në këtë drejtim është parashikuar në kontratën nr.61, datë 08.06.2023 që është duke u zbatuar me objekt “Përmirësim i eDPSHTRR dhe financiar”.

Rëndësia: E lartë

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, në kushtet kur mekanizmi i logeve është parashikuar të zhvillohet në kontratën që është aktualisht në zbatim për përmirësimin e sistemit eDPSHTRR, të mbajë në konsideratë që për këtë zhvillim të ndërtuar nevojitet të përcaktohet struktura monitoruese dhe analizuese e gjurmës elektronike.

4.Titulli i gjetjes: Janë vendosur kriteret minimale në aksesimin e sistemit eDPSHTRR.

Situata: Nga auditimi mbi kriteret e fjalëkalimit për përdoruesit e sistemit eDPSHTRR u konstatua se, janë vendosur kriteret minimale në aksesimin e këtij sistemi dhe nuk janë aplikuar elementë sigurie të detyrueshem mbi gjatësinë që sipas standardeve përlogarit të jetë jo më pak se 8 karaktere, mos përsëritjen e të njëjtit fjalëkalim, bllokimin e përdoruesit në rastet e vendosjes së fjalëkalimit të gabuar nga një numër i arsyeshem provash të aksesimit si dhe ndërrimin e detyrueshem pas log-imit kur fjalëkalimi është krijuar nga suporti.

Kriteri: Standardet dhe elementët e sigurisë së përcaktuar nga AKCESK ku Operator Administrues është DPSHTRR.

Ndikimi/Efekti: Fjalëkalimi i parametrizuar me kritere të dobëta, përbën risk për aksesim të paautorizuar të sistemit.

Shkaku: -

Rëndësia: E lartë

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të marrë masa, për rritjen e sigurisë në aksesimin e sistemit eDPSHTRR, si një nga elementët e rëndësishëm që parandalon aksesimin e paautorizuar të të dhënave të sistemit eDPSHTRR nga përdorues të brendshëm dhe të jashtëm.

5.Titulli i gjetjes: Mungesa e ndërveprim me sistemin doganor Assycuda.

Situata: Nga auditimi u konstatua se sistemi eDPSHTRR nuk ka ndërveprim në kohë reale me sistemin doganor Asycuda, por është mundësuar gjenerimi i një raporti për mjetet tek të cilat janë kryer veprimet doganore të një dite më parë.

Në rastet kur konstatohen mospërputhje nga identifikimi teknik i mjetit me deklaratën doganore, DPSHTRR refuzon dhënien e shërbimit për regjistrimin e mjetit. Të dhënat e përditësuara/amenduara nga DPD për rastet e refuzuara, DPSHTRR i lexon dhe i azhuron ditën tjetër.

Veprimet mbi mjetet e importuara të kryera nga DPD, nuk lexohen në kohë reale duke sjellë një impakt në DPSHTRR, e cila nuk mund të japë shërbim për të gjitha rastet e regjistrimit të mjeteve që paraqiten për regjistrim brenda ditës që kanë kryer procedurat doganore.

Kriteri: Ndërveprimi me të dhëna ndërmjet databazave shtetërore.

Ndikimi/Efekti: Të dhëna të pasqyruara jo në kohë reale për veprime të rëndësishme në sistemin eDPSHTRR.

Shkaku: Mungesa e ndërveprimit me sistemin doganor Assycuda.

Rëndësia: E lartë

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masa për ndërtimin e ndërveprimit ndërmjet sistemit eDPSHTRR dhe Assycuda me qëllim leximin tek ky i fundit të të dhënave në kohë reale mbi mjetet motorikë të importit të cilat aktualisht përditësohen me veprime manuale nga një punonjës i dedikuar në DPSHTRR.

6.Titulli i gjetjes: Statusi ligjor një e dhënë e rëndësishme në bazat e të dhënave të QKB-s dhe DPT-s për subjektet, nuk lexohet dhe nuk është e mundur të ruhet në regjistrin e mjeteve.

Situata: Nga auditimi u konstatua se në sistemin informatik eDPSHTRR, kategorizimi në sistem bëhet në grupet “Individ” dhe “Subjekt”. Për kategorinë subjekt të dhënat si emri, adresa, etj., lexohen nga sistemi i QKB-s dhe DPT për statuset ligjore që krijohen direkt në sistemin informatik eTax të DPT-s. Statusi ligjor, një e dhënë e rëndësishme në bazat e të dhënave të QKB-s dhe DPT-s për subjektet, nuk lexohet dhe nuk është e mundur të ruhet në regjistrin e mjeteve pasi mungon fusha në bazën e të dhënave për këtë të dhënë. Në sistemin elektronik eTaxation të DPT-s, kategorizimet ligjore të subjekteve në total aktualisht janë 25, ku 15 statuse krijohen në QKB, ndërsa 10 prej tyre krijohen në sistemin tatimor. Mungesa e këtij informacioni në sistemin eDPSHTRR, krijon pamundësi në analizimin e të dhënave për mjetet në pronësi të subjekteve në kategori të ndryshme, pamundësi për të aplikuar lehtësime apo kufizime të njëjta në nivel kategorie, si dhe pamundësi për veprime të tjera që vendimmarrjet sjellin impakt në grup të mjeteve apo njoftime automatike për detyrimet që nevojitet të aplikohen në mjete sipas grupeve.

Kriteri: Ndërveprimi me të dhëna parësore ndërmjet databazave shtetërore.

Ndikimi/Efekti: Pamundësi për të analizuar të dhëna të biznesit për grupe të ndryshme, veprime manuale mbi filtrimin e të dhënave për kategori biznesi të ndryshme rreth 1500 NIPT-e, pamundësi për të aplikuar të njëjtat parametrizime në të njëjtin grup etj.

Shkaku: Mungesa e fushës për kategorizimin ligjor në sistemin eDPSHTRR.

Rëndësia: E lartë

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masa për ndërtimin e funksionalitetit në sistemin eDPSHTRR për statusin ligjor të subjekteve dhe të lexojë e ruajë në regjistrat e mjeteve këtë të dhënë të marrë nga QKB apo DPT sipas rastit, si një e dhënë orientuese në mjetet e biznesit që i përkasin të njëjtës kategori. Filtrimi, analiza dhe planifikime të politikave mbi të dhëna në regjistrin e mjeteve që identifikohen në grup do të jetë më i lehtë dhe më i saktë në rast se cilësimi për statusin ligjor do të lexohet nga ndërveprimi.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.5, datë 13.11.2023, protokolluar në DPSHTRR me nr. 17659/5, datë 13.11.2023 si dhe trajtuar në faqet 53-62 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione.

Sistemi eDM u ndërtua me kontratë dhe objekt “Plotësimi i sistemeve të lejedrejtimit” në bashkimin e sistemeve ekzistuese në një sistem të vetëm (LD5_live, Ld5_kualifikimi, eForm, CAP, DT pa përfshirë personalizimin ekzistues) i cili shërben për:

- Migrimin e të dhënave nga sistemet ekzistuese në një të vetëm
- Leje drejtimi
- Personalizimi
- Sistemi i aplikimit për karta të tjera jashtë CAP dhe LD
- DMT (Dëshmi e mësuesit të Teorisë)
- DIP (Dëshmi e Instruktorit të Praktikës)
- ADR (Certifikata e trajnimit e Drejtuesit të Mjetit)
- CKP (Certifikatë e Kompetencës Profesionale)
- DM (Dëshmi Manovratori)
- DPTA (Dëshmi për përgjegjës Teknik Autoriparimi)
- CMJN (Certifikatë për mjete jashtë norme)
- Ndërtimi/përmirësimi i webserviceve për komunikimin me sisteme të tjerë.
- Ngritja e infrastrukturës së duhur për ofrimin e shërbimeve online;
- Implementimin e sistemit të përmirësuar pa ndërprerë shërbimet ekzistuese.
- Implementimi i Hardware dhe konfigurimi i HA dhe backup-et.

Ndërtimi i sistemit ka filluar në vitin 2019 në përputhje me kontratën e nënshkruar me palën zhvilluese dhe është vendosur në funksion dhe të përdoret për lejet e drejtimit prej datës 2 Janar 2020. Sistemi është mirëmbajtur vazhdimisht nëpërmjet kontratave të shërbimit dhe mirëmbajtjes dhe është përshtatur gjatë gjithë kohës, në përputhje me ndryshimet ligjore dhe procedurale që kanë ndodhur si dhe është përmirësuar vazhdimisht sipas kërkesave të DPSHTRR.

1. Titulli i Gjetjes: Mos regjistrimi i sistemit eDM si bazë të dhënash shtetërore.

Situata Nga auditimi u konstatua se të dhënat e sistemit eDM nuk janë të regjistruara si bazë të dhënash shtetërore dhe janë ngritur ndërveprime në kundërshtim me ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” dhe VKM nr. 945, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”, i ndryshuar.

Kriteri: Ligji nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” dhe VKM nr. 945, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”, i ndryshuar.

Ndikim/Efekti: Të dhënat e këtij sistemi nuk janë të specifikuar për nga rëndësia, për nga lloji i tyre, si dhe detyrimi për ruajtjen e tyre. Ndërveprimet me këto të dhëna nuk janë konform akteve ligjore pasi për të ndërvepruar, nevojitet që shkëmbimi të ndërtohet mbi të dhëna shtetërore.

Shkaku: Zhvillime të sistemit nga ai i vitit 2015 në një version të migruar të të dhënave në vitin 2020.

Rëndësia: E Lartë

1.1 Rekomandim: DPSHTRR të hartoj dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin eDM me të dhënat e të cilëve janë ndërtuar dhe ndërveprime me sisteme të tjera.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.6, datë 13.11.2023, protokolluar në DPSHTRR me nr. 17659/6, datë 13.11.2023 si dhe trajtuar në faqet 62-66 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin janë paraqitur observacione protokolluar në KLSH me nr.599/3, datë 04.01.2024.

Pretendimi i subjektit: DPSHTRR prej vitit 2015 ka dërguar pranë ARK/AKSHI informacionin e kërkuar sipas legjislacionit në fuqi për regjistrimin e dy databazave shtetërore:

Regjistri Kombëtar i Mjeteve – eDPSHTRR;

Regjistri Kombëtar i Personave të Aftësuar për Drejtimin e Mjeteve.

Në vitin 2020, me kontratën nr. 5499, datë 12.10.2018 “Plotësimi i sistemeve të lejedrejtimin”, u realizua bashkimi dhe migrimi i të dhënave të sistemeve të ndërtuara për menaxhimin e “Regjistrin Kombëtar të Personave të Aftësuar për Drejtimin e Mjeteve” në një sistem të vetëm. Në vitin 2020, me kontratën nr. 4721, datë 06.08.2019 “Upgrade i sistemit qendror eDPSHTRR, pajisjet HW dhe aplikimit eDPSHTRR. Ridizenjim i infrastrukturës HW dhe ndërtimi i sistemit të menaxhimit. Upgrade i sistemeve operative të serverave dhe databazës eDPSHTRR. Upgrade i sistemit informatik eDPSHTRR, përmirësimi i funksionaliteteve aktuale, shtim shërbimesh” u realizua upgrade i sistemit të ndërtuar për menaxhimin e “Regjistri Kombëtar i Mjeteve – eDPSHTRR”. Meqenëse këto kontrata kishin Autoritet Kontraktor AKSHI-n, dokumentacioni i plotë i rifreskuar i këtyre sistemeve, u dorëzuan edhe pranë AKSHI-t.

Qendrimi i Grupit të Auditimit: Sqarojmë se zhvillimi i sistemit nga versioni i vjetër në një version të ri, shoqërohet me nevojën për të identifikuar të dhëna shtetërore që mund të kenë ndryshuar apo shtuar si rrjedhojë e përmirësimeve që janë implementuar nëpërmjet versionit të ri. Pavarësisht faktit që AK është AKSHI, pronësia e të dhënave dhe përgjegjësia për identifikimin e tyre dhe ndarjen në të dhëna parësore dhe dytësore i takon DPSHTRR-s. Për këtë grupi i auditimit mban qëndrimin se kjo bazë të dhënash si bazë të dhënash shtetërore duhet të hartohet nga DPSHTRR, ndërsa të dhëna specifike që ju nuk i keni por i disponon AK, të bëhen pjesë e dokumentacionit duke bashkëpunuar me AKSHI-n.

Për sa më sipër, nuk janë pasqyruar ndryshime në gjetje dhe rekomandim për këtë pikë në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Infrastruktura hardware dhe software e Sistemit eDM

Sistemi eDM është aplikacion modular që shërben në menaxhimin e proceseve për pajisjen me leje drejtimi, cap si dhe Dëshmi te ndryshme. Ky sistem është i hostuar në godinën e DPSHTRR. Sistemi eDM është instaluar në çdo përdorues nga ku akseson data bazën e sistemit në server. Sistemi eDM është ngritur në gjuhën e programimit VB.Net. Baza e të dhënave: SQL Server 2016.

DPSHTRR për menaxhimin e sistemit eDM mbështetur në praktikat më të mira duhet të kishte Workflow. Tre proceset kryesore që përfshihen në Workflow janë: Hyrja e të dhënave (Input); Procesimi i tyre dhe Rezultati (Output); Mungesa e dokumentimit të diagrameve shpjeguese se si informacioni rrjedh në sistemet e TI që mbështesin proceset e institucionit në vazhdimësi të plotësisht të gjurmës së auditimit krijojnë pengesa në të paktën 3 drejtime për:

- Kuptimin: Diagrami nxjerr në pah zona ku mungon kuptimi i sistemit dhe kontroleve që janë implementuar në të.

- Vlerësimin: Nëpërmjet diagrameve, vetë punonjësit apo strukturat monitoruese mund të zbulojnë pikat e forta dhe dobësitë e kontrollit që është implementuar në sistem.

- Gjurmimin: Nëpërmjet diagrameve dokumentohet rruga që përshkon informacioni i regjistruar në sistem, deri në raportimin e të dhënave përfundimtare që janë institucionet tek të cilat shoqëria raporton. Ky gjurmim tek DPSHTRR nuk realizohet plotësisht nëpërmjet aplikacioni

Nga grupi i auditimit u administrua diagrama se si ndërveprojnë dhe komunikojnë sistemet me njëri tjetrin.

2.Titulli i Gjetjes: Nuk janë dokumentuar, diagramet e rrjedhës së informacionit “Workflow”

Situata: Nuk janë dokumentuar, diagramet e rrjedhës së informacionit, për çdo shërbim të konfiguruar në sistemin eDM. DPSHTRR nuk disponon një dokumentim skematik mbi proceset, rregullat dhe procedurat e implementuara për çdo modul apo shërbim që është informatizuar në sistemin eDM.

Kriteri: MFK miratuar me Urdhrin Nr. 108 date 17.11.2016 pika 2.2.10 roli i auditit të brendshëm dhe harta proceseve të punës (aneksi nr.3)

Ndikim/Efekti: Risk në sigurinë e të dhënave me pasojë humbjen, tjetërsimin e tyre.

Shkaku: mos zbatim i përcaktimeve nga strukturat Drejtuese të DPSHTRR i përcaktimeve të MFK miratuar me Urdhrin Nr. 108 date 17.11.2016 pika 2.2.10 roli i Auditit të Brendshëm dhe harta proceseve të punës (aneksi nr.3)

Rëndësia: E Lartë

2.1.Rekomandim: DPSHTRR duhet të hartoj dhe dokumentoj diagramet e rrjedhës së informacionit për çdo proces që realizohet nëpërmjet sistemit me qëllim përcaktimin e të dhënave hyrëse, roleve, ndryshimin, miratimin dhe përfundimin për çdo shërbim që realizohet nëpërmjet sistemit informatikë.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.6, datë 13.11.2023, protokolluar në DPSHTRR me nr. 17659/6, datë 13.11.2023 si dhe trajtuar në faqet 62-66 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin janë paraqitur observacione protokolluar në KLSH me nr.599/3, datë 04.01.2024.

Pretendimi i subjektit: DPSHTRR angazhohet të dokumentojë këto procese në dokumente administrative brenda 6 muajve të parë të vitit 2024.

Qendrimi i Grupit të Auditimit: Afati i kërkuar për zbatimin e rekomandimit, që i referohet hartimit të diagrameve të informacionit pranohet dhe do të pasqyrohet në këtë raport auditimi.

Të dhënat Input dhe Output

Sistemi i Drejtuesit të Mjeteve, Dëshmime dhe Certifikatave - eDM është një sistem modular duke mundësuar përmbushjen e të gjithë funksionaliteteve që lidhen me dëshmitë e drejtuesve të mjeteve. Ky sistem ka të inkuorporuar në të sisteme si:

- Lejet e drejtimit
- ADR (Certifikata e trajnimit e Drejtuesit të Mjetit)
- CAP (Certifikata e Aftësisë Profesionale)
- Dëshmi taksisti

- CMJN (Certifikate për mjete jashtë norme)
- Dëshmi Instruktor Praktike
- Dëshmi Mësues Teorie
- DPTA (Dëshmi për përgjegjës Teknik Autoriparimi)
- DM (Dëshmi Manovratori)

Funksionalitetet e secilit sistem i mundësohen përdoruesve nëpërmjet moduleve përkatëse të cilat janë të thjeshta në përdorim, të qarta në paraqitje dhe ndërkohë duke u lidhur me njëra-tjetrën. Të gjithë sistemet, japin dhe marrin të dhëna nga njëri-tjetri duke mundësuar kështu funksionalitet të plotë të shërbimeve që i ofrohen qytetarit.

Sistemi eDM ka të ngritur Web service dhe nëpërmjet tyre popullohet baza e të dhënave.

Dhënësit e informacionit për sistemin eDM janë:

- Drejtoria e Përgjithshme të Gjendjes Civile sistemi i eDM merr si input të dhënat e gjeneraliteteve të shtetasit shqiptar.
- Qendra e sistemit Maha -VR popullon bazën e të dhënave me të dhënat e kontrollit teknik të mjeteve të subjekteve auto shkolle.
- Me sistemin eDPSHTRR popullon bazën e të dhënave me të dhënat e mjeteve të subjekteve auto shkollë, si dhe të faturës.
- Qendra Kombëtare të Biznesit sistemi eDM popullon bazën e të dhënave me të dhënat e subjekteve auto shkollë.
- Nga databaza e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë sistemi eDM merr si input të dhënat e masave administrative

Kontrollet e verifikimit input përdoren për të siguruar që të dhënat e futura nga përdoruesi janë të vlefshme dhe plotësojnë kriteret e kërkuara. Kjo bëhet për të parandaluar që sistemi të përpujë të dhëna të pasakta ose me qëllim të keq, të cilat mund të çojnë në output te pa saktë. Procesi i vërtetimit të inputeve përfshin analizimin e të dhënave të përdoruesit dhe moslejimin e atyre që konsiderohen të papërshtatshme. Ideja prapa vërtetimit të hyrjes është se duke lejuar vetëm hyrje që plotësojnë kritere specifike, bëhet e pamundur për një sulmues të hyjë në një hyrje të krijuar për të shkaktuar dëme në një sistem.

3.1 Titulli i Gjetjes: Nga auditimi u konstatua se Sistemi EDM:

- Nuk janë ndërtuar mekanizma për bllokimin e përpjekjeve për të loguar me fjalëkalim të gabuar;
- Nuk ka ndërveprim në kohë reale me sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile;
- Nuk ka mekanizma kontrollit të vlefshmëria e hyrjes “Input”, për disa fusha të rëndësishme duke gjeneruar një output të pa vlefshëm.

Situata: Nga grupi i auditimit u testuan me 10 fjalëkalime të gabuara sistemi EDM përdoruesi klsh.tr i hapur nga It e DPSHTRR përdoruesi nuk u bllokua).

Burimi: DPSHTRR Testi eDM 10 fjalëkalime të vendosura gabim përdoruesi nuk u bllokua.

Nga testimi i sistemit eDM mbi ndërveprimin e tij në kohë reale me sistemin e DPGJC u konstatuan problematika duke mos gjeneruar të dhënat, shtetasit që kanë ndërruar jetë dhe shtetasit që kanë ndryshime gjeneraliteteve të cilët janë të pajisur me leje drejtimi nuk shfaqen ndryshimet e statusit të gjeneraliteteve në sistemin eDM.

Regjistri i Shtetasit

Nid : 06023151S

Emri : ERVINA Mbiemri : KULLA

Atesia : NEVRUS Amesia : ALIDE

Datelindja : 23.10.1980 Gjinia : Femer

Shtetesia : Shqipëri Vendlindja : GRAMSH,GRAMSH

Shteti Lindje : Shqipëri Vendbanimi : TIRANE

Nr Dokumenti : Email :

Nr kontakti : Adresa : 3 Vellezerit Kondi

Burimi DPSHTRR .Testi EDM për te marre te dhënat nga DPGJC , nuk i gjeneroi te dhënat

Grupi i auditimit konstatoi praktika ku si rezultat mos aplikimit të kontrolleve në input dhe gjenerimit të output të pa vlefshëm, Nëse për arsye të ndryshme të dhënat konstatohen të gabuara si (Zgjedhja e kualifikimit të gabuar, Autoshkolla e gabuar) Ndërprerja e kualifikimit kryhet nga roli “Kryetar_DDM” ky funksionalitet nuk kryen asnjë veprim mbi faturën e shërbimit. Qytetarëve që i ofrohej shërbimi për tu pajisur me leje drejtimi i është dashur të paguajnë përsëri faturën e shërbimit nëpërmjet aplikimi të ri.

Ndërprerja Regjistrim Kualifikimi - Lejedrejtimi

Regjistrimi ID : 1221100 NID : J00611099K

Emri : EMIL Mbiemri : MUSTAFA

Atesia : ABEDIN Dt Lindja : 11.06.1990


Arsyeja : kategoria e kualifikimit per leje drejtimi perzgjedhur gabim

Burimi DPSHTRR Test ndërprerja Regjistrim Kualifikimi-Lejedrejtimi

Sistemi EDM nuk ka mekanizma kontrolli (Vlefshmëria e hyrjes) për fushat e regjistrimit të certifikatës nga mjeku (fusha Nr. Serial).

- Ofron asistencë të përdoruesve fundorë Konform manualeve të përdorimit.
- Reklamon në DPSHTRR problematika apo incidente të konstatuar në sisteme apo aplikacione.
- Kryen kontrolle mbi pajisjet elektronike/kompjuterike të instaluara në Drejtori.
- Instalimi i aplikacioneve të ndryshëm.
- Kryen detyra të tjera të veçanta që i ngarkon Kryetari i Degës.

Në DRSHTRR Shkodër është instaluar fizikisht rrjeti kompjuterik (paraqitje network) që shërben në përdorim të sistemeve eDPSHTRR,eDM Maha.



Auditi i Brendshëm dhe Auditimet e Teknologjisë së Informacionit.

Struktura aktuale e funksionimit në DPSHTRR është miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me Urdhrin nr.34, datë 16.02.2022. Mbi strukturën dhe përshkrimet e punës DPSHTRR në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm ka të miratuar një numër prej 7 punonjësish. E cila ushtron aktivitetin nga 1-Drejtor Drejtorie, 2-Përgjejsa Sektori dhe 4-Specialist Auditimi, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi ku citohet se:

- Neni 4/pika 6 – “Auditimi i teknologjisë së informacionit” përfshin vlerësimin e kontrolleve të menaxhimit në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, në lidhje me ruajtjen e aseteve, integritetin e të dhënave dhe operimin në mënyrë efektive për të arritur qëllimet dhe objektivat e njësisë publike;
- Neni 9/pika 1 - Një angazhim auditimi për shërbimet e sigurisë përfshin një vlerësim të pavarur të qeverisjes, menaxhimit të riskut dhe proceseve të kontrollit të një njësie të sektorit publik, nëpërmjet auditimit të përputhshmërisë, auditimit të performancës, auditimit financiar, auditimit të teknologjisë së informacionit dhe lloje të tjera të auditimit të brendshëm.

1.1 Titulli i Gjetjes Nga auditimi u konstatua se në Drejtorinë e Përgjithshme Shërbimeve të Transportit Rrugor nuk ka auditues me profil të teknologjisë së informacionit me qëllim planifikimin dhe zhvillimin e drejtimeve të auditimit IT nga struktura e Auditimit të Brendshëm.

Situata: Nga auditimi u konstatua se në Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor nuk ka auditues me profil të teknologjisë së informacionit

Kriteri: Ligji nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, Neni 4/pika 6 dhe Neni 9/pika 1

Ndikimi/Efekti: Mos evidentim në kohë i problematikave që lidhen me Teknologjinë e Informacionit

Shkaku: Mos zbatimi nga strukturat e menaxhimit të DPSHTRR dhe Drejtorisë së auditimit të brendshëm të përcaktimeve sipas Ligjit nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, Neni 4/pika 6 dhe Neni 9/pika 1

Rëndësia: E lartë.

1.1 Rekomandim: : Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të vlerësojnë me prioritet ndryshimin e strukturës së Auditit të Brendshëm duke përfshirë auditues me profil në Teknologjinë e Informacionit me qëllim auditimin e drejtimeve IT, duke i ofruar institucionit mbulim të plotë të auditimit.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.7, datë 13.11.2023, protokolluar në DPSHTRR me nr. 17659/7, datë 13.11.2023 si dhe trajtuar në faqet 66-68 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor nuk ka një strategji institucionale si dhe nuk ka një strategji mbi teknologjinë e informacionit. Rrjedhimisht nuk ka një plan për të mbështetur dhe adresuar qartë objektivat e institucionit. Për periudhën objekt auditimi DPSHTRR nuk ka ndërmarrë masa për hartimin dhe implementimin e një strategjie mbi Teknologjinë e Informacionit, me qëllim identifikimin e proceseve për zhvillimin në mbështetje të objektivave institucionale.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 9-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie institucionale ku të përfshihet një plan mbi Teknologjinë e Informacionit me qëllim identifikimin e proceseve për zhvillimin në mbështetje të objektivave të institucionit.

Brenda vitit 2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor:

- Nuk ka Politika të Sigurisë së Informacionit dhe një drejtim strategjik të përshtatshëm si mbështetje për sigurinë e informacionit;
- Nuk janë mirë përcaktuar përgjegjësitë për sigurinë e informacionit;
- Procedura e ndjekur për kryerjen e backup-it nuk është e pasqyruar apo dokumentuar në asnjë dokument administrativ ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup, procesi i ruajtjes së të dhënave etj., për sistemet në përdorim nga punonjësit e DPSHTRR;
- Nuk disponon dokument të planeve të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofat (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash;
- Nuk ka identifikuar sistemet ose pjesët e tyre të cilat janë kritike për ofrimin e shërbimit 24 orë në 7 ditë të javës;
- Nuk ka hartuar politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 9-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit dhe uljen e riskut për ndërprerjen e shërbimeve

dhe vazhdimësisë së punës. Gjithashtu të merren masa për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve, problemeve dhe ndryshimeve.

Brenda 6 mujorit të vitit 2024

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, detyrat dhe përgjegjësitë mbi sigurinë e informacionit nuk janë kryer as nga AKSHI dhe as nga DPSHTRR e cila në zbatim të VKM nr. 673 prot., datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, nuk ka në strukturën e saj njësi të teknologjisë së informacionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 9-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, të marrin masa për miratimin e një strukture funksionale mbi sigurinë e informacionit me qëllim ofrimin e këtij shërbimi.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga niveli drejtues i DPSHTRR-s për periudhën objekt auditimi nuk janë identifikuar apo planifikuar trajnime të nevojshme në drejtim të teknologjisë së informacionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 9-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor të marrë masa për identifikimin e nevojave dhe trajnimin e punonjësve të strukturës së Drejtorisë së Administrimit dhe Monitorimit, si dhe të hartojë e miratojë plane trajnimi mbi drejtime specifike të teknologjisë së informacionit.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në identifikimin e risqeve për vitet 2021-2022 janë identifikuar risqet mbi sistemet e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, por nuk ka risqe të identifikuar për teknologjinë e informacionit. Në risqet e identifikuar për vitin 2023 është përfshirë në Objektivin 40: ‘Ruajtja e sigurt e të dhënave të regjistrave elektronik’, e cila përcakton si risk mungesën e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të vazhdueshëm me Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, për rritjen e sigurisë së sistemeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 9-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor të marrë masa për identifikimin e risqeve në drejtim të teknologjisë së informacionit, vlerësimin dhe adresimin tek personat përgjegjës duke përfshirë dhe rastet kur risku paraqitet si rezultat i mungesës së bashkëpunimit ndërmjet AKSHI-t dhe DPSHTRR-s.

Brenda 6 mujorit të vitit 2024

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- Nuk disponohet një akt rregullativ për administrimin e përdoruesve, mbi procedurat që duhet të ndiqen për krijimin, ndryshimin dhe mbylljen tyre;
- Në detyrat funksionale të përgjegjës të sektorit të suportit në Drejtorinë e Administrimit dhe Monitorimit nuk është përcaktuar nëse mund të kryhen funksionet mbi administrimin e përdoruesve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 9-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor të marrë masa për hartimin e një akti rregullativ për administrimin e përdoruesve, në të cilin të përcaktohen procedurat që do të ndiqen për krijimin, ndryshimin dhe mbylljen e tyre. Gjithashtu, të përditësohen përshkrimet e punës për pozicionet që angazhohen me administrimin e përdoruesve të brendshëm dhe të jashtëm të sistemeve të DPSHTRR-s.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, ambienti fizik i dhomës së serverave nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara në Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverëve të AKSHIT si dhe praktikat më të mira, ku disa nga mangësitë janë:

- Nuk janë kryer kolaudime për sistemin kundër zjarrit;
- Nuk ka një plan testimi të sensorëve të zjarrit si dhe nuk ka një plan testimi mirëmbajtje për sistemin elektrik;
- Instalimi elektrik i dhomës së serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm të godinës;
- Nuk ka të instaluar BMS (Building Management System) sistemi i alarmit. Sistem i cili sinjalizon problemet me rrymën elektrike, prezencën e ujit, temperaturës, sigurisë së aksesit në ambientin fizik.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 9-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor në projektin për ndërtimin e objektit të ri për zyrat qendrore të mbajë në konsideratë zbatimin e standardit dhe parametrave që nevojiten për dhomën e serverave.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit, realizuar në teknologjinë e informacionit, u konstatua se nuk është argumentuar mënyra e përzgjedhur për përlllogaritjen e fondit limit si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit.

Nga auditimi mbi procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pajisje ndihmëse për Drejtorinë e Drejtuesve të Mjeteve” për vitin 2021, u konstatua se:

- Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, argumentimin e sasisë dhe kriterëve teknike të kualifikimit si dhe të fondit limit, nuk ka argumentuar sasinë e pajisjeve bazuar në urdhrin e titullarit nr. 181, datë 11.03.2021.
- Komisioni nuk ka argumentuar mënyrën e përzgjedhur për përlllogaritjen e fondit limit si dhe kriteret teknike të kualifikimit duke filluar nga pika 4 deri në pikën 15 të këtij dokumenti, në kundërshtim me nenet 59 dhe 61 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar” si dhe urdhrin e titullarit nr. 181, datë 11.03.2021.
- Nuk është argumentuar teknikisht numri prej 10 punonjësish të kërkuar, kur numri i punonjësve të specializuar për të gjitha instalimet dhe konfigurimet që kërkohen është 6.
- Nuk është argumentuar teknikisht numri prej 3 punonjësish për instalimin e pajisjeve Server/Storage kërkuar në kapacitetin teknik, përkatësisht në kriteret për 2 punonjës të certifikuar për pajisje server/storage të nivelit ekspert i avancuar dhe 1 punonjës të diplomuar në fushën e teknologjisë së informacionit të certifikuar MCSE ose ekuivalent.

Nga auditimi mbi procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pajisje informatike” për vitin 2021, u konstatua se nuk janë dokumentuar nevojat dhe si është përlllogaritur kjo sasi pajisjesh informatike si dhe nuk është argumentuar mënyrën e përzgjedhur për përlllogaritjen e fondit limit për pajisjet server, çmimet e të cilave nuk publikohen nga AKSHI.

Nga auditimi mbi procedurën e prokurimit me objekt “Zbatimi i masave organizative dhe teknike sipas ligjit nr.2/2017 për Sigurinë Kibernetike” për vitin 2023, u konstatua se;

- Në specifikimet teknike kërkohet që të vlerësohet situata aktuale e ISMS, ndërkohë që DPSHTRR nuk disponon një të tillë, por vetëm një rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.
- Nuk janë argumentuar teknikisht kriteret për 10 punonjës të punësuar për 3 muaj, si dhe kriteret për:

1 inxhinier të pajisur me certifikatë nga Microsoft në nivel MCSE;

1 inxhinier të certifikuar për sigurinë e rrjetit në nivel profesional;

1 punonjës të pajisur me certifikatë ITIL për menaxhimin dhe cilësinë e shërbimeve;

- Nuk është vendosur kriteri për 1 punonjës të certifikuar si Auditor/Lead Auditor, për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001, si kriter që lidhet ngushtësisht me kërkesat e vendosura në specifikime teknike dhe me rekomandimet e AKCESK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 20-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të mbajë në konsideratë se krahas argumentimit ligjor të kriterëve të veçanta të kualifikimit nevojitet të argumentohet mënyra e përzgjedhur për përlogaritjen e fondit limit si dhe në terma teknike çdo kriter apo specifikë e kërkuar në prokurimet që zhvillohen në drejtim të Teknologjisë së Informacionit.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Për 5 procedurat e prokurimit me vlerë të vogël në njësitë e prokurimit të cilat kanë vepruar dhe si KVO për blerjet e vogla, nuk ka asnjë anëtar në grup ekspert të fushës së teknologjisë së informacionit, megjithëse janë vendosur kriterë të veçanta kualifikuese dhe specifike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 20-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të marrë masa duke caktuar ekspertë të fushës në hartimin e specifikimeve teknike si dhe të kriterëve të veçanta kualifikuese, në komisionet e vlerësimit të ofertave, për procedurat e blerjeve të vogla që janë investime apo shërbime në Teknologjinë e Informacionit.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e masave organizative dhe teknike për Sigurinë Kibernetike”, u konstatua se DPSHTRR ka vepruar duke prokuruar një shërbim rivlerësimi mbi situatën aktuale të ISMS-s në kushtet dhe ndikimet e faktorëve të mëposhtëm që janë:

- Kërkesat e vazhdueshme të AKCESK mbi marrjen e masave organizative dhe teknike në drejtim të sigurisë kibernetike;
- Në mungesë të njohurive specifike në këtë drejtim;
- Në mungesë të strukturës së sigurisë që AKSHI duhej të angazhonte për DPSHTRR;
- Në mungesë të plotësimit të detyrimeve nga AKSHI-n mbi politikat dhe masat teknike që nevojiten të ndërmerren për llogari të DPSHTRR-s, për aq sa përcakton VKM nr.673 datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

DPSHTRR si Operator Administrues i infrastrukturave kritike dhe AKSHI si institucioni përgjegjës për sigurinë, nuk janë angazhuar dhe nuk kanë aprovuar një ndarje të përgjegjësive dhe detyrave në mangësitë organizative dhe teknike që janë konstatuar nga AKCESK në drejtim të sigurisë kibernetike dhe masave që përcakton Ligji nr.2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 20-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor si institucioni përgjegjës për të dhënat e sistemeve informatike, në bashkëpunim me AKSHI-n si institucioni përgjegjës për zhvillimet teknologjike, të marrin masa për përcaktimin e termave në nivel teknik, të detyrimeve ligjorë që nevojitet të plotësojë secili prej tyre, si një zhvillim dhe domosdoshmëri në drejtim të sigurisë kibernetike. Të dy institucionet nevojitet që të mbajnë në konsideratë se siguria nuk mund të ofrohet vetëm nga një faktor, por nevojitet një përgjegjshmëri dhe ndarje eksplicite në detyrimet që ka secili prej tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor nuk ka hartuar një raport përmbledhës për asnjë nga procedurat e prokurimit me vlerë të vogël që parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe në nenin 84 të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të s’kualifikuar etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 20-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse duhet të hartojë një raport përmbledhës për çdo procedurë me vlerë të vogël që do të zhvillojë në vijimësi.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në 4 dosjet e prokurimit me vlerë të vogël është konstatuar se pjesa më e madhe e shkresave zyrtare nuk janë protokolluar nga institucioni. Mungesa e numrit të protokollit nuk lë gjurmë mbi vërtetësinë e dokumenteve zyrtare të tenderit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 20-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të mbajë në konsideratë që çdo shkresë zyrtare pjesë e dosjes së procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, të jetë e protokolluar nga institucioni.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për procedurat e prokurimit me objekt “Blerje USB Dongle-Security” e vitit 2022 dhe “Automatizim të procedurave online në web” për vitin 2022 fondi i miratuar është me TVSH në kundërshtim me nenin 34, pika 10 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në 2.2 faqet 20-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor të marrë masa që për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël, të bëjë përlllogaritjen e vlerës pa TVSH në zbatim të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se DPSHTRR për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje USB Dongle-Security” për vitin 2022 ka nxjerrë urdhrin e prokurimit para se të bënte përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta në kundërshtim me nenin 56, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” dhe me pikën 7 të Udhëzimit nr. 05, datë 25.06.2021.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 20-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa për zbatimin kronologjik të dispozitave ligjore dhe nënligjore për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël që do të zhvillojë.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se demo e sjellë në DPSHTRR nga OE “O.C.” për procedurën e prokurimit me objekt “Automatizim të procedurave online web” për vitin 2022 ka qenë jashtë afatit të përcaktuar në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 16 ku thuhet se: “Operatori Ekonomik duhet të paraqitet pranë autoritetit kontraktor brenda 24 orëve nga momenti i njoftimit të fituesit dhe duhet të dorëzojë me usb/cd një demo të aplikacionit mobile të instalueshëm në platformën Android (duke plotësuar të gjitha kërkesat sipas specifikimeve teknike)”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 20-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël duhet të sigurohet që operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet e përcaktuara në ftesën për ofertë, në zbatim të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave u konstatua se:

1. Nuk është ndjekur e njëjta praktikë në drejtim të nënshkrimit të marrëdhënies kontraktuale, megjithëse jemi në kushtet që asetet ndodhen në regjistrin e DPSHTRR-s dhe pagesat për këto kontrata kryhen nga ky institucion:

- Kontrata me nr.4698, datë 24.09.2020 me objekt “*Implementimi i platformës elektronike eTransport*” është nënshkruar ndërmjet 3 palëve që janë: Autoriteti Kontraktor që është AKSHI, Autoriteti Përfitues që është DPSHTRR si dhe Operatorit Ekonomik.

- Kontrata me nr.4721, datë 06.08.2019 me objekt “*Upgrade i sistemit qendror eDPSHTRR...*” është nënshkruar ndërmjet 2 palëve që janë: Autoriteti Kontraktor që është AKSHI dhe Operatorit Ekonomik.

2. Nuk është ndjekur e njëjta praktikë në caktimin e punonjësve ndjekës të kontratave, ku:

- Për kontratën me nr.4698, datë 24.09.2020 me objekt “*Implementimi i platformës elektronike eTransport*”, institucioni i DPSHTRR-s përfaqësohet me 1 punonjës ndërsa AKSHI me 3 punonjës;

- Për kontratën me nr.4721, datë 06.08.2019 me objekt “*Upgrade i sistemit qendror eDPSHTRR...*” institucioni i DPSHTRR-s përfaqësohet me 2 punonjës ndërsa AKSHI me 3 punonjës;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 56-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masa për përcaktimin e termave në kontratë dhe nënshkrimin e tyre me përfaqësimin e dy institucioneve që janë AKSHI si Autoriteti Kontraktor dhe DPSHTRR si Autoriteti Përfitues, për investime në teknologjinë e informacionit apo shërbime që aplikohen mbi asete të cilat ndodhen në regjistrat e aktiveve të institucioneve përfitues të shërbimit.

Në vijimësi

16.2 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masa që në çdo kontratë investimi apo shërbimi në teknologjinë e informacionit ku asetet hardware dhe software regjistrohen në institucionin përfitues, numri i ndjekësve të kontratës nevojitet të jetë një numër tek punonjësish, ku numri më i lartë të jetë nga Institucioni Përfitues si ndjekës dhe monitorues i funksionaliteteve dhe administrator i fondeve të shpenzuara në drejtim të teknologjisë së informacionit.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ndjekjen e zbatimit të kontratave nëpërmjet sistemit të menaxhimit të kontratave-SMK, u konstatuan disa problematika që i paraqiten ndjekësit të kontratës dhe punonjësit të financës, dy funksione që përmbushen nga Autoriteti Përfitues i shërbimeve të cilat janë:

- Dokumenti i paraqitur nga OE pasi është kthyer nga ndjekësit e kontratës për korrigjim nuk pajiset me numrin e protokollit që ka marrë dokumenti kur ngarkohet për herë të parë, por ndjekësit janë të detyruar të nënshkruajnë dokumentin e radhës pa numër dhe datë protokollit;

- Sistemi është konceptuar dhe ndërtuar për nënshkrime në grup të dokumenteve periodike si dhe dokumenteve përfundimtare të zbatimit të kontratës, megjithëse aprovimi dhe nënshkrimi i dokumenteve do të duhej të ishte më dinamik, duke patur parasysh se fatura nuk

mund të nënshkruhet nëse nuk është konfirmuar marrja e shërbimit të realizuar, ose procesverbali i pranimit të shërbimit nuk mund të nënshkruhet përpara se raporti të jetë nënshkruar.

Fatura elektronike nevojitet të gjenerohet vetëm dhe vetëm pasi shërbimi apo produktet e ofruara janë pranuar nga grupi i marrjes në dorëzim apo ndjekësit e kontratës;

- Plani i zbatimit të kontratës nuk nënshkruhet nga OE dhe ky dokument nuk pajiset me numër dhe datë protokoll;
- Procesverbali i gjeneruar automatikisht nga sistemi në fakt duhet të ishte një akt-pranimi me të drejta editimi dhe jo një model i standardizuar për arsye se grupi në rast se duhet të dokumentojë një veprim, i nevojitet të mbajë një tjetër dokument të quajtur procesverbal dhe ta ngarkojë atë në sistem në formatin pdf si dokumentet e tjerë;
- Dokumentet e ngarkuar nga anëtarë të grupit të ndjekjes së kontratës nuk marrin numër dhe datë protokoll;
- Nuk janë mundësuar kërkime me numër protokoll, raporte të ndryshme që nevojiten të gjenerojë çdo përdorues me qëllim kontrollimin e veprime të kryera prej tij.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 56-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, të adresojë tek AKSHI si Autoritet Kontraktor për Sistemin e Menaxhimit të Kontratave – SMK, problematikat e konstatuara nga auditimi gjatë përdorimit të këtij sistemi, që nevojiten të zgjidhen me qëllim sigurimin e veprimeve të duhura dhe gjurmimin e tyre gjatë zbatimit të kontratave, për të paktën dy pozicionet që DPSHTRR përfshihet si ndjekës kontrate dhe punonjës finance.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi sistemin eDPSHTRR rezultoi se nuk është përcaktuar administratori i të dhënave me të drejta të plota, kërkesë kjo e përcjellë dhe nga AKCESK tek Operatorët Administrues të sistemeve kritike. AKSHI në kushtet e mungesës njohurive profesionale për mirëmbajtjen e këtij sistemi ka lejuar dhe ekspozuar sistemin e DPSHTRR ndaj një aksesimi dhe veprimi të pagjurmueshëm elektronikisht, por dhe të pambrojtur ligjërisht megjithëse nuk është administratori me të drejta të plota në të dhënat e këtij sistemi.

Siguria e të dhënave nga ky aksesim ka mbetur në motivimin e OE dhe punonjësve të cilët angazhohen në veprime të këtij suporti. Sipas VKM-s nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” i ndryshuar, nuk përcaktohet që AKSHI të jetë apo të ketë administratorin me të drejta të plota në këto të dhëna.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 54-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të marrë masa për shtimin në organikë dhe hartimin e përshkrimit të punës për Oficerin e Sigurisë së të dhënave, nisur nga detyrimet ligjore dhe nënligjore që përcakton ligji për sigurinë kibernetike ku institucioni është Operator Administrues dhe si i tillë duhet të plotësojë një sërë kërkesash që burojnë nga këto akte. DPSHTRR duhet të kërkojë dhe mbajë detyrat e administratorit të të dhënave me të drejta të plota.

Brenda 6 muhorit të parë të vitit 2024

19. Gjetje nga auditimi: Ndërmjet DPSHTRR dhe AKSHI-t nuk ka një ndarje të detyrimeve dhe përgjegjësi në lidhje me sigurinë e të dhënave. Nga auditimi u konstatua se DPSHTRR gjendet në kushte të paqarta vepruese ndaj kërkesave të vazhdueshme nga AKCESK për masat që duhet të merren për infrastrukturën kritike eDM dhe eDPSHTRR, për arsye se marrëdhënia e përgjegjësi dhe bashkëveprimi me AKSHI-n nuk është përcaktuar në terma teknikë. Aktet ligjore e nënligjore për infrastrukturën kritike përcaktojnë DPSHTRR si Operator Administrues

për eDM dhe eDPSHTRR. Në asnjë strukturë dhe tek asnjë punonjës nuk janë përcaktuar detyrat funksionale që DPSHTRR ka detyrim të plotësojë si Operator Administrues i strukturave kritike përcaktuar me aktet ligjore e nënligjore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 62-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor në bashkëpunim me AKSHI-n dhe AKCESK-un të marrin masa organizative për përcaktimin e detyrave që rrjedhin nga aktet ligjore ku mbështeten AKSHI dhe AKCESK, por që duhet t'i zbatojë DPSHTRR, duke ndarë në këtë mënyrë përgjegjësinë e çdo institucioni ku secili do të duhet të ndërmarrë hapat organizativë dhe teknikë në sigurimin e arsyeshëm të të dhënave që ruhen në sistemin eDPSHTRR.

Brenda 6 muhorit të parë të vitit 2024

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për sistemin eDPSHTRR nuk janë ndërtuar mekanizma gjurmues dhe kontrollues mbi gjurmën elektronike të veprimeve në të dhëna të rëndësishme që në termat teknikë quhen logs. Nuk ka asnjë evidencë se analizimi i log-eve të konfiguruar në bazën e të dhënave, analizohet dhe monitorohet nga struktura të caktuara të DPSHTRR-s.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 62-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, në kushtet kur mekanizmi i logeve është parashikuar të zhvillohet në kontratën që është aktualisht në zbatim për përmirësimin e sistemit eDPSHTRR, të mbajë në konsideratë që për këtë zhvillim të ndërtuar nevojitet të përcaktohet struktura monitoruese dhe analizuese e gjurmës elektronike.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi kriteret e fjalëkalimit për përdoruesit e sistemit eDPSHTRR u konstatua se, janë vendosur kriteret minimale në aksesimin e këtij sistemi dhe nuk janë aplikuar elementë sigurie të detyrueshëm mbi gjatësinë që sipas standardeve përlllogarit të jetë jo më pak se 8 karaktere, mos përsëritjen e të njëjtit fjalëkalim, bllokimin e përdoruesit në rastet e vendosjes së fjalëkalimit të gabuar nga një numër i arsyeshëm provash të aksesimit si dhe ndërrimin e detyrueshëm pas log-imit kur fjalëkalimi është krijuar nga suporti.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 62-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

21.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të marrë masa, për rritjen e sigurisë në aksesimin e sistemit eDPSHTRR, si një nga elementët e rëndësishëm që parandalon aksesimin e paautorizuar të të dhënave të sistemit eDPSHTRR nga përdorues të brendshëm dhe të jashtëm.

Brenda vitit 2024

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se sistemi eDPSHTRR nuk ka ndërveprim në kohë reale me sistemin doganor Asycuda, por është mundësuar gjenerimi i një raporti për mjetet e importuara tek të cilat janë kryer veprimet doganore të një dite më parë.

Në rastet kur konstatohen mospërputhje nga identifikimi teknik i mjetit me deklaratën doganore, DPSHTRR refuzon dhënien e shërbimit për regjistrimin e mjetit. Të dhënat e përditësuara/amenduara nga DPD për rastet e refuzuara, DPSHTRR i lexon dhe i azhuron ditën tjetër.

Veprimet mbi mjetet e importuara të kryera nga DPD, nuk lexohen në kohë reale duke sjellë një impakt në DPSHTRR, e cila nuk mund të japë shërbim për të gjitha rastet e regjistrimit të mjeteve që paraqiten për regjistrim brenda ditës që kanë kryer procedurat doganore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 62-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

22.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masa për ndërtimin e ndërveprimit ndërmjet sistemit eDPSHTRR dhe Assycuda me qëllim leximin tek ky i fundit të të dhënave në kohë reale mbi mjetet motorikë të importit të cilat aktualisht përditësohen me veprime manuale nga një punonjës i dedikuar në DPSHTRR.

Brenda vitit 2024

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në sistemin informatik eDPSHTRR, kategorizimi në sistem bëhet në grupet “Individ” dhe “Subjekt”. Për kategorinë subjekt të dhënat si emri, adresa, etj., lexohen nga sistemi i QKB-s dhe DPT për statuset ligjore që krijohen direkt në sistemin informatik eTax të DPT-s. Statusi ligjor, një e dhënë e rëndësishme në bazat e të dhënave të QKB-s dhe DPT-s për subjektet, nuk lexohet dhe nuk është e mundur të ruhet në regjistrin e mjeteve pasi mungon fusha në bazën e të dhënave për këtë të dhënë. Në sistemin elektronik eTaxation të DPT-s, kategorizimet ligjore të subjekteve në total aktualisht janë 25, ku 15 staturë krijohen në QKB, ndërsa 10 prej tyre krijohen në sistemin tatimor. Mungesa e këtij informacioni në sistemin eDPSHTRR, krijon pamundësi në analizimin e të dhënave për mjetet në pronësi të subjekteve në kategori të ndryshme, pamundësi për të aplikuar lehtësime apo kufizime të njëjta në nivel kategorie, si dhe pamundësi për veprime të tjera që vendimmarrjet sjellin impakt në grup të mjeteve apo njoftime automatike për detyrimet që nevojitet të aplikohen në mjete sipas grupeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 62-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

23.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masa për ndërtimin e funksionalitetit në sistemin eDPSHTRR për statusin ligjor të subjekteve dhe të lexojë e ruajë në regjistrat e mjeteve këtë të dhënë të marrë nga QKB apo DPT sipas rastit, si një e dhënë orientuese në mjetet e biznesit që i përkasin të njëjtës kategori. Filtrimi, analiza dhe planifikime të politikave mbi të dhëna në regjistrin e mjeteve që identifikohen në grup do të jetë më i lehtë dhe më i saktë në rast se cilësimi për statusin ligjor do të lexohet nga ndërveprimi.

Brenda vitit 2024

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se të dhënat e sistemit eDM nuk janë të regjistruara si bazë të dhënash shtetërore dhe janë ngritur ndërveprime në kundërshtim me ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” dhe VKM nr. 945, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 62-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

24.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të hartoj dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin eDM me të dhënat e të cilëve janë ndërtuar dhe ndërveprime me sisteme të tjera.

Në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nuk janë dokumentuar, diagramet e rrjedhës së informacionit, për çdo shërbim të konfiguruar në sistemin eDM. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor nuk disponon një dokumentim skematik mbi proceset, rregullat dhe procedurat e implementuara për çdo modul apo shërbim që është informatizuar në sistemin eDM.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 62-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

25.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme Shërbimeve të Transportit Rrugor duhet të hartoj dhe dokumentoj diagramet e rrjedhës së informacionit për çdo proces që realizohet nëpërmjet sistemit me qëllim përcaktimin e të dhënave hyrëse, roleve, ndryshimin, miratimin dhe përfundimin për çdo shërbim që realizohet nëpërmjet sistemit informatikë.

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për sistemin eDM:

- Nuk janë ndërtuar mekanizma për bllokimin e përpjekjeve për të loguar me fjalëkalim të gabuar;
- Nuk ka ndërveprim në kohë reale me sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile;
- Nuk ka mekanizma kontrollit të vlefshmëria e hyrjes “Input”, për disa fusha të rëndësishme duke gjeneruar një output të pa vlefshëm.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 62-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

26.1 Rekomandimi: Organet drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Drejtoria e Administrimit dhe Monitorimit të marrin masa për vendosjen mekanizmave:

- Për bllokimin e përpjekjeve për të loguar me fjalëkalim të gabuar
- Për të përditësuar të dhënat dhe për të krijuar ndërveprim në kohë reale me sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile
- Të marri masa në përmirësimin e sistemit në ndryshimin e aplikimit me të dhëna të gabuara duke ndërprerë pagesën e dyfishtë gjithashtu të ndërtoj mekanizma kontrollit të vlefshmëria e hyrjes “Input”, për disa fusha të rëndësishme duke gjeneruar një output të pa vlefshëm.

Brenda vitit 2024 dhe në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Drejtorinë e Përgjithshme Shërbimeve të Transportit Rrugor nuk ka auditues me profil të teknologjisë së informacionit me qëllim planifikimin dhe zhvillimin e drejtimeve të auditimit IT nga struktura e Auditimit të Brendshëm.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 76-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

27.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të vlerësojnë me prioritet ndryshimin e strukturës së Auditit të Brendshëm duke përfshirë auditues me profil në Teknologjinë e Informacionit me qëllim auditimin e drejtimeve IT, duke i ofruar institucionit mbulim të plotë të auditimit.

Brenda vitit 2024

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT